**Shtojca 1.**

Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (2021-2025), dhe Plani i Veprimit (2021-2023)

# Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit për vitin (2023)

**Maj, 2024**

Në vijim është prezantuar Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (2021-2025), me kolonën në fund ku tregohet progresi në zbatim, siç rekomandohet nga Manuali i Qeverisë për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike (2019).

Udhëzim:

Ngjyra e gjelbërt tregon zbatimin e plotë të një aktiviteti
Ngjyra e portokalltë tregon zbatimin e pjesshëm apo se një aktivitet është në zbatim e sipër
Ngjyra e kuqe tregon se aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të

## Shtojca 1.

**Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin (2021 -2023)- Modeli për progresin kundrejt veprimeve**

Fokusi i raportit të planit të veprimit është në përfundimin e veprimeve (progresit) siç parashihet në planin e veprimit dhe arsyet e vonesave, të cilat jepen në shtyllën "Progresi në zbatim".

| **Nr.** | **Objektivat dhe veprimet** | **Afati i fundit** | **Burimi i financimit** | **Institucioni udhëheqës dhe mbështetës** | **Produkti (Output)** | **Progresi në zbatim** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **I.** | **Objektivi strategjik: Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut** | | | | | |
| **I.1** | **Objektivi specifik: Zhvillimi i mekanizmave institucional efektiv, të përgjegjshëm, gjithëpërfshirës, pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm, në të gjitha nivelet për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| I.1.1 | Të Funksionalizohet Grupi Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, si mekanizëm kryesor Koordinues qeveritar për të drejtat e njeriut | 2021 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM | Grupit Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut funksional<br><br>Rregullorja e punës së Grupit Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut e aprovuar | Qveria e Kosovës është duke i dhënë prioritet përmirësimit të koordinimit ndër-institucional në aspektin e hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe Politikave në fushën të drejtave të njeriut. Me dt .10 dhjetor 2021, në rrjedhën e koordinimit të procesit për plotësim ndryshim të Vendimit Nr.06/87, Datë:13.05.2016 për Grupin Koordinues Ndërministror për të Drejtat e Njeriut, Qeveria e Kosovës ka marrë Vendim për themelimin e Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut. Ndryshimet janë fillimisht me emërtimin e grupit duke qenë se anëtarët e saj nuk janë vetëm ministrit e linjës por edhe institucione të pavarura dhe si i tillë nuk mund të quhet mekanizëm ndërministror duke ju referuar (vendimit të kaluar) por mekanizëm ndërinstitucional. Ky mekanizem udhëhiqet nga Zëvendëskryeministrja e tretë për çështje të pakicave dhe të drejtave të njeriut znj. Emilija Rexhepi. Grupi Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut është organ kryesor koordinues për të drejtat e njeriut, në kuadër të Qeverisë së Kosovës, detyrat, përgjegjësitë dhe përbërja e të cilit janë të përcaktuara me Vendim Nr.10/47 me date 10.12.2021<br>• Grupi funksion në bazë të Rregullores së punës Nr.01/2021.Me dt.09 qershor 2023 është mbajt takimi i rregullt i Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut, ku pik e rendit të ditës ishte: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Prezantimi dhe diskutimi i Raportit të Progresit (2021-2022) mbi zbatimin e Planit të Veprimit (2021-2023) për Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2025)<br>"Situata lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit adresuar institucioneve"(progresi & sfidat).<br>" Për herë të parë në kuadër të këtij mekanizmi është bërë Prezantimi dhe adresimi i Rekomandimeve të dala nga Raporti i Shoqërisë Civile për të drejtat e njeriut në Kosovë në vitin 2022" |
| I.1.2 | Funksionalizimi dhe fuqizimi i i mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në qeveri dhe komuna konform legjislacionit në fuqi | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM Ministritë, Komunat KE ZBEK | Në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes janë funksionalizuar mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi | Në nivel ministror dhe të komunave janë themeluar mekanizmat institucional për mbrojtjen nga diskriminimi. Sipas të dhënave zyrtare të MAPL, shohim se deri më tani janë 30 komuna të cilat kanë caktuar zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa 8 komuna (Klinë, Kamenicë, Kllokot, Hani Elezit, Partesh, Novobërdë, Kaçanik, dhe Zubin Potok), janë zyrtarë tjerë që e mbulojnë këtë fushë. Probleme në vete është se këto mekanizma nuk kanë një strukturë uniforme të organizimit dhe emërimit ,dhe jo në konformitet me Ligjin NR. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi,si dhe Rregulloren Nr.03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtën nga diskriminimi në Qeveri dhe Komuna.<br>MAPL,ka bërë një vlerësim të kapaciteteve të strukturave komunale të mandatuara për të punuar me grupet e margjinalizuara. Qëllimi i këtij vlerësimi ka qenë që të mësoj për strukturat dhe zyrtarët ekzistues që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë dhe grupet e cenueshme në komuna dhe të identifikoj problemet dhe sfidat që këto struktura kanë në kryerjen e mandatit të tyre.<br>https://mapl.rks-gov.net/raportet-vjetore-te-mapl-se/ |
| I.1.3 | Këshillime profesionale për realizimin e të drejtës, informim të drejtë dhe të shpejtë dhe të qasshëm të dokumenteve përmes të cilave realizohen të drejtat e tyre. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM ABGJ Ministrit Komunat | Numri i fushatave dhe aktiviteteve vetëdijusese dhe informuese të organizuara Realizimi i debateve, tryezave me grupet e | Në zbatim të kësaj mase ka pas aktivitete të shumta të realizuara nga ana e ministrrive dhe komunave, agjensioneve, duke vu theksin në disa me kryesore, në pamundësi me i prezantu të gjitha po i prezantojmë disa prej tyre;<br>**ABGJ** ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas me dedikimin në kujtimi të grave krijuese, artiste profesoresha universitare dhe gazetare që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje dhe të cilat nuk jetojnë me''.Konferencën e ndoqën 90 pjesëmarrës. Në vlerë totale 2.232.00 euro.<br>**ABGJ** në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), në muajin nëntor ka organizuar takimin e rregullt konsultativ vjetor të nivelit të lartë, të gjashtin me radhë, me akterë institucional, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Takimi ishte i fokusuar në përkushtimin e Kosovës drejt procesit të Integrimit Evropian nga perspektiva gjinore si dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ndryshme të interesit<br><br>Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime | sfidat e avancimit të barazisë gjinore. Vlera e shpenzimeve ishte 1785.40 euro.<br><br>Ndriçimi i Ndërtesës se Qeverise në shënim të 8 Marsit- Dita Ndërkombëtare e Gruas me dedikimin në kujtimi të grave krijuese, artiste, profesoresha universitare dhe gazetare që thyen barrierat në fushat ku vepruan dhe ndërtuan historinë e vendit tonë me fytyrë gruaje dhe te cilat nuk jetojnë me’’ në vlerë totale 1587.70 euro.<br>Ndriçimin i Ndërtesës se Qeverise me ngjyrë vjollce dhe kordele roze, për shënim të: Tetori- Muaji i Ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit, Ne vlere totale 1587.70 euro, si dhe ka bere shtypjen e materialeve promovuese (shalla, totbeg, kordelet e roze), në kuadër të shënimit te këtij muaji. Vlera totale është 1649.99 euro.•<br>Ndriçimi i Ndërtesës se Qeverise në kuadër te fushatës se 16 Ditëve të Aktivizmit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës në baza gjinore, në vlere 1,587.70 euro. Me rastin e mbajtjes se Konferencës të organizuara nga Ministria e Drejtësisë dhe presidentja në kuadër te fushatës se 16 Ditëve të Aktivizmit , ABGJ ka mbështetur Ndriçimi e Ndërtesës se Ministrisë se Drejtësisë ( ish Objeki i Rilindjes) në vlere 1,587.70 euro.Shtypja e materialeve promovuese (ombrellat, totbeg, kordelet e bardha, fletore). Vlera totale është 5477.15 euro.<br>**Ministria e Shëndetsisë,** Gjatë vitit 2023 me qëllim që profesionistët shëndetësor të njoftohen me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimit lidhur me obligimet dhe të drejtat që parshehë ky ligj si dhe janë prezantuar disa nene të Konventave ndërkombëtare me të cilat mbrohet e drejta për shëndet; prezantimet janë mbajtur në 5 (pesë) QKMF me përkrahjen financiare nga projekti i AQH-së;<br>Në kujdesin Parësor pasi që kontakti i parë i pacientit me profesionistin shëndetësore është në nivele të kujdesit parësor shëndetësorë.<br>Tryezat janë mbajtur në pesë (5) QKMF si : QKMF– Lipjan; Rahovec; Istog ; Fushë Kosovë; Obiliq.<br>**Tryezat kanë përfshirë 80 profesionistë shëndetësor të nivelit: kryeinfermier dhe infermiere,**<br>Ndërsa tryezat me komunitetin përfaqësuese të organizatave Roma, ashkali dhe egjiptase, dhe qytetar të këtij komuniteti, janë mbajtur në vitin- 2023; Tema prezantimi i Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi e drejta e ankesës dhe e drejta për shëndete si e drejte e njeriut e mbrojtur me Kushtetutë dhe Konventa Ndërkombëtarë,<br>Tryezat janë mbajtur në Komunat ku ka një numër me të madhe të banoreve të këtij komuniteti, pasi që kontakti i parë i pacientit me mjekun është në nivel të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | kujdesit parësor shëndetësor.<br>Në vitin 2023 janë mbajtur në tri (3) Komuna: QKMF – Lipjan; QKMF Podujeve; QKMF – Peje.<br>Tryezat kanë përfshirë 50 qytetare të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian: udhëheqës i OJQ –ve, të këtij komuniteti.<br>MSH me qëllim të ngritjes së cilësisë në shërbimet shëndetësore dhe me qëllim që qytetarit ti krijohet mundësia që ti shprehe pakënaqesitë gjatë marrjes se shërbimeve shëndetësore ka themeluar linjen e ankesave që nga viti 2013 dhe gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithësej 214 ankesa përmes linjës ankesave dhe emailit linjafalas@rks-gov.net, raporti i ankesave është i publikuar në ueb faqen e MSh –së për vitin 2023.<br>Organizata Joqeveritare VORAE gjatë muajit maj 2023, ka organizuar dy sesione një ditore trajnimi me qellim të ngritjes së kapaciteteve të brendeshme të promovimit dhe të mbrojtjes nga diskriminimi. Punëtoritë janë organizuar me zyrtaret e zyrave komunale të punësimit dhe me zyrtarët e Qendrave të Aftësimit profesional, institucione këto në kuadër të APRK.<br>**NJDNJ në MMPHI** pjesa e Mjedisit në vitin 2023 organizoj punëtori dy ditore me temen Kontributi i Grave në mbrojtjen e resurseve ujore dhe përfshirja e barabartë gjinore përkrahur nga Programi i Menagjimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë. Ne këtë punëtori prezantimi i NJDNJ ishte lidhur me kontributin e grave në mbrojtjen e resurseve ujore, ngritja e kapaciteteve, ndërgjegjësimi për bizneset e grave dhe kujdesi për ndotje e ujit, mbledhja e të dhënave në baza gjinore në përdorimin dhe menaxhimin e ujit, konsultimet me palët e interesit me ndjeshmëri gjinore në mënyrë që gjate hartimit të politikave të integrojmë perspektivën gjinore. Ne këtë punëtori ishin përfaqësues të Komunave, përfaqësues te shoqërisë civile, përfaqësues nga SKAT dhe nga stafi i MMPHI-së.<br>**Ministria e Ekonomisë** në vazhdimësi i publikon dokumentet që janë me inetres për qytetarët dhe ato që janë obligim ligjor, të cilat gjenden në ueb-faqen e ME-së: https://me.rks-gov.net/<br>**Ministria e Ekonomisë** ka zhvilluar fushata vetëdijësuese me thirrjen “Kurse Energjinë”, si videove vetëdijësuese me mesazhe nga Kryeministrin, Ministren e Ekonomisë, ministrja e MINT, ministren MASHTI, ministri i MMPHI si dhe ambasadorë të ndryshëm.<br>Videove të shkurtër vetëdijësuese të transmetuara në TV, në rrjete sociale të Ministrisë (vazhdojnë akoma në mënyrë periodike)<br>Informata të ndryshme ilustruese/video/infografika/ përmes platformës Viber<br>Fushata vetëdijësuese për kursim të energjisë nëpër shkolla të Kosovës<br>Video informuese në rrjete sociale për energjinë e ripërtërishme<br>Subvencionimi i pajisjeve efiçiente të energjisë për qytetarë dhe biznese |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Intervista dhe video me qëllim informimin e qytetarëve rreth aplikimit dhe benefitive të subvencionimit të pajisjeve efiçiente.<br>Janë mbajtur Konsultime publike për Agjendën Digjitale të Kosovës 2030.<br><br>Niveli local i Qeverisjes ka organizuar në vazhdimësi gjatë gjithë vitit fushata vetdijësuese dhe sensibilizim të qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre. Janë mbajt ligjërata e takime, me nxënës, përgatitë dhe shpërndë fletpalosje lidhur me të drejtat dhe obligimet e fëmijëve si dhe aktivitete tjera në fushat e të drejtave të njeriut.<br>**Komuna e Istogut** -ka organizuar fushata dhe aktivitete vetëdijësuese sipas Planit të punës së Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me OJQ-të. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për shfrytëzimin e të drejtës së tyre për këshillë juridike falas.Janë përditësuar të dhënat në ueb faqe ku qytetarët informohen për realizimin e drejtave të tyre.<br>**Komuna e Kamenicës ka lasuar videospote:**<br>**Të drejtat e njeriut:**<br>- **https://www.youtube.com/watch?v=zQ5p7UxMmaI**<br>- **Ç’është Aftësia e Kufizuar? https://www.youtube.com/watch?v=-5lsBHWtBzA**<br>- **Unë kam një ligje që më mbron**<br>**https://www.youtube.com/watch?v=ptQf62XkMEM**<br>- **Tetori rozë – Muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit https://www.youtube.com/watch?v=CcZbyG4g5oU**<br>- **Si ta parandalojmë Trafikimin me Qenie Njerëzore https://www.youtube.com/watch?v=kUPA0A_NKkY**<br>- **Spot vetdijësues STOP DHUNËS**<br>- **https://www.youtube.com/watch?v=kUPA0A_NKkY**<br>- **Stop-Bullizmit https://www.youtube.com/watch?v=mfNvPzbuDeo**<br>Të gjitha këto videospote janë të lansuara në youtube dhe kanë për qëllim që edhe qytetarët të cilët jetojnë në viset e thella rurale t’mund ti shohim dhe ta kuptojnë qëllimin e këtyre videospoteve e që është vetdijësimi i tyre.<br>Çdo herë mbanë ligjërata me nxënës dhe tryeza diskutimi lidhur me parandalimin e këtyre dukurive por edhe për të drejtat e njeriut në përgjithësi. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Fushata Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Komunën e Kamenicës ka filluar që nga data 18 Tetor, ku në bashkëpunim me Policinë e Kosoves dhe DKA janë realizuar aktivitete të ndryshme, sesione informuese nëpër shkolla, takim dhe bashkëbisedim me qytetarë të grupmoshave të ndryshme, shpërndarje të fletpalosjeve dhe materialeve tjera ndërgjegjësuese lidhur me Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore.<br><br>Fushata 16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, me datën 10 Dhjetor Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut - lansimi i videospotit përgatitur nga Koordinatorja e NJKDNJ-së lidhur me vetdijësimin e qytetarëve mbi të Drejtat e Njeriut.<br>Komuna e Vushtrisë- Njësiti komunal për të drejtat e njeriut, gjatë gjithë vitit mirët me promovimin e të dtejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve, për barazi gjinore dhe mos diskriminim. Gjatë vitit 2023, dhe gjate kësaj kohe kemi realizuar 15-të takime në fushën kundër diskriminim, në fushatën 16të ditët e aktivizmit janë realizuar disa aktivitete në lidhje me informimin dhe vetedisimin kundër dhunës në familje, në fushatën Tetori muaji roze, kemi organizuar, 5 takime informuese, një marsh dhe një ekspozit për vetëdisimin e qytetareve për sëmundjen e kancerit.<br>Realizimi i debateve, tryezave me grupet e ndryshme të interesit.<br>NJKDNJ-ja, kemi realizuar debate me grupe të ndryshme të grave lidhur me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortve, ku vlen të ceket që ne komunën tone gjate vitit 2023, gjithashtu kemi realizuar edhe debate me grupe te ndryshme te nxensive te shkollave te mesme lidhur me te drejtat e njeriut, fëmijëve, barazi gjinore, kundër dhunës, kundr diskriminimit, per bullizmin, siguria ne shkolla etj.<br>Gjate debateve, takimeve me qytetare, gjithmonë i kemi njoftuar lidhur me të drejtat e tyre, duke filluar nga e drejta e regjestrimit të pronës ne emër te dy bashkeshortve, të drejtës trashigimore, gjithashtu edhe per ofrimin e ndihmës juridike falas.<br>Komuna e Malishevës -Aktivitete të realizuara me grupe të grave, vajza e djem lidhur me njohjen e të drejtave (takime, debate, ligjerata në shkolla me tema të caktuara me theks të veçant të drejtat e njeriut në bashkepunim me zyrtarin ligjor (nga regjioni) nga zyra e avokatit të popullit organizohet për çdo muaj dita e hapur me qytetare. Janë organizuar ligjerata për të drejtat fëmijeve me nxenes dhe mësimdhënës<br>**Agjensioni për Informim dhe Privatësi-** ka qenë i fokusuar në Promovimin e së drejtës për qasje si dhe këshillimi dhe njoftimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve për procedurat e realizimit të së drejtës së tyre për qasje në dokumente publike, përmes paraqitjeve në emisione televizive, debateve ,tryezave etj. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Janë përditësuar web faqet e ministrive dhe komunave me informacione të nevojshme lidhur me informin e qytetarëve lidhur me realizimin e të drejtave të tyre për qasje në shërbime | Web faqet e ministrive dhe komunave në vazhdimësi përditësohen dhe ofrojnë informacione relevante lidhur me realizimin e të drejtave të qytetarëve për qasje në shërbime në fushat e ndryshme të të drejtave të njeriut, konform legjislacionit në fuqi.<br>MAPL ka filluar procesin e digjitalizimit të shërbimeve komunale përmes zhvillimit të platformës E-KOMUNAT. Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për të rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal dhe do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale duke rritur efikasitetin dhe kualitetin e këtyre shërbimeve karshi qytetarëve. |
| I.1.4 | Të bëhet vlerësimi vjetor i performancës së zyrtarëve publik në kuadër të komunave lidhur me zbatimin e ligjeve në shërbim të qytetarëve për këto shërbime komunale;<br><br>Shërbimet publike administrative;<br>Transparenca komunale;<br>Të drejtat e njeriut, shërbimet | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MAPL Komunat Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale, Koordinatori komunal për Performancë; Drejtori i administratës komunale; | Raportet e monitorimit të performancës së komunave të publikuara<br><br>Publikimi i rezultateve të performancës në faqen zyrtare të komunës përkatëse, bërjen transparente të punës së komunës përballë qytetarëve; si | **Raporti i performancës komunale për vitin 2023,** prezanton rezultatet e punës së komunave në fushat e kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes treguesve të përfshirë në Sistemin për Menaxhimin e Performancës Komunale. Bazuar në Raportin e performancës, në nivelin mbi mesataren e vendit janë shërbimet si në vijim: Shërbime Publike Administrative janë në nivelin më të lartë prej **88.04%** në nivel vendi, e pasuar nga fusha transparenca komunale **85.78%,** Kultura Rina dhe Sporti janë shërbime të cilat janë ofruar në nivel të kënaqshëm që shprehur në përqindje janë **83.67%,** uji pijshëm është renditur në nivelin katërt prej **74.60%,** po ashtu fusha e menaxhimit të mbeturinave ka vlerën prej **69.84%.** Dy fushat tjera, përgjegjshmëria komunale dhe barazia në punësim dhe shërbimet sociale janë shumë afër mesatares së vendit sa i përket ofrimit të këtyre shërbimeve për qytetarë, fusha përgjegjshmëria komunale ka vlerën **62.02%** dhe barazia në punësim dhe shërbimet sociale në vlerën prej 60.30%.<br>Sa i përket të dhënave për vitin 2022, performanca e përgjithshme e komunave në 19 fusha me 111 tregues të matjes është 59.25%, që do të thotë se komunat kanë ofruar shërbime më cilësore, për 3.17% krahasuar me 2021, ndërsa krahasuar me vitin 2020 ndonëse ka një ngritje të lehtë të performancës në vitin 2022 prej 2.19%. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sociale dhe familjare;<br>Barazia Gjinore Kulturë, rini dhe sport;<br>Menaxhimi i fatkeqësive;<br>Planifikimi hapësinor;<br>Hapësirat publike;<br>Infrastruktura rrugore;<br>Transporti Publik;<br>Parkingjet publike;<br>Furnizimi me ujë të pijshëm;<br>Kanalizimi;<br>Menaxhimi i mbeturinave;<br>Mbrojtja e mjedisit. | | | dhe Kryetari i Komunës.<br>Zyra Kombëtar e e Auditimit (ZKA)<br>Zyrtaret për Barazi Gjinore;<br>Njësitë për të drejtat e njeriut, në kuadër të komunave ; | dhe krahasimi i performancës së komunave në nivelin e fushave prej viti në vit<br><br>Publikim dhe raportim i nivelit te integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në hartimin dhe zbatimin e politikave; | Përfitues të Grantit: Dragash, Malishevë, Kaçanik, Obiliq, Partesh, Pejë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj dhe Suharekë<br><br>.<br>Prandaj, të dy këto procese, matja e performancës dhe ndarja e grantit për performancë, synojnë të përmirësojnë punën e administratës komunale në përgjithësi, të rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, si dhe të reflektojnë në qeverisje më të mirë dhe shërbime sa më cilësore për qytetarë.<br>Informacione më të zgjeruara ofrohen te Raporti i Performancës së Komunave të cilin çdo vit e publikon MAPL.<br>Raporti i performancë së komunave hartohet sipas pikës 7 shtojca 12 e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, ku përshkruhet përgjegjësia e MAPL-së në lidhje me mbikëqyrjen cilësisë së shërbimeve komunale.<br><br>Raporti i performaces /matja e përfromancës bëhët gjithmonë për një vit më vonë.<br>https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/ALB-Raporti-i-Performances-Komunale-2022.pdf<br><br>Komuna e Podujevës pasi që ka marrë rezultatin e Performancës Komunale në formë të shkruar dhe tabelare ka hartuar një raport me informata nga procesi i raportimit të zyrtarëve në Fushat e Performancës Komunale.<br>Këtë raport e paraqet në mbledhjen e Kuvendit Komunal Kordinatori për performacë Komunale dhe bëhet një krahasim nga rezultatet e viteve paraprake. |
| I.1.5 | Bashkërendimi i veprimeve ndërmjet institucioneve vendore e ndërkombëtare për ndarjen e fondeve stimuluese komunave<br>➢ bazuar | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës **Donatorët** | MAPL Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale ,<br><br>Koordinat | Aplikimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në sektorët përkatës dhe paraqitja e shtojcës se BPGJ-së nga komunat - e | Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përmirësojne dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor,të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kritereve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë.<br>Situata aktuale rezulton si në vijim:<br>• Buxhetimi dhe shpenzimi i përgjegjshëm gjinor, ka vlerë 45%<br>• Barazia gjinore në buxhetim për punësim dhe ndërmarrësi të grave, 41.98%<br>• Niveli I të punësuarve gra në institucionet komunale është 83.53% në raport me kriterin 50 x 50. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në performancën e të drejtave të njeriut,<br>➢ shërbimet sociale dhe familjare<br>➢ barazi në gjinore dhe nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në komunat përkatëse; | | | ori komunal për Performancë; Drejtori i administratës komunale; dhe Kryetari i Komunës. | kërkuar nga Ministria e Financave me Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).<br><br>Komunave më të suksesshme u ndahen mjete financiare nga fondi stimulues për zbatimin e projekteve prioritare të propozuara nga vetë komunat.<br><br>Raporti i Performancës së Komunave paraqet nivelin e performancës së komunave lidhur me ofrimin e shërbimeve për qytetarët, | • Gra të emëruara në pozita politoke është arritur 61.57% e kriteriit ligjor<br><br>Përfitues të Grantit janë: Dragash, Malishevë, Kaçanik, Obiliq, Partesh, Pejë, Rahovec, Ranillug, Shtime, Skenderaj dhe Suharekë<br><br>Raporti i performancës komunale për vitin 2022 prezanton rezultatet e punës së komunave në 19 fusha të kompetencave që janë nën përgjegjësi të tyre, përmes 111 treguesve nga 119, sa ka gjithsej Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale1. Këto tregues përfshijnë aspekte të ndryshme të veprimtarisë komunale, duke shqyrtuar çështje si shërbimet publike administrative, transparenca komunale, përgjegjshmëria komunale, barazia në punësim, kulturë, menaxhimi i fatkeqësive, infrastruktura rrugore, dhe shumë të tjera.<br><br>Informacione më të zgjeruara ofrohen te Raporti i Performancës së Komunave të cilin çdo vit e publikon MAPL.<br>Raporti i performancë së komunave hartohet sipas pikës 7 shtojca 12 e rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, ku përshkruhet përgjegjësia e MAPL-së në lidhje me mbikëqyrjen cilësisë së shërbimeve komunale. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të vlerësuar sipas indikatorëve matës të sistemit të performancës Komunale, të vendosur nga MPL. | |
| I.1.6 | Monitorimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të dala nga raporti i performancës së komunave në përmirësimin e shërbimeve përkatëse për qytetarët; | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MAPL Departamenti për Performancë dhe Transparencë Komunale , | Raporti mbi monitorimin e rekomandimeve të dala nga raporti i performancës së Komunave, si dhe Arritjet e përgjithshme të performancës sipas komunave në përqindje. | Konkluzione dhe rekomandime ;Vlerësimi i performancës komunale për vitin 2022 nxjerr të gjetura të shumta për 19 fusha të kompetencave komunale.<br><br>Përfundimet e këtij raporti theksojnë një numër të madh të çështjeve, të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen me prioritet nga organet e pushtetit lokal. Në këtë pjesë të raportit, janë veçuar disa nga konkluzionet dhe rekomandimet me peshë më të madhe në avancimin e shërbimeve komunale. Raporti nxjerr përfundimet se:<br><br>**1.** Vlerësimi i performancës së komunave për vitin 2022 është bërë për 30 komuna . Disa nga të dhënat e raportuara nga komunat me shumicë serbe, në fushën e arsimit dhe shëndetësisë, të cilat nuk korresponduan me ofrimin e shërbimeve sipas legjislacionit pozitiv të Republikës së Kosovës, janë shpallur nule dhe u aplikua vlera 0% e performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës është obligim ligjor i të gjitha komunave, të cilat duhet t'i përgjigjen kërkesave për informata konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale.<br>**2**. Komunat duhet t'i kushtojnë vëmendje të gjitha të dhënave të prezantuara për raportim, në mënyrë që vlerat e fituara të paraqesin vlerësimin sa më objektiv të performancës për çdo tregues. Dokumentimi i të dhënave është kusht i domosdoshëm. Gjatë përgatitjes së të dhënave dhe informatave, komunat duhet të përgatisin dosjen për secilën fushë.<br>**3.** Procesi i sigurimit të cilësisë ka evidentuar një numër të të dhënave të pasakta, të cilat në shumë raste janë shpallë të pavlefshme, përveç atëherë kur është bërë dokumentimi i tyre. Cilësia e raportimit duhet të rritet në të ardhmen, ashtu që raportimi të jetë i drejtë, i saktë, objektiv dhe të paraqes gjendjen sa më reale të performancës së komunave.<br>**4.** Performanca është kategorizuar në dy grupe me tregues të cilës pasqyrojnë veprimet e komunave në funksion të qeverisjes së mirë dhe ofrimit të shërbimeve. Në kuadër të grupit të indikatorëve të qeverisjes, Shërbimet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Administrative renditet e para, megjithëse treguesi për pasqyrimin e rezultateve të konsultimeve publike duhet të trajtohet seriozisht nga autoritetet lokale. 33.12% e komunave kanë filluar me hartimin e këtyre raporteve (Gjilani, Gllogoci, Hani i Elezit, Juniku, Kaçaniku, Kamenica, Klina, Lipjani, Malisheva, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Peja, Podujeva, Prizreni, Rahoveci Skenderaj, Suhareka Podujeva, Rahoveci). Raportet e proceseve të konsultimeve publike duhet të përpilohen për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në politik-bërje dhe marrjen e opinionit të tyre për çështje publike.<br>**5.** Prezenca e qytetarëve në konsultimet publikë ka vazhduar të jetë e ulët. Komunat duhet të shfrytëzojnë teknika dhe mjete efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.<br>**6.** Performancë e ulët është treguar në fushën e përfaqësimit gjinor. Komunat duhet të ndërmarrin veprime për ta rritur numrin e grave në pozita vendimmarrëse, politike dhe në këshillat lokale. Po ashtu, duhet të përmirësohen dokumentet planifikuese dhe financiare duke marrë për bazë elementin gjinor.<br>**7.** Një pjesë e komunave kanë filluar aplikimin online të shërbimeve administrative, përformanca në këtë segment duhet të përmirësohet, për të ngritur efikasitetin në shërbime dhe me kosto sa më të ulët. Këto shërbime duhet të aplikohen në të gjitha komunat dhe për numër më të madh të shërbimeve, përfshirë aplikimin online për leje ndërtimore, leje mjedisore, pagesat e tatimit në pronë, apo faturat për shërbime komunale etj.<br>**8.** Të dhënat për barazinë në punësim dhe shërbimet sociale tregojnë se drejtoritë komunale duhet të bëjnë përpjekje për përfshirje të të gjitha kategorive në nevojë në politikat e punësimit. Gjithashtu efikasiteti duhet të rritet në vlerësimin e familjeve në banim social, në mënyrë që të objektet e banimit social të shfrytëzohen nga familjet në nevojë dhe të ketë shqyrtim të plotë të kërkesave të parashtruara;<br>**9.** Planifikimi hapësinor kërkon trajtim më të gjerë për të rregulluar të gjithë sipërfaqet e nevojshme me plane rregulluese të hollësishme ose me harta zonale. Të dhënat flasin për një shkallë mjaft të ulët të këtyre planeve të cilat janë tejet të rëndësishme për rregullimin e komunës;<br>**10.** Infrastruktura rrugore duhet të kompletohet, si në aspektin e asfaltimit të rrugëve, ashtu edhe me infrastrukturë përcjellëse përfshirë trotuare dhe ndriçim publik. Komunat duhet të rrisin cilësinë e të dhënave për nivelin e asfaltimit të rrugëve, trotuaret, ndriçimin e tyre, e sidomos tek të dhënat për shtigjet e biçiklistëve. Po ashtu, nevojitet planifikim më i mirë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale, në mënyrë që shtrirja me këtë shërbim të jetë e plotë.<br>**11.** 7.38% e të dhënave për shtigje të biçikletave në zonat urbane, është vlerë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | që tregon se komunat duhet të punojnë në avancimin e infrastrukturës rrugore përmes krijimit të shtigjeve të biçikletave.<br>**12.** Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit, komunat duhet të përpilojnë dhe të formulojnë pjesën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas kritereve ligjore. Politikat lokale duhet të vlerësojnë ndikimin gjinor, ashtu që burimet financiare të ndahen proporcionalisht për të dy gjinitë. Kërkohet promovim më i madh i politikave gjinore në këshillat e lokale. Komunat duhet të të hartojnë planet për barazi gjinore. Po ashtu kriteri i barazisë gjinore duhet të forcohet edhe në kuadër të pozitave të emëruara politike, si dhe të promovohet e drejta për regjistrimin e pronësisë në të dy gjinitë e cila qëndron në vlerë mjaft të ulët.<br>**13.** Komunat duhet të fillojnë të investojnë në çerdhe/kopshte në zona rurale ku ka nevojë, për shkak të rëndësisë së këtyre institucioneve në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.<br>**14**. Drejtoritë komunale të arsimit duhet të planifikojnë që shkollat të plotësojnë kushtet e infrastrukturës përcjellëse, masat e energjisë efiçiente, si dhe të jenë të pajisura me kabinete me internet në masë më të madhe. Krijimi i hapësirave shkollore sidomos në zonat urbane kërkojnë trajtim të veçantë për të eliminuar mësimin në më shumë turne dhe aplikimin e mësimit gjithë-ditor. Edhe në fushën e arsimit, është e domosdoshme të rritet cilësia e raportimit dhe saktësisë së të dhënave.<br>**15.** Planifikimi formal për zhvillim ekonomik lokal duhet të zgjerohet në komuna. Komunat duhet të hartojnë Planet për Zhvillim Ekonomik Lokal. Raportimi për realizimin e planeve të tilla duhet të jetë temë e diskutimit në kuvendet komunale, në mënyrë që te aktivitetet në këtë fushë të gjejnë zbatim më të lehtë dhe të renditen sipas kërkesave të shumicës.<br>**16.** Duhet të inkurajohen komunat që të respektohen rregullat ligjore, për ta ngritur cilësinë e raportimint dhe ngritjen e cilësisë së referencimit sa i përket dokumenteve adekuate për çeshtje të caktura.<br>**17.** Duhet tu bëhet me dije të gjitha komunave të Republikës së Kosovës se, përfromanca si instrument përveç që është mundësi për marrje të fondeve, është edhe obligim ligjor që të aplikohet raportimi i plotë për të gjithë treguesit.<br>*Komuna e Kamenicës dhe Podujevës ,aplikon një shembull të mirë, pas marrjes së rezultateve nga Raporti i Performancës, bënë krahasimin e pikëve të të gjitha fushave në krahasim me vitet e kaluara, dhe nga aty nxjerr gjetjet se ku ka pasur rënie e ku ngritje të shërbimeve. Mbi bazën e atyre gjetjeve dalin rekomandimet se si duhet vepruar për vitet e ardhshme në mënyrë që të rritet edhe më shumë ofrimi i shërbimëve sa më cilësore.* |

| I.2 | Objektivi specifik: Avancimi i mbledhjes së të dhënave për të drejtat e njeriut, monitorimit dhe raportimit | | | | | **Progresi në zbatim** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I.2.1 | Hartimi i manualit për krijimin e sistemit të monitorimit të drejtave të njeriut në nivel vendi, në konsultim me shoqërinë civile; | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/ ZQM, ASK ABGJ Ministrite e linjës, Njësia për të Drejtat e Njeriut në Komuna si dhe Zyrtarët për Integrime Evropiane në Komuna dhe Zyrtarët për Barazi Gjinore OHCHR | Manuali i hartuar përcakton hapat dhe procedurat për funksionimin e sistemit të monitorimit të të drejtave të njeriut në nivel vendi | Ka përfunduar Hartimi i manualit ( doracakut për Hapat praktikë të zbatimit për krijimin e një sistemi efektiv të Monitorimit dhe Raportimit të të Drejtave të Njeriut në nivel kombëtar.Mbi bazën e këtij manuali është hartuar Koorniza e Treguesve për të Drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës. |
| 1.2.2 | Zhvillimi i kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut | 2021-2022 | Buxheti dhe **donatorët** | ZKM/ ZQM, Zyra e Komisaritit të lartë për të drejtat e Njeriut OSBE UNICEF UNDP BE KE | Korniza e treguesve për të drejtat e njeriut e miratuar dhe është në përputhje me treguesit global për të drejtat e njeriut. | Është hartuar Koorniza e Treguesve për të Drejtat e Njeriut.<br>Me qëllim që treguesit të ishin sa më të kuptueshëm dhe shterues, metodologjia e hartimit të tyre konsistoi në përgatitjen e treguesve për secilën të drejtë të detyrueshme të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Kjo metodë lehtëson edhe ndarjen e përgjegjësive midis institucioneve të ndryshme, pasi bën më të lehtë identifikimin e treguesve që mbulohen sipas detyrave që u ka ngarkuar ligji institucioneve përkatëse.<br>Korniza e Treguesve për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, është aprovuar në mbledhjen e rradhës së Qeverisë së Kosovës , datë 13.12.2023, me Vendim Nr.20/178. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ABGJ<br>IAP<br>OHCHR | | |
| I.2.3 | Zhvillimi i sitemit (bazës së të dhënave për grumbullimi, analizimin dhe monitorimin e zbatimit të treguesve për të drejtat e njeriut). | 2022 | Buxheti dhe donatorët | **ZKM/ ZQM,**<br>ASK<br>ABGJ<br><br>Ministritë e linjës, Komunat UNICEF, Komisioni Evropian Këshilli i Evropës OSBE OHCHR | Sistemi për monitorimin e zbatimit të kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut gjeneron të dhëna sipas standardeve të përcaktuara | Sistemi për monitorimin e zbatimit të kornizës së treguesve për të drejtat e njeriut do të vihet në funksion gjatë vitit 2024, pasi të ngriten kapacitetet e institucioneve përkatëse për monitorim dhe raportim konform Kornizës së Treguesve për të Drejtat e Njeriut.<br>Është hartuar Formati i raportimit lidhur me monitorimin e zbatimit të Kornizës së Treguesve të të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës, dhe gjatë vitit 2024 do të testohet për herë të parë zbatimi i kësaj koornize të treguesve për të drejtat e njeriut |
| I.2.4 | Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave cilësore lidhur me të drejtat e njeriut, të ndara sipas gjinisë;moshës, aftësisë së kufizuar, përkatsisë etnike | 2022-2023 | Buxheti dhe donatorët | ZKM/ ZQM,<br>ASK<br>ABGJ<br>Ministritë e linjës, Komunat UNICEF,<br><br>Komisioni Evropian Këshilli i Evropës OSBE OHCHR | Të paktën 40 zyrtarë të trajnuar në mbledhjen, përdorimin dhe analizën e të dhënave; | ZQM-rë me mbështetjen projektit projektit Human Capacity Development Fund (HCDF)[1], asistenca teknike në kontekst të integrimit Evropian ka organizuar me datë; (24-28) Prill dhe me datë;( 02-04) Maj 2023- Trajnim dy ditore- lidhur me prezantim e Kornizës së Indikaorëve (treguesve) për të drejtat e njeriut. Qëllimi i trajnimit ishte -Aftësimi i mëtejshëm i zyrtarëve për të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminim nga institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe institucione të tjera publike të pavarura të Kosovës për t'u aftësuar më the për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave publike për të drejtat e njeriut, me fokus në Treguesit e të drejtave të njeriut dhe përdorimi praktik i tyre, gjatë procesit të hartimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të politikave.<br>IKAP ka ofruar, organizuar trajnime në fushën "Të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Sistemi Evropian i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut", janë trajnuar 25 pjesemarres dhe "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë" janë trajnuar 23 pjesëmarrës, pra në të dy temat e trajnimeve janë aftësuar /trajnuar 48 pjesemarrës (20 femra dhe 28 meshkuj) |

[1] Në kuadër të programit të asistencës së donatorëve, Dukati i Madh i Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë po mbështesin përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përmbushur kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE). Për këtë qëllim, është krijuar një Institucion për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF) për të mbështetur zbatimin e MSA-së.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | etj. | | | | Databazat funksionale dhe të përditësuara me të dhëna të ndara sipas gjinisë,moshës, aftësisë së kufizuar, përkatsisë etnike etj. | Ekziston databaza funksionale dhe e përditësuar me të dhëna të ndara sipas gjinisë,moshës, aftësisë së kufizuar, përkatsisë etnike, përgatitjes profesionale, trajnime, kurse etj (FSK-MM)<br>Me vendimin nr. 765 të datës 21.07.2023 të nxjerr nga z.v.Drejtoresha e Përgjithëshme e Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK)-së është themeluar Komiteti për Barazi Gjinore në kuadër të APRK-së i ngarkuar me udhëheqjen e zotimeve të parashikuara në letrën e përkushtimit të nënshkruar me datë 15.05.2023 në kuadër të,, Programit të Vulës së Barazisë Gjinore në Institucione Publike'' e mbështetur nga UNDP-ia, pra APRK është Institucioni I pare publikë në Kosovë që ka nisur këtë program me qëllim të promovimit të politikave që janë më të përgjegjëshme ndaj gjinis efektive, efikase dhe të synuara për nevojat e të gjithë nerzëve, veçanërisht të grave në situate të cënueshme.<br>Është mbajtur trajnimi për 45 zyrtarë të APRK-së lidhur me temën në fjalë, nga Raporti me të gjetura është rekomanduar që të fillohet me hartimin e legjislacionit të ri përmes Koncept dokumenti. |
| I.2.5 | Raportimi vjetor i progresit për të drejtat e njeriut | 2021-2023 | Buxheti dhe donatorët | ZKM/ ZQM, Ministrit, Komunat, Agjensionet | Raporti vjetor mbi situatën e të drejtave të njeriut i publikuar | Zyra për Qeverisje të Mirë çdo vit harton Raport Vjetor lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në vend. Në raport pa mëdyshje evidentohet progresi dhe sfidat e institucioneve karshi obligimeve kushtetuese, ligjore dhe institucionale për mbrojtjen, respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut si dhe rekomandimet të cilat adresohen në fushat e ndryshme të drejtave të njeriut. |
| **I.3** | **Objektivi specifik: Rritja e Transparencës dhe lehtësimi i qasjes në informata dhe dokumente publike** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| I.3.1 | Të monitorohet me përpikëri respektimi i afatit kohor për qasje në dokumentet publike nga institucionet publike dhe zyrtarët përgjegjës | Në vazhdimësi | Nuk ka nevojë për buxhet | Agjencia për Informim dhe Privatësi – (AIP) Ministritë Komunat | Është siguruar qasje në informata dhe dokumente publike komfor afatit kohor të përcaktuar me legjislacionit në fuqi nga | Më qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike, AIP në fushën e qasjes në dokumente publike sipas autorizimeve të saja ligjore, ka vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në dokumente publike, duke pranuar dhe shqyrtuar ankesat e qytetarëve dhe duke monitoruar faqet zyrtare të institucioneve publike për ofrimin e informacioneve publike me vetiniciativë. Përveç kësaj, AIP ka vazhduar të obligojë të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të raportojnë mbi numrin e kërkesave për qasje për periudhën njëvjeçare. Gjatë monitorimit, AIP ka gjetur se institucionet publike në përqindje më të lartë respektojnë kriteret e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike, lidhur me publikimin e dokumenteve në faqet e tyre zyrtare .<br>Pas zgjedhjes së Komisionerit për Informim dhe Privatësi dhe pas funksionalizimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka rënë dukshëm |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ana e institucionev e publike | numri i ankesave që paraqiten në IAP<br>Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka pranuar 11 ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, 8 nga këto janë shpallur të papranueshme, ndërsa 3 të tjerat janë hapur për hetim. Hetimet për 3 ankesat kanë përfunduar dhe është konstatuar se palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk i kanë respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.<br>Nga një total prej 7561 kërkesave për qasje në dokumente publike, 7408 kanë qenë të lejuara, pra iu është dhënë qasje në dokumente publike. Kjo tregon një nivel të lartë të transparencës në institucionet publike, njëkohësisht numri i shtuar i kërkesave për qasje pranë këtyre<br>institucioneve paraqet një vetëdijesim të shtuar të qytetarëve për të realizuar të drejtën e tyre sa i përket qasjes në dokumente publike.<br>Ministri e Shëndetësisë ka pranuar 83 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku vetëm për dy kërkesa është dhënë qasje e pjesshme. Ndërsa për 81 kërkesa është ofruar qasje e plotë brenda afatit kohor.<br>**Ministria e Drejtësisë për periudhën janar – dhjetor 2023 ka pranua 41 kërkesa për qasje,** 38 kanë marrë përgjigje të plota, 1 të pjesshme dhe 2 janë refuzuar. Kërkesat e pjesshme dhe te refuzuar janë komfor ligjit për Qasje në Dokumente Publike " e drejta e privatësisë..." dhe "rasti nën hetime..."<br>Gjatë vitit 2023 kemi pranuar 37 kërkesa për qasje dhe të gjitha kërkesat janë trajtuar dhe kanë marr përgjigje, pra janë aprovuar. Nuk ka asnjë përgjigje të refuzuar.<br><br>Po ashtu në ueb-faqe i kemi të publikuara të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me Ligjin<br>https://me.rks-gov.net/qasja-ne-dokumentet-publike/<br>Linku:<br>https://me.rks-gov.net/qasja-ne-dokumentet-publike/<br><br>Gjatë vitit 2023, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, janë adresuar gjithsej 42 kërkesa për qasje në dokumente publike, për të cilat jemi përgjigjur brenda afatit ligjor bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike Nr. 06/L-81. Nga gjithsej këto kërkesa, 18 prej tyre kanë qenë të adresuara nga gazetarët e mediave vendore, 5 prej OJQ-ve, 8 nga qytetarët dhe 11 prej tyre kanë të profileve të ndryshme.<br>Ndërkaq, dokumentet që janë kërkuar nga parashtruesit e këtyre kërkesave për qasje kanë qenë si në vijim: 10 për shpenzimin e parasë publike, 13 dokumente administrative, 12 dokumente ligjore dhe nënligjore, 2 dokumente lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe 5 të tjera. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Numri i gjobave të shqiptuara ndaj institucioneve publike dhe zyrtarëve përgjegjës, të cilët nuk e kanë respektuar afatin kohor sipas dispozitave të këtij ligji. | Në Komunën e Malishevës për vitin 2023 kane qene 22 kerkesa ,për të gjitha kërkesat është lejuar qasja<br>**Transparenca Komunale**<br>Në këtë fushë janë aplikuar 7 tregues me 26 të dhëna të cilat japin informata për publikimin e akteve, planeve, buxhetit, kritereve të ueb-faqeve, qasjen në dokumentet publike, publicitetin e seancave të kuvendit, etj.<br>Sa u përket performancës sipas tregueseve, përqindja më e lartë është në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet zyrtare shprehur me 99.61%.<br><br>AIP, deri tash, ka shqiptuar 4 gjoba administrative ndaj institucioneve publike. |
| I.3.2 | Agjencia për Informim dhe Privatësi të organizon dhe mbanë konferenca, seminare dhe trajnime për zyrtarët publik përgjegjës, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë lidhur me promovimin dhe ngritjen e | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorë t | Agjencia për Informim dhe Privatësi – AIP ZKM-ZQM | Numri i aktiviteteve të organizuara qoftë (konferenca, seminare dhe trajnime),<br><br>Të paktën 40 zyrtarë të trajnuar | AIP -orgaanizon konferenca, seminare dhe trajnime në baza periodike, në shënim të datave specifike dhe sipas kërkesës së institucioneve publike.<br>Ndërsa, për realizimin e së drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike, AIP ka zhvilluar aktivitete promovuese për të rritur ndërgjegjesimin e qytetarëve për të qenë pjesë e vendimmarrjes institucionale, në njërën anë dhe në anën tjetër, për të ngritur përgjegjësinë institucionale për rritjen e transparencës për punën e tyre dhe ofrimin e llogaridhënies për qytetarët.<br>Ka vazhduar ,Promovimi i së drejtës për qasje dhe njoftimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve për procedurat e realizimit të së drejtës së tyre për qasje në dokumente publike, përmes paraqitjeve në emisione televizive, debate, tryeza,konferenca..<br>Aktivitetet promovues janë pjesë e panadashme e punës së Agjencisë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | kapaciteteve lidhur me realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. | | | | | |
| I.3.3 | Të evidentohen rastet e ankesave të ushtruara në sektorin publik dhe privat mbi bazat e diskriminimit të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | IAP Ministrit Komunat Inspektora ti i Punës | Numri i ankesave të paraqitura për diskriminim ,si dhe numri i rasteve te iniciuara ex-officio për diskriminim në sektorin publik dhe privat | Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka vazhduar të pranoj ankesa me pretendim për diskriminim. Bazat e diskriminimit të pretenduara nga ankesat e pranuara kanë të bëjë me etninë, gjininë, moshën, aftësinë e kufizuar, mendimet politike, gjuhën, gjendja shëndetësore, diskriminim në vendin e punës, ushtrimi i profesionit si dhe baza tjera. Gjithashtu, janë hapur edhe raste sipas detyrës zyrtare.<br>Gjatë vitit raportues janë mbyllur 130 raste lidhur me ankesat me vendim për refuzim mbi ndonjërën nga bazat e përcaktuara me nenin 22 të Ligjit për Avokatin e Popullit. Ndërsa, janë publikuar 6 raporte me rekomandime me konstatime për diskriminim<br>Sipas informacioneve të Inspektoratit të Punës, numri i ankesave për shkak diskriminimit është 2 –gra lehona dhe numri i rasteve të inicuara ex officio është 3 raste të gjetura me rastin e inspektimeve të inspektorëve në subjektet punuese (Inspektorati i punës). |
| **I.4** | **Objektivi specifik: Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut siç garantohet nga korniza kushtetuese dhe legjislative e Kosovës dhe instrumentet direkt të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut**<br>**Progresi në zbatim** | | | | | |
| I.4.1 | Institucionet kompetente për monitorimin e zbatimit të ligjeve për të drejtat e njeriut, mbrojtjen nga diskriminimi dhe minoriteteve të raportojnë dhe hartojnë raporte vjetore mbi zbatimin e | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | ZQM/ZKM ABGJ ZÇK Komisionari për Gjuhët Ministritë Komunat IAP Inspektora ti i Punës | Raportet mbi monitorimin e zbatimit të ligjeve të hartuara dhe publikuara | Zyra për Qeverisje të Mirë konform Nenit 10 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi paraqet raport çdo vit në Qeverinë e Kosovës për zbatimin e këtij Ligji.<br>Zyra për Qeverisje të Mirë ka hartuar 3 raporte vjetore për Vitin 2021,2022, 2023 lidhur me zbatimin e Ligjit NR. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI .<br>Gjithashu është hartuar dhe miratuar nga Qeveria Raporti për Vlerësimin Ex-post të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<br>Raporti mbi Zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi për vitin 2023 , bazuar në rastet e raportuara në Platformën Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian" në katër gjuhë ; shqip, serbisht, anglisht dhe në gjuhën rome.<br>Zyra e Komisonerit për Gjuhët në vazhdimësi monitoron dhe harton raporte për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | ligjeve | | | | | zbatimn e Ligjit LIGJI NR. 02/L-37 PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE.<br>Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ-ja) bën monitorim te vazhdueshëm të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e gjuhëve. Perveç aktiviteteve te shumta, gjate vitit 2023 ZKGJ-ja ka trajtuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) ankesa, të pranuara nga qytetarët. 14 (katërmbëdhjetë) janë zgjidhur, ndërsa 2 (dy) janë duke u trajtuar në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit. Ankesat i adresohen shkeljeve të pretenduara të institucioneve të ndryshme të nivelit qendror dhe të nivelit lokal, për mosrespektim të Ligji nr. 02/l-37 për përdorimin e gjuhëve;<br>REKOMANDIME: Bazuar në ankesa, monitorim, si dhe në komunikim ndërinstitucional, ZKGJ-ja ka dhënë rekomandime për: Administratën Tatimore e Kosovës(ATK), Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK), Spitalit Rajonal të Prizrenit, Komunës së Fushë Kosovës, Komunës së Klinës, Komunës se Pejës, Komunës së Kamenicës, për ASHI, ZKM-së për Platformë, Komunës së Ferizajt, Komunës së Obiliqit, Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, Komunës së Lipjanit, Komunës së Prishtinës, MKRS-së për konkurs, MINT-it, MSH-së, Ministrisë së Bujqësisë, KQZ-së, MAPL-së, Institutit të Mjekësisë Ligjore, me të cilat ka kërkuar që të zbatohet Ligji për përdorimin e gjuhëve; |
| I.4.2 | Të themelohet Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizim të legjislacionit drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorë t | Zyra e Komisione rit për Gjuhët | Është themeluar Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizimi n e legjislacionit në kuadër të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, e cila do të përmirësojë praktikën e përkthimit në procesin legjislativ dhe të fusë një proces të | Është krijuar Grupi Punues për formimin e Njësisë, me vendim të Kryeministrit më 08.11.2022 dhe deri më tani janë mbajtur dy punëtori dhe një vizitë studimore, në Qendrën e Shërbimeve Gjuhësore në Kancelarinë Federale Zvicerane dhe në MPJ të Zvicrës, në Bern.<br>Deri më tani janë harxhuar 9.000 euro ,nga shuma e përgjithshme që është paraparë për vitin 2022 (30.000)<br>Grupi punues për themelimin e Njësisë për harmonizim dhe kontrollim gjuhësor ka përfunduar punën e vet të caktuar sipas vendimit. Ka përpiluar rekomandimet dhe i janë dërguar qeverisë. Rekomandimet janë integruar në dy draft rregullore të Qeverisë dhe pritet të integrohet edhe në Rregulloren për rregullim të brendshëm të qeverisë. Me të përfunduar rregullorja në fjale, njësia do të funksionalizohet, konform vendimit që Qeveria ka marrë vendimin për krijimin e Njesisë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | redaktimit, lekturës dhe harmonizimin gjuhësor, me qëllim të harmonizimit të legjislacionit shumëgjuhësh me standarde të larta. | |
| I.4.3 | Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për procesin e përafrimit, filtrimit dhe harmonizimit të legjislacionit vendor me kërkesat e BE-së dhe *acquis communautaire*. | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | Ministria përkatëse ZL/ZKM IKAP | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar | IKAP gjatë vitit 2023 ka organizuar 1 kurs trajnimi rreth procesit të përafrimit, filtrimit dhe harmonizimit të legjislacionit vendor me kërkesat e BE-së si dhe 2 kurse rreth acquis communautaire.<br><br>Në trajnimin "Korniza ligjore dhe teknikat për perafrimin e legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian, janë trajnuar 37 pjesëmarrës dhe trajnimi ka zgjatur 9 ditë me 3 grupe.<br><br>acquis communautaire janë zhvilluar dy kurse:<br><br>Kapitulli 1_Levizja e lire e mallrave dhe Kapitulli 3_ E drejta e themelimit dhe liria per të ofruar shërbime, janë aftësuar/trajnuar 24 pjesemarres në 6 ditë trajnim |
| I.4.4 | Të bëhet vlerësimi ex-post i ligjeve[2], konkretisht të bëhet vlerësimi ex-post i Ligjit për Mbrojtjen | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **ZL/ZKM ZQM/ZKM** Ministritë Komunat OSBE BE KE | Raporti i vlerësimit ex-post të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi i hartuar dhe | Me vendimin nr.139/2022 të nxjerr nga zv.Sekretari i Përgjithëshem i Zyrës së Kryeministrit, është themeluar grupi punues për hartimin e Raportit të vlerësimi ex-post të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,Gjatë vitit 2023 ka filluar punën grupi punues për vlerësimin ex-post të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili ka dal me raport vlerësues lidhur me veprimet pasuese që do ti ndërrmer Qeveria lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së Republikës |

[2]Vlerësimi ex-post shihet si shumë i rëndësishëm në sigurimin e zbatimit të legjislacionit primar e sekondar në mënyrë efektive dhe që legjislacionit ti bëhet rishqyrtimi i duhur, gjithashtu është proces i vetëvlerësimit i bërë nga qeveria në politikat e veta dhe rezultatet e arritura

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nga Diskriminimi | | | | publikuar | së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023. |
| 1.4.5 | Zyra ligjore e Kryeministrit të organizon, promovon dhe siguron mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët e departamenteve ligjore dhe fushave përkatëse lidhur me zbatimin e vlerësimit ex-post në bashkëpunim me IKAP-in | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | **ZL/ZKM** Ministritë IKAP | Janë mbajt trajnimet për zyrtarët e departamenteve ligjore dhe fushave përkatëse lidhur me zbatimin e vlerësimit ex-post<br><br>Të paktën 50- të zyrtarë të trajnuar | Zyra Ligjore e ZKM-së, në bashkëpunim me IKAP-in gjatë vitit vitit 2021 ka mbajtur gjithsej 3 trajnime për vlerësimin ex-post të legjislacionit. Gjat vitit 2023 janë realizuar 2 trajnime për vlerësimin ex-post të legjislacionit për zyrtarët ligjor.<br><br>Trajnimi me temë “Vlerësimi Ex-ante dhe Ex-Post i legjislacionit”<br>Për 3 vite (2021-2023)-janë trajnuar më tepër se 70 zyrtarë |
| 1.4.6 | Raportimi i vlerësimit sistematik i ligjshmërisë të akteve të komunave në aspektin e sigurimit të përputhmërisë me aktet dhe politikat e nivelit qendror të qeverisjes | 2021 2023 | Buxheti i Kosovës, Buxheti i paraparë në kuadër të Strategjisë Sektoriale e për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 | **MAPL** Komunat | Sistemi i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të komunave me ministritë e linjës, i përfunduar dhe funksional | Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QKR) Nr-06/2021, për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK Nr.10.2019 për shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave.<br>MAPL, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave përmes Divizionit të Monitorimit të komunave në përputhje me përgjegjësitë ligjore të përcaktuara më Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht në nenin 86, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës harton raporte periodike lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave për këtë periudhë. Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht MAPL,në përgjithësi ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendeve të komunave është bërë në afatin e përcaktuar ligjor brenda 7 dite nga miratimi i akteve në kuvendin e komunës.<br>Aktet të cilat miratohen në Kuvendin e Kryeqytetit, Sektori i Kuvendit i dërgon në Ministri për konfirmim të ligjshmërisë, dhe në momentin që marrin konfirmimin e ligjshmërisë, ato akte publikohen në web faqen zyrtare të Komunes dhe hyjnë në fuqi. Ndërsa aktet të cilat nxjerren nga Kryetari publikohen në web faqen zyrtare të Kryetarit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **II.** | **Objektivi strategjik: Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut** | | | | | |
| **II.1** | **Objektivi specifik: Fuqizimi i sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ)** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| **II.1.1** | Monitorimi i procesit të zbatimit të rekomandimeve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | **ZKM/ZQM** Ministrit Komunat Institucion i i Avokatit të Popullit (IAP) ABGJ | Raporti i monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave i hartuar | Me qëllim të prioritizimit të procesit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Albin Kurti iu drejtua me një letër zyrtare ministrive të linjës që të kenë prioritet shqyrtimin e secilit rekomandim që është adresuar tani dhe atyre që do të adresohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me synim ngritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe respektimin e afatit ligjor prej 30 ditësh për të dhënë të gjitha përgjigjet e kërkuara nga Avokati i Popullit.Zyra për Qeverisje të Mirë në vazhdimësi monitoron dhe harton raporte lidhur me situatën e zbatimit të rekomandimeve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave . |
| **II.1.2** | Hartimi i një dokumenti (udhëzuesi drejtuar autoriteteve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes lidhur me sigurimin e përgjigjeve të shpejta dhe brenda afatit ligjor për të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit | 2021 | Financimi i donatorëve | **ZKM/ZQM** Komisioni Parlamentar për të drejtat e njeriut Ministritë Komunat Institucion i i Avokatit të Popullit (IAP | Është hartuar udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit<br><br>Sistemi elektronik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit (në nivelin lokal dhe qendror), i | Udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është hartuar.<br><br>Mbi bazën e Udhëzuesit funksionon sistemi ku evidentohen të gjitha rekomandimet të cilat institucioni i Avokatit të Popullit i adreson te institucionet ,nvarësisht prej fushës dhe natyrës së të drejtave të cilat i përmban rekomandimi. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | funksionalizuar dhe gjeneron të dhëna<br><br>Autoritetet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes respektojnë afatin ligjor për kthim të përgjigjeve brenda afatit ligjor për kërkesat dhe rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit | Bazuar në obligimet ligjore në baze të Ligjit nr.05\L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë monitoron në mënyrë të vazhdueshëm zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit<br>Është krijuar një kulturë institucionale për respektimin e detyrimeve kushtetuese për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe për t'i paraqitur të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, brenda afatit ligjor në pajtim me ligjin. Vazhdimisht ka pasur rritje të zbatimit të rekomandimeve, ashtu që niveli i zbatimit të rekomandimeve ka arritur në 28%, që është dukshëm më i lartë sesa në vitet e kaluara. Megjithatë kërkohet më shumë angazhim dhe përkushtim për rritjen e zbatimit deri në arritjen e nivelit kur zbatohen të gjitha rekomandimet.<br>Përqindja e zbatueshmërisë së rekomandimeve nga autoritetet publike përgjegjëse<br>Nga rastet e shqyrtuara gjatë vitit 2023, autoriteteve u janë adresuar **836 rekomandime**, nga të cilat **300 janë rekomandime nga hetimet e përfunduara në këtë vit**, ndërsa **536** janë rekomandime janë të bartura nga viti paraprak**,** Statusi i procesit të zbatimit të rekomandimeve është si në vijim:<br>**Rekomandime të zbatuara 28%**<br>**Rekomandime të pazbatuara 6%**<br>**Rekomandime pjesërisht të zbatuara 16%**<br>**Rekomandime në pritje për zbatim 50%** |
| II.1.3 | Qeveria të zbaton rekomandimet e Komisoneve Parlamentare, Trupave ndërkombëtare, Avokatit të Popullit, Komisonerit për Gjuhët, Këshillit | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | ZKM/ZQM Ministritë, Komunat Agjensionet , Institucionet e Drejtësië, si dhe të gjitha | Numri i rekomandimeve të zbatuara si dhe raportet mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara | Qeveria e Kosovës është duke i dhënë prioritet zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë. Në funksion të zbatimit të Rekomandimit të adresuar nga Komisioni Parlamanetar për të Drejtat e Njeriut përmes Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ku rekomandohet që Qeveria pas analizës gjithëpërfshirëse postlegjislative të hartojë Projektligjinë për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga Diskriminimi ose eventualisht të hartoj Ligjin e ri, Zv.Sekretari i përgjithshëm i ZKM- ka marrë Vendim Nr.139/2022, për themelimin e grupit punës për hartimin e Raportit të vlerësimit Ex-post të Ligjit Nr.05/L-021 për mbrojtjen nga Diskriminimi. Raport i Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi është miratuar në Mbledhjen e 159-të të Qeverisë së |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Këshillit Konsultativ për Komunitete ,OJQ-ve, lidhur me zbatimin e ligjeve, politikave dhe të drejtave të njeriut. | | | institucionet të cilave u adresohen rekomandimet | nga mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor | Republikës së Kosovës, me Vendim Nr. 05/159, të datës 13.09.2023.<br><br>Me datë **03-04 Prill 2023**, në Kosovë ka qëndruar Znj. Irene Khan, Raportuese Speciale e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të lirisë së mendimit dhe shprehjes.<br>Qëllimi i vizitës ishte shqyrtimi në frymën e bashkëpunimit dhe dialogut i gjendjes së të **drejtës në liri të mendimit dhe shprehjes ,** brenda kontekstit të mandatit të raportuesit special.<br>Është realizuar me sukses vizita e Z. Fabian Salvioli, Raportues Special i Kombeve të Bashkuara për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garantimit të mos-përsëritjes. Angazhimi i Qeverisë për adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe nismat për drejtësi tranzicionale, ishin tema të takimit të perfaqsuesve të institucioeve të Kosovës me Z.Fabian Salvioli, Raportues Special i Kombeve të Bashkuara për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garantimit të mos-përsëritjes. (Zyra për Qeverisje të Mirë përmes Zyrës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të UNMIK-UT e ka kordinuar tëre procesin e Vizitës së Raportuest Specila në Kosove dhe Aranzhimit të takimeve me përfaqsueit e institucioneve relevante.<br>Raportuesi Special Z.Fabian Salvioli ,për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, dëmshpërblimit dhe garantimit të mospërsëritjes e ka dërguar versionin e avancuar dhe të pa redaktuar të raportit nga vizita e tij e realizuar në Kosovë në Nëntor të vitit të kaluar 2022. Draft Raporti i hartar nga Raportuesi Special Z.Fabian Salvioli gjatë muajit Maj 2023, është komentuar dhe plotësuar me informacione shtese nga ana e Institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës ,dhe pas kemi pranuar Raportin final nga ana e Raportuesit Special i njëjti është përcjell te institucionet kometente dhe është kërkuar nga të njëjtat që ti ndërmarinë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e të gjeturave në kuadër të Raportit.<br>Zyra për Qeverisje të Mirë si mekanizëm kryesor për koordinimin e procesit të raportimit karshi trupave të ndryshme ndëkombëtare , ka themeluar ;<br>**1. Grupin Teknik të Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare**<br><br>Institucionet e Kosovës vazhdojnë me vëmendje të veçantë të sigurojnë të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e saj pa dallime përmes kushtetutës dhe kornizës ligjore dhe përmes zbatimit të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.<br>Bazuar në kërkesën e dërguar nga Këshilli i Evropës për komentet përfundimtare për Opinionin e ciklit të 5-të, komentet përfundimtare i janë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | dërguar UNMIK-ut më 16.05.2023 pasi janë konsultuar të gjitha institucionet e Kosovës.<br>Qeveria e Kosovës ka vlerësuar shumë ndarjen e draft Opinionit të ciklit të 5-të të Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kornize për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe përfshirjen e komenteve të institucioneve të Kosovës në draft-Opinion të ciklit të 5-të nga Komiteti Këshillëdhënës. Është më rëndësi të theksohet që për herë të parë draft opinioni është ndarë me qeverinë e Kosovës për komete nga Komitetit Këshillëdhënës të Këshillit të Evropës.<br>Grupit Teknik i Punës për Koordinimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është takuar me 16.05.2023, me qëllim të diskutimit të Opinionit të 5-të përfundimtar për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare nga Këshilli i Evropës dhe aktivitetet që synohen të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve . |
| II.1.4 | Krijimi i ekipit të përbashkët për të koordinuar procesin për zbatimit e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. | 2021 | Buxheti i Kosovës | **ZKM/ZQM**<br>Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP)<br>ABGJ | Ekipi i përbashkët funksional,realizon takime të rregullta , koordinon dhe monitoron procesin e zbatimit të rekomandimeve, adresuar institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes. | Ekipi i përbashkët për koordinimin dhe monitorimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve, adresuar institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes është funksional. Natyra e punës se ekipit fokusohet me tepër në shkëmbim, analizimin dhe krahasimin e të dhënave dhe informatave lidhur me statusin dhe ecurin e tërë procesit të zbatimit të Rekomandimeve të Avokatit të Popullit.Bashkëpunim dhe kontaktet me Avokatin e popullit dhe zyrtarët kompetent janë shumë të shpeshta dhe në nivel shumë të mirë profesional dhe kolegial. |
| II.1.5 | Inspektorati i punës ti jap prioritet hetimit dhe trajtimit të ankesave lidhur me rastet e pretenduara të diskriminimit të | Në vazhdimësi | Buxheti është i paraparë në kuadër të Strategjia Sektoriale e | **Inspektorati i Punës**<br>ZKM/ZQM<br>Ministritë<br>Komunat<br>Institucion | Numri i ankesave të pranuara dhe të hetuara lidhur me bazat e diskriminimit në sektorin | **Inspektorati i Punës;** Numri i ankesave për diskriminim është 2 -gra lehona |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shkaktuara në sektorin publik dhe privat<br><br>Ngritja e kapaciteve të Inspektoratit të Punës, në raport me diskriminimin, me fokus diskriminimin në baza gjinore; | | MPMS-së 2018-2022<br><br>Plani Kombëtar për Barazi Gjinore | i i Avokatit të Popullit (IAP)<br><br>Bashkimi i Sindikatave të Panvarura të Kosovës (BSPK-ja) Bizneset e sektorit privat | publik dhe privat, te ndara sipas gjinise dhe etnise;<br><br>Numri i hetimeve ex officio lidhur me hetimin e rasteve për diskriminim në sektorin publik dhe privat;<br><br>Numri i gjobave të shqiptuara;<br><br># Të paktën 20 Inspektore të trajnuar në trajtimin e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore, diskriminimin në punësim;<br><br># Të paktën 3 (tre) Inspektore gra të rekrutuara | Numri i hetimeve ex officio lidhur me hetimin e rasteve për diskriminim në sektorin publik dhe privat është 3 raste. Sipas etnisë nuk kemi pasur raste të diskriminimit.<br><br>Numri i gjobave të shqiptuara për raste diskriminimi është 5 gjoba.<br>26 inspektor të trajnuar Ma shumë se 3 femra te trajnuara.<br><br>IKAP_në bashkëpunim me Inspektoratin e Punes për të ngritur kapacitetet e stafit dhe nevojave për trajnim ka organizuar trajnimin; **Puna e denjë, siguria dhe shëndeti në punë: Hyrje në perspektivën gjinore**<br><br>Ky trajnim është mbështetur nga UN Women dhe është organizuar në kuadër të projektit "**Komponenta gjinore në promovimin e punës së denjë përmes menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë**", i cili është implementuar nën menaxhimin e ILO dhe financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë.<br><br>Në këtë aktivitet u trajnuan 24 pjesemarrës në 4 ditë trajnim.<br><br>6 femra dhe 18 meshkuj. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.6 | Të përmirësohen sistemet e menaxhimit të të dhënave. Të regjistrohen ankesat e pranuara, inspektimet e ndërmarra dhe masat disiplinore të filluara, duke i ndarë këto sipas gjinisë së punonjësve, gjinisë së kryerësit të pretenduar | 2022 | Buxheti i Kosovës | **MFPT/ Inspektorati i punës** | Sistemi për evidentimin dhe menagjimin e të dhënave funksionale duke ju referuar diskriminimit me bazë gjinore në lidhje me punën, të kategorizuara sipas llojit të shkeljes, gjinisë së personit që parashtron ankesën dhe personit të cilit i drejtohet ankesa. | Sistemi për evidentimin dhe menaxhimin e të dhënave nuk është funksional. Baza e të dhënave nuk është e instaluar.<br>Edhe më tutje nuk është ndërtuar një sistem funksional për evidentimin e rasteve të diskriminimit. Rastet evidentohen dhe menaxhohen në programin exell sipas raportimeve të drejtë për drejta nga inspektorët e punës. Jemi në process së ndërtimit të data bazës. |
| II.1.7 | Organizimi i forumit për bashkëpunim të strukturuar me aktorët institucional nga ekzekutivi, legjislativi, gjyqësori, avokati i popullit, policia dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me të | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | ZKM/ZQM Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ABGJ | Konferenca për vlerësimin e situatës së të drejtat e njeriut dhe shënimit te Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut e organizuar çdo vit | Gjatë muajit dhjetor në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut organizohen aktivitete të ndryshe nga ana e Institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes.<br>Zyra për qeverisjes të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim-Zyra e Kryeministrit dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR KS), kanë organizuar Konferencën kushtuar 75-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe në kuadër të edicionit të 10-të të Javës së të Drejtave të Njeriut.<br><br>Gjithashtu aktivitete për shënimin e Ditës Ndërkombëtre për të Drejtat e Njeriut janë organizuar edhe në komuna.<br>- Në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut – është lansuar videospoti i përgatitur nga Koordinatorja e NJKDNJ-së të komunës së |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | drejtat e njeriut. | | | | | Kamenicës lidhur me vetdijësimin e qytetarëve mbi të Drejtat e Njeriut. |
| II.1.8 | Të respektohen dhe zbatohen me përpikëri rekomandimet e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës i cili vepron në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e institucioneve kompetente të cilave u është adresua rekomandimi/et. | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) SHKK/MD Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës MSH Departamenti për Shëndetësi në në burgje QKRMT Policia e Kosovës | Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të realizuara<br><br>Numri i rekomandimeve të adresuara te institucionet kompetente<br><br>Numri i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet të cilave u janë adresuar rekomandimet | Gjatë vitit 2023, MKP-ja realizoi 61 vizita pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si: stacionet policore, qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese, qendrën për migrantë, qendrën për të riatdhesuarit, institucionet e shëndetit mendor, institucionet e kujdesit social si dhe pikat kufitare.<br><br>Raportet me rekomandime të publikuara gjatë periudhës për të cilën po raportohet. MKP-ja ka publikuar njëzet e pesë (25) raporte me rekomandime pas vizitave të realizuara në institucionet e monitoruara. Përmes këtyre raporteve MKP-ja ua ka adresuar autoriteteve kompetente 112 rekomandime me qëllim të avancimit të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.<br><br>Autoritetet kompetente zbatuan 38 rekomandime, pjesërisht të zbatuara 22 rekomandime, 51 janë në pritje për t'u implementuar dhe 1 rekomandim i paimplementuar.<br><br>Policia e Kosovës të gjitha raportet me rekomandime nga Mekanizmi Kombetar për Prandalimin e torturës i trajton me profesionalizëm të larte. Gjatë vitit 2023 nga Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës nuk kemi pranuar raport me rekomandime.<br>Deprtamenti i Burgjeve ka theksue se sivjet nuk ka pas rekomandime dhe ska të dhëna për këtë pjesë. |
| II.1.9 | Monitorimi në mënyrë sistemnatike i mbrojtjes, respektimit dhe zbatimit të drejtave të njeriut në qendrat e | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | IAP/ MKPT MPBAP QKRMT Organizatat Ndërkombëtare | Numri i vizitave të realizuara<br><br>Raportet mbi monitorimin e situatës në qendrat e mbajtjes për | Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës (MKP-së), bënë vizita të rregullta në qendrat e azilit për qëllim vlerësimin e respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.<br><br>MKP-ja gjatë vitit 2023, ka realizuar një (1) vizitë në Qendrën e Pritjes për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mbajtjes për të huajt, Qendra e Azilit në Magure dhe Vranidoll, kushtet e të cilave duhet domosdoshmëris ht të monitorohen ngase mund të afektojnë të drejtat bazike të personave te akomoduar në ato qendra. | | | | të huajt të hartuara dhe të qasshme | Migrantë në Vranidol, si dhe një (1) vizitë në Qendrën e Pritjes për të Riatdhesuarit në Prishtinë.<br><br>Në vitin 2021, Avokati i Popullit kishte rekomanduar që të evitohen mangësitë në funksionimin e sistemit të kanalizimit në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll. Grupi monitorues, gjatë vizitës së fundit, ka vërejtur se në këtë qendër ishin kryer renovimet dhe rekomandimi ishte implementuar.Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e MPB dhe nga Policia e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur komunikim shumë miqësor dhe interaktiv ndërmjet azilkërkuesve dhe zyrtarëve policorë dhe atyre të MPB.<br><br>Sa i përket rritjes së numrit të personelit sipas vlerësimit të nevojave.<br><br>**Në vitin 2023 është rekrutuar një zyrtar për të huaj në QMH.**<br><br>Të evitohen mangesitë sa i përket funksionimit të kamerave të sigurisë në QMH. Në vitin 2023 ne objektin e administratës janë instaluar dhe lëshuar në funksion kamerat e sigurisë.<br><br>Ndersa, në dy objektet A dhe B kamerat kanë qenë të instaluara, por vetëm është bërë mirëmbajtja e tyre sipas nevojës nga kompania e kontraktuar nga MPB për mirëmbajtjen e kamerave<br><br>Ekipi i MKP-së ka realizuar **2 vizita** në Qendrën e Azilkërkuesve në Magure, 1 vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll, 1 vizitë në Qendrën e Përkohëshme të Pritjes për Migrant dhe 2 vizita në Qendrën e Mbajtës për të Huaj në Vranidoll.<br><br>Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës.<br><br>Avokati i Popullit lidhur me vizitën e MKP-së në Qendrën e Mbajtjes për të Huaj ka publikuar raport me rekomandim më 25 korrik 2022.[3] |

[3] Shih Raportin e Avokatit të Popullit për Qendrën e Mbajtjes për të Huaj në Vranidoll, https://oik-rks.org/2022/07/26/raport-i-mkpt-se-per-viziten-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huaj-ne-vranidoll/

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Raporti i MKP-së për Vitin 2023,ende nuk është publikuar. |
| II.1.10 | Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve kur në procedurë penale përfshihen kryerësit me çrregullime mendore.<br><br>Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokuroreve në trajtimin e rasteve te dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktima; | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | Akademia e Drejtësisë KGJK KPK | Numri i trajnimeve të mbajtura;<br><br>Të paktën 60 –të gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar,<br><br>Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor | Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2023 ka ofruar një trajnim ekskluzivisht për Procedurën penale të kryesve me çrregullime mendore. Këtë trajnim e kanë vijuar 27 gjyqtarë dhe 7 prokurorë. Kjo temë ka qenë pjesë e trajtimit edhe në 4 trajnime për Risitë e Kodit të Procedurës penale të mbajtura 2 në janar, 1 në shkurt dhe 1 në qershor 2023. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 26 gjyqtarë dhe 41 prokurorë.<br><br>Për dhunën në familje janë realizuar 14 trajnime në fushën penale me temat si në vijim: Program i Specializuar i Trajnimit Dhuna në familje, Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje, Vlerësimi i rrezikshmërisë në rastet e dhunës në familje, Protokolli për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje, Vktimat e dhunës seksuale.<br>Në këto trajnime kanë marrë pjesë 220 pjesëmarrës. Prej tyre 70 nga radhët e gjyqtarëve dhe 42 nga radhët e prokurorëve, ndërkaq tjerët ishin nga IML, zyrtarë policor, mbrojtës të viktimave, QPS, avokat si dhe zyrtarë të ndihmës juridike falas. |
| II.1.11 | Nga menaxhmenti i burgjeve, të merren masa për të rritur besimin e të burgosurve në sistemin e ankesave, si dhe për të siguruar dhe garantuar | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | SHKK / MD Inspektorati i MD për SHKK | Trajtimi i ankesave të të burgosurve bëhet mbrenda afatit kohor duke ruajtur kofidencialintetin dhe | Numri i ankesave në nivel të SHKK-së (Shkalla e parë dhe e dytë) që janë shqyrtuar gjatë vitit 2021 si dhe deri në muajin gusht 2022 është:<br>144 ankesa nga të burosurit meshkuj madhorë, 9 ankesa nga të miturit dhe 7 ankesa nga të burgosurat femra.<br><br>• Në bazë të informacioneve të ofruara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës , ankesat e të burgosurve vazhdojnë të trajtohen brenda afateve ligjore, e kjo vlerësohet lartë edhe nga zyrtaret që e monitorojn institucionet korrektuese. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | qëndrueshmërinë e sistemit të ankesave . | | | | siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të ankesave<br><br>Numri i ankesave të pranuara dhe shqyrtuara, të ndara sipas gjinise;<br><br>Monitorimi i punës së menaxhmentit brenda burxheve, dhe raportimi në gjetjet; | |
| II.1.12 | Të sigurohen dhe zhvillohen aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe risocializimin e të burgosurve | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | SHKK/MD<br>OJQ dhe Qendrat per pune sociale<br>Komunat Drejtorit e Arsimit | Janë zhvilluar programet dhe aktivitete kultorore, sportive për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve<br><br>Numri i aktiviteteve të realizuara | Gjatë përiudhesë që i referohemi brenda istitucioneve korrektuese janë zhvilluar shumë aktivitete sportive e që vazhdojnë në të gjitha institucionet korrektuese disa prej tyre edhe në bashkpunim edhe me nxënës të shkollave, Po ashtu kanë vazhduar programet rehabilituese me trajnime shtes në veqanti tek të miturit . Gjithashtu për herë të par është mbajt edhe trajnimi proesional edhe në Qendren e paraburgimit në Mitrovicë , ku janë shpërnda edhe certifikata.<br>Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, Qendrat e Aftesimit Profesional (QAP) në kuadër të APRK kanë ofruar mbështetje në organizimin e shërbimeve të trajnimit në kabinetet e qendrave korrektuese, mbështetja në trajnim të trajnerëve të qendrave korrektuese, mbështetje në furnizim me materiale trajnimi, si dhe behet monitorimi i vleresimit të kandidateve. Lëshimi i certifikatave për kandidat që përfundojnë trajnimin, sipas marrëveshjes bëhet nga QAP.<br>Bazuar në të dhënat e QAP-ve gjate vitit 2023 numri i kandidatëve që janë në mbajtje dhe kanë vijujar trajnimet në Qendrat Korrektuese (QK) të vendit është 148 persona;<br>Në vitin 2023 është nënshkruar një Aneks Marrëveshje me Shërbimin Korrektues të Kosovës, me qëllim të mbështetjes së këtij shërbimi në fushën e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | aftësimeve profesionale. APRK përmes Qendrave të Aftësimeve Profesionale, ka mbeshtetur Shërbimin Korrektues të Kosovës duke angazhuar trajnerët e QAP-Mitrovicë (Mitrovicë Veriore) për organizimin e procesit të trajnimeve të stafit të punësuar dhe kandidatëve në mbajtje pranë Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë me lokacion në Mitrovicën Veriore. Kjo marrëveshje synon të ngritë kapacitetet profesionale të stafit dhe të ndihmojë në përgatitjen e kandidatëve ne mbajtje për të hyrë në tregun e punës pas lirimit nga paraburgimi; |
| II.1.13 | Institucionet kompetente të nxjerrin të gjitha aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit për shëndetin mendor dhe për të siguruar që vendosja dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara mendore të jetë në përputhje me atë ligj dhe standardet ndërkombëtare. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | MSH SHKK/MD Departamenti për Shëndetësi në në burgje | Janë hartuar aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr.05/L-025 për shëndetin mendor Është bërë vendosja dhe trajtimi i personave me aftësi të kufizuara mendore në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. | Janë miratuar aktet si në vijim: Udhëzuesi për menaxhimin e të burgosurve me çrregullime mendore (19.08.2022) . Me qëllimin e avancimit të menaxhimit sa më efikas të të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues, ka miratuar Udhëzuesin për Menaxhimin e të Burgosurve me Çrregullime të Shëndetit Mendore gjatë mbajtjes në institucionet korrektuese.<br><br>Me këtë udhëzues përcaktohen dhe sqarohen disa nga procedurat e menaxhimit të të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor. si dhe Rregulla e brendshme për procedurat dhe masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale (19.05.2022).<br>Gjithashtu është hartuar-Koncept dokumenti për shëndet mendore<br>Është aprovuar Plani i Veprimit për shëndetë mendore gjatë dhe pas pandemis COVID 19/ në 2021;<br>Është aprovue Udhërrëfyesi klinik ‘’ trajtimi i alkoolit dhe drogave tjera;<br>Udhërrefyesi Klinik trajtimi i sjelljeve suicidale;<br>Udhërrefyesi Klinik , trajtimi i depresionit;<br>Udhërrefyesi trajtimi i ankthit;<br>Udhezuesi për intervenime promovuese dhe parandaluese në fushën e shëndetit mendore të adoloshenteve. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.1.1 4 | Të organizohen programe sistematike të trajnimit në protokollin e Stambollit për të gjithë **profesionistët shëndetësorë** që mund të thirren për të ekzaminuar personat e privuar nga liria, në mënyrë që të forcojnë të kuptuarit e tyre potencial dhe kufizime të ekzaminimit mjekësor në identifikimin, interpretimin dhe dokumentimin e shenjave të torturës dhe formave të tjera të trajtimit të keq | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MSH**<br>AD<br>MD<br>KGJK<br>KPK<br>PK<br>Oda e Avokatëve të Kosovës<br>Departamenti për Shëndetësi në në burgje (DSHB) | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar<br><br>Të paktën tre sesione informuese të mbajtuara<br><br>Të paktën 60-të profesionist shëndetsorë të trajnuar | Departamenti Shëndetësor i Burgjeve që nga 2017 ka aprovu PSV-të hamonizuara me KE.<br><br>Në PSV të DSHB janë të integruar parimet e Protokolit të Stambollit, për shëndetësi në burgje, sipas rekomandimeve të eksperteve të KE.<br><br>Që nga 2017 çdo, vit përfshirë edhe 2021 DSHB organizon trajnime me komplet stafit, 125 në total, në zbatimin e PSV - përkatësishtë parimeve të Protokolit të Stambollit.<br><br>Gjatë vitit 2022 për shkak të mungeses se mbështetjes me fonde DSHB nuk ka organizuar trajnim.<br>Gjatë vitit 2023 janë mbajtur trajnime të vazhdueshme pa shkëputje nga puna, gjatë orarit të punës. Është kryer trajnimi i 20 infermierëve për punë me SMSF, në 11 njësi shëndetësore të burgjeve. Janë akredituar programe trajnimi nga OIK për trajnime në vend të punës për infermier dhe psikolog.<br>Po ashtu ka pasur trajnime të vazhdueshme nga Këshilli i Evropës për trajnimin e stafit dhe trajnerëve mbi zbatimin e PSV-ve të harmonizuara.<br>Ka pasure dhe angazhime online në vazhdimësi për trajnim adekuat dhe bashkëpunim ndërinstitucional.<br>Në koloninën II.1.10 përfshihen trajnimet për protokollin ku përveq gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë marrë pjesë edhe profesionistë tjerë ligjor. Në këtë rast po i veqoi 9 pjesëmarrës nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML). |
| II.1.1 5 | Të organizohen programe sistematike të trajnimit në protokollin e Stambollit për **avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët**, të cilët mund të përfshihen në | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | MSH<br>AD<br>KGJK<br>KPK<br>PK<br>Oda e Avokatëve të Kosovës<br>Departamenti për | Numri i trajnimeve të mbajtura dhe zyrtarëve të trajnuar<br><br>Të paktën tre sesione informuese të mbajtuara | Në kolonën II.1.10 e u raportua edhe për trajnimet me temë Protokolli për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Janë realizuar tri trajnime me këtë tematikë dhe kanë qenë regjionale duke perfshirë fillimisht regjionin Mitrovicë –Pejë, Regjionin Gjilan Ferizaj dhe Gjakovë si dhe trajnimi i fundit për regjionin e Prishtinës dhe Prizrenit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | çështje gjyqësore përkatëse, në mënyrë që të forcojnë të kuptuarit e tyre potencial dhe kufizime të ekzaminimit mjekësor në identifikimin, interpretimin dhe dokumentimin e shenjave të torturës dhe formave të tjera të trajtimit të keq | | | Shëndetësi në në burgje | Të paktën 60-të profesionist të drejtësisë të trajnuar | |
| **II.2** | **Objektivi specifik: Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i diskriminimit** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| II.2.1 | Organizimi i fushatave, tryezave, debateve dhe aktiviteteve tjera promovuese për pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | ZKM/ ZQM ZL/ZKM ABGJ Ministrit Komunat IAP ZBEK OSBE OJQ-të | Projekte të përshtatura enkas për të promovuar legjislacionin kundër-diskriminimit të zbatuara<br><br>Numri i fushatave dhe tryezave, debateve të organizuara në nivel vendi | Me qëllim të informimit të personave të verbër lidhur me të drejtat të cilat ua garanton pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut,Zyra për qeverisje të mirë ka shtypur dhe publikuar në shkrimin braill; Ligji nr. 05/l -021 për mbrojtjen nga diskriminimi;Ligji nr. 05/l-020 për barazi gjinore; Ligji nr. 05/l-019 për avokatin e popullit.Publikimet e shtypura janë shpërnda te Shoqatat e personave të verbër si dhe në Biblotekën Kombëtare të Kosovës.<br>Në të gjitha aktivitetet, debatet, fushatat kemi promovuar pakon e ligjeve, sidomos në fushatën kundër dhunës, braktisjes së shkollimit, parandalim të dhunës në familje dhe antitrafikimit.<br>- U shënua Dita për internet të sigurt me aktivitet promovuese dhe sensibilizuese, në komuna/ shkolla, sipas udhëzimeve nga MASHTI. U lansua videoja sensibilizuese, u mbajtën sesione me nxënës dhe u shpërndanë udhëzuesit për mbrojtje të fëmijës në internet;<br>- MASHTI zhvilloi dhe realizoi Fushatën njëmujore kundër dhunës në shkolla me moton "Së bashku për shkollën miqësore, sipas programit të fushatës (me video promovuese, emisione televizive, seanca me koordinatorë të cilësisë, ligjërata nga UP, seanca me nxënës, etj.);<br>- (MAShTI), shënoi Muaji i Diversitetit në Arsim" po edhe aktivitete sensibilizuese në shënimin e datave si: Dita Ndërkombëtare të Sindromës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Down, Ditës Ndërkombëtare e Autizmit;<br>- U zhvilluan faktivitetet e fushatës antitrafikimin (3 seanca në Prizren, Gjilan, Ferizaj) dhe asaj të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, me seanca dhe aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla (8 aktivitete me shkolla / komunat: Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Prizren);<br>U shënua Java kundër braktisjes me aktivitete në nivel komunash dhe në nivel qëndror, si dhe u shpërblyen 30 shkolla për raportimet cilësore.<br><br>Te të gjitha këto fushata u adresua e drejat për arsim e cila garantohet me pakon e ligjeve, pa dallim gjini, etnie apo gjendje tjetër.<br><br>ABGJ: ka realizuar dy videospote . Vlera totale është  2900.00 euro:<br>Parandalimin e ngacmimit seksual tek fëmijët<br>https://www.youtube.com/watch?v=EqCHdzoEQmY<br>Parandalimi i dhunës te çiftet adoleshente<br>https://www.youtube.com/watch?v=8RQ7lcjh7OM<br><br>ABGJ ka prezantuar  Ligjin për Barazi Gjinore në Qendrën e Shërbimit Korrektues të Kosovës për  gratë e burgosura në ketë qendër.<br>MBPZHR konkretisht NJDNJ-ka zhvillua aktivitete ku ka promovua të drejtat e njeriut e në veqanti proovimin e legjislacionit kundër diskriminimit.<br>Janë shënuar aktivitete si:<br>- Shënimi i 1 Qershorit- Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve<br>- Është hartuar udhërrëfyesi për punët e rrezikshme të fëmijëve në bujqësi , të gjitha aktivitetet janë mbështet nga ILO- në Kosovë.<br>- Shënimi i Ditës së Fermereve në Prizeren dhe Prishtinë me fermerë dhe prodhuesve të Qumshtit në koordinim me AUVK.<br>- Shënimi i 75 Vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut me fermerë dhe OJQ që punojnë me të drejta e njeriut.<br>- Fushat vetëdisuese për fuqizimin e fermerëve.<br><br>MMPHI në vazhdën e fushatës globale të 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore prezantuam stafit të MMPHI-së pjesa e Mjedisit temën; *Ndikimi i Barazisë Gjinore ne Mjedis*.<br><br>Gjatë vitit 2023 MSH-DDQKSH ka mbajtur 8 tryeza për prezantimin e LMD si dhe të drejtën e ankesës në linjen e ankesave, në linkun linja falas@rks- |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | gov.net jane mbajtur me profesionistet shëndetësorë me infermier në QKMF me përkrahjen financiare nga projekti i AQH-së;<br>Tryezat kanë përfshirë 80 profesionistë shëndetësor të nivelit: udhëheqës i infermieris dhe infermiere.<br>Si dhe 50 përfaqsus të OJQ-ve dhe qytetare nga komuniteti rom ashkali dhe egjiptas për tu njoftuar me ekzistimin e linjës së ankesave në MSh dhe se munden me paraqite ankese nëse kanë pakënaqesit lidhur me shërbimet shëndetësore në vend në linjen e ankesave 080017777`<br>NJDNJ/ në Ministrin e Mbrojtjes , ka mbajtur 7 prezantime me pjesëtar të FSK (burra dhe gra, komunitete) për promovimin e Ligji NR. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji nr. 05/l -020 për barazi gjinore, Ligji nr. 05/l -019 për avokatin e popullit<br>Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/ në kudër të Komunës së Istogut ka punuar në vetëdijesimin dhe sensibilizimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre, kanë organizuar tryeza/aktivitete dhe shënuar data, të cilat kanë të bëjnë me avokimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për të drejtat në përgjithësi e në veçanti për të drejtat e grave dhe komuniteteve.<br>Komuna e Malishevës- ka organizuar Diten e hapur me qytetare, çdo muaj me zyrtarin ligjor në nivel regjional në kuadër të zyres së avokatit të popullit, si dhe trajnime, ligjerata lidhur me të drejat e njeriut.<br>**Komuna e Podujevës**- Koordinatori i NJKDNJ-së ka realizuar dhjetra fushata sensibilizuese dhe vetëdijësuese tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme, ligjerata me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, përgatitë fletpalosje sa i përket promovimit dhe dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të cilat i ka shpërndanë tek qytetarët pa dallim, etnie, gjinie apo moshe.<br>**Komuna e F.Kosovës** –ka organizuar Fushatë vetëdijesuese me qëllim të promovimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nxënësit ku kemi shpërnda ROLL UP ,në te gjitha shkollat komunë,QPS,QKMF<br>**Komuna e Kamenicës** -Koordinatorja e NJKDNJ-së ka realizuar dhjetra fushata sensibilizuese tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme ,ka organizuar fushata vetdijësuese, ligjerata me nxënës të shkollat fillore dhe të mesme, përgatitë fletpalosje sa i përket promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të cilat i ka shpërndanë tek qytetarët pa dallim, etnie, gjinie apo moshe me qëllim të vetdijësimit të tyre. |
| II.2.2 | Të organizohen aktivitete vetëdijesuese me | 2021-2022 | Buxheti Donatorë t | ZKM/ ZQM ABGJ | # Numri i fushatave ndërgjegjësu | Ka pas aktivitete të shumta të organizuara nga institucionet qendrore dhe lokale të qeverisjes, shoqëria civile dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.Në pamundesi me i paraqit të gjitha, i kemi përfshi disa aktivitete në vijim: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | qëllim të vetëdijesimit , ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rëndësinë e raportimit të rasteve të diskriminimit se si të paraqesin siç duhet ankesën mbi bazat e diskriminimit, dhe si të raportojnë në mënyrë adekuate diskriminimin | | | Ministrit Komunat IAP ZBEK OSBE OJQ-të Inspektorati i Punës | ese mbi raportimin e diskriminimit dhe bazat e diskriminimit ; | **Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian-**ka nisur të funksionojë prej datës 1 maj, 2022. Qëllimi i platformës kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi ( https://raportodiskriminimin.org) është të kontribuojë në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke ofruar qasje më të lehtë për qytetarët për të raportuar rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe referimin e tyre në institucionet përkatëse, për të ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.<br>Bazuar në rastet e raportuara në platformë, në gjithësej 39-të prej tyre, deri më 15.11.2023 dhe 41 deri më 01.12.2023, vërehet se sidomos në gjashtë muajt e fundit të vitit 2023, ka pasur një rritje intensive të raportimit të rasteve. Gjithësej 14 raste të raportuara në platformë, janë regjistruar në periudhën 1 Korrik-1 Dhjetor 2023. Kjo shifër përbën 35% të të gjitha rasteve të raportuara për 17 muaj aktivitet të platformës.<br>***Gjithashtu rritja intensive e raportimit të rasteve në periudhën Korrik-Dhjetor 2023, tregon rritjen e besimit në punën dhe angazhimin e platformës për shkak të suksesit të rasteve.***<br><br>**Ministria e Shëndetsisë:** ka realizur 8 tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësore në QKMF, për zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskrimimi dhe linjen e ankesave për qyetarët,<br>MSh me qëllim të ngritjes së cilësisë në shërbimet shëndetësore dhe me qëllim që qytetarit ti krijohet mundësia që ti shprehe panaqesitë gjatë marrjes se shërbimeve shëndetësore ka themeluar linjen e ankesave që nga viti 2013 qëllimi i kësaj linje ka qene dhe është me tepër me ngrite cilësinë lidhur me ofrimin e sherbimeve shëndetesore.Gjatë vitit 2023 janë regjistruar gjithësej 214 ankesa përmes linjës ankesave dhe emailit linjafalas@rks-gov.net si dhe raporti i ankesave është publikuar në ueb faqen e MSh –së për vitin 2023<br>**Ministria e Mbrojtjes:** Në të gjitha kazermat (7 kazerma) e FSK, përmes prezantimeve është promovuar pakoja ligjore për të drejtat e njeriut me qëllim të promovimit të legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi.<br>**MBPZH:** Në takimet në gjashtë regjione është bërë vetëdijesimi, ndërgjegjësimit dhe edukimi i publikut për rëndësinë e raportimit të rasteve të diskriminimit se si të paraqesin siç duhet ankesën mbi bazat e diskriminimit;<br>Gjatë vitit 2023, NJDNJ-MM ka mbajtur një (1) aktivitet vetëdijësues lidhur me ndërgjegjësimin dhe edukimin e kadetëve të FSK-së për mbrojtje nga diskriminimi. Nuk kemi pasur raste të raportuara.<br>Inspektorati i punës për çdo inspektim të planifikuar kontrollon edhe zbatimin e dispozitave të Ligjit NR. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **Komuna e Malishevës:** ka mbajt debat me temën e drejta nga mardhënja e punës në sektorin publik dhe privat, qëllimi ngritja e vetedijesimit dhe informimit për të drejtat para, gjatë dhe pas përfundimit të mardhënjes së punës (pjesemarres zyrtare,vajza dhe djem nga sektori publik e privat).<br>**Komuna e Podujevës**- Koordinatori i NJKDNJ-së realizon vazhdimisht fushata sensibilizuese tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme, mbanë fushata vetdijësuese, ligjerata me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, përgatitë fletpalosje sa i përket diskriminimit të cilat i shpërndanë tek qytetarët pa dallim, etnie, gjinie apo moshe me qëllim të vetdijësimit të tyre lidhur me parandalimin e diskriminimit.<br>Komuna e Fushë.Kosovës, ka organizuar dy takime informuese me qëllim të informimit për mundësit e raportimit të diskriminimit. |
| II.2.3 | Promovimi i Politikës kundër Ngacmimit Seksual në organet e administratës publike | 2021-2022 | Buxhet i Kosovës Donatorët BE KE | ZKM/ ZQM ABGJ IKAP Ministrit Komunat IAP Qendra Kosovare për Studime Gjinore UN Women Zyra në Kosovë | Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuese të zbatuara | Me qëllim të zbatimit të Politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administratës publike të Republikës së Kosovës, ZKM/ZQM me përkrahjen e OSBE – Misioni në Kosovë, ka hartuar Manualin për zbatimin e Politikës kundër Ngacmimit seksual. Manuali është i rëndësishëm për institucionet në Kosovë dhe ofron informacion të mjaftueshëm se si t'i trajtojnë rastet e ngacmimit seksual në vendin e punës<br><br>Në dhjetor 2023 është mbajt një sesion informues me zyrtarë nga Policia e Kosovës me qëllim që t'ju ofrohen njohuri praktike për Politikën kundër Ngacmimit Seksual, procedurat e raportimit dhe procedurat për trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës.<br><br>ABGJ në bashkëpunim me IKAP dhe në mbështetje të asistencës teknike të UN Women, ka realizuar 16 trajnime për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës. Janë certifikuar 36 Zyrtare për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Ministri dhe Komuna. Në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor janë certifikuar 112 zyrtare të nivelit udhëheqës dhe menaxherial.<br>Po ashtu me trajnime është vazhduar edhe në nivelin lokal në 11 Komuna: Drenas, Viti, Lipjan, Kline, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenice, Skenderaj, Istog, Prizren, ku janë certifikuar 227 zyrtarë te nivelit udhëheqës dhe menaxherial.<br>Buxheti në vlerë prej **9,054.50** euro.<br>Kemi zhvillua nje fushatën sinziblilizuese me zyrtaret e AUVK dhe zyrtaret e MBPZHR.<br>Me kërkesen e zyrtares për barazi gjinore, ABGj ka mbajtur trajnimin një ditor |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | më datën 06.11.2023 për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës me 32 pjesëmarrës në komunën e Kamenicës.<br>**MMPHI-se** në koordinim me ABGJ dhe në mbështetje të UN Women ka organizuar trajnim stafit të MMPHI-se për Parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës për 20 Zyrtar/e.<br>Nuk është evidencuar ndonjë rast në këtë perudhë të raportimit. Ndërsa, kemi promovuar politiken dhe manualin kundër ngacmimit seksual për personelin e MM.<br>**Komuna e Malishevës** - ka organizuar Debat me zyrtare dhe të rinje lidhur me ngacmimet seksuale<br>**Komuna e Podujevës-** në koordinim me zyrtaren për barazi gjinore dhe e mbështetur nga (ABGJ) është mbajtur një trajnim një ditor për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës me një përbërje solide të pjesmarrësve në Komunën e Podujevës. |
| | | | | | Numri i rasteve të denocuara për ngacmim seksual | Në bazë të informacioneve të ofruara nga Instituti Gjygjësor i Kosovës (IGJK), gjatë vitit 2023, kanë qenë të denoncuara 33 lëndë për ngacmime seksuale ,prej tyre janë zgjidhë 25 lëndë. |
| II.2.4 | Parandalimi i diskriminimit në aspektin e përdorimit të gjuhëve përmes aktiviteteve promovuese si dhe për të siguruar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare. | 2021-2023 | Buxheti Donatorë t | Zyra për çështje të komunitet eve<br>Zyra e Komisione rit për Gjuhët | Numri i projekteve të mbështetura për promovimin e të drejtave gjuhësore dhe zhvillimin e diversitetit gjuhësor | Moszbatimi i gjuhës rome në Komunën e Graçanicës dhe të Prizrenit, si gjuhë në përdorim zyrtar, është trajtuar dhe janë ofrur zgjidhje . IOM-i në bashkëpunim me ZKGJ-në ka shpallur konkurs dhe janë angazhuar dy përkthyes të gjuhës rome, njëri në Prizren e tjetri në Graqanicë<br>Në kuadër të Ditës Evropiane e Gjuhëve, ZKGJ-ja së bashku me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe me mbështetjen e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë, Ambasadës së Zvicrës në Kosovë dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim - IOM në Prishtinë, **më 26 shtator** ka zhvilluar aktivitete në tri komuna: **Prishtinë, Prizren dhe Graçanicë**;<br>Dita ndërkombëtare e gjuhës amtare (21.02.2023), u shënua me një takim të Grupit punues për formimin e Njësisë me Kryeministrin, ku u diskutua për rëndësinë e gjuhës amtare;<br>Zyra e Komisionerit për gjuhët më datën 20.10.2023 ka shpallur Thirrjen publike për financimin e projekteve të OJQ-ve për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. 43 (dyzet e tri) OJQ kanë aplikuar, 12 (dymbëdhjetë) kanë fituar<br>MASHTI ka zhvilluar dokuemente në mbështetje të komunitetit edukativ arsimore dhe të njëjtat i ka përkthyer edhe në gjuhët e komuniteteve, p.sh |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Modulet tematike për mbrojtje të fëmijës, Ligjin për mbrjtje të fëmijës në version miqësor, Inforgrafet për parandalim dhe referim të dhunës. |
| II.2.5 | Parandalimi dhe eliminimi i paragjykimeve dhe gjuhës diskriminuese në përmbajtjen e teksteve shkollore në të gjitha nivelet e arsimit para universitar | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Buxheti i procesit të zhvillimit të teksteve të reja | MASHTI Këshilli i ekspertëve të programeve e të teksteve shkollore ABGJ ZKM/ZQM | Këshilli i ekspertëve të programeve të teksteve shkollore siguron zbatimin e Standardeve për tekste shkollore si dhe eliminimin e elementeve (gjuhës) diskriminuese në tekstet shkollore; | MASHTI ka përkrahur hulumtimin mbi gjuhën e përdorur në tekste shkollore. Institucioni i Avokatit të Popollit (IAP) ka realizuar dhe publikuar raportin Ex-officio për gjuhën e përdorur në tekstet mësimore të arsimit të mesëm të ulët, në gusht të vitii 2023. Fatbardhësisht raporti është pozitiv dhe ka konstatuar që tekstet shkollore nuk përmbajnë gjuhë diskriminuese.<br><br>Tutje, IAP ka adresuar emailin njoftues që të njëjtin hulumtim do ta vazhdojnë edhe për tekstet e klasave 10, 11 dhe 12.<br>Gjithashtu MASHTI ka angazhuar projektin KosEd për shqyrtimin e teksteve dhe fillimisht janë shqyrtuar teskstet e gjuhës shqipe dhe të matematikës. Tekstet në mënyrë të veçantë janë shikuar edhe nga aspekti gjinor. Tashmë raportet janë përfunduar me rekomandime dhe pritet të adresohen. |
| II.2.6 | Aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit) | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës/ donatorët<br><br>5000 për vit | MASHTI Këshilli i prindërve Këshilli i nxënësve DKA Shkollat | Numri i aktiviteteve të mbajtura.<br><br>Numri i nxënësve të përfshirë dhe të cilët kanë përfituar nga këto aktivitete, i ndare sipas gjinisë. | Në mbështetje të shkollave MASHTI ka hartuar pakon e 12 moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me temat që i adreson Ligji për mbrojtjen e fëmijës:<br><br>• Moduli 1. Parandalimi dhe referimin e dhunës në shkolla<br>• Moduli 2. Parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes së shkollës<br>• Moduli 3. Mbrojtja e fëmijëve në internet<br>• Moduli 4 Parandalimi i diskriminimit në shkolla<br>• Moduli 5. Promovimi i barazisë gjinore<br>• Moduli 6. Parandalimi i gjuhën së urrejtjes<br>• Moduli 7. Parandalimin e dhunës në familje<br>• Moduli 8. Parandalimi i trafikimit të fëmijëve<br>• Moduli 9. Parandalimi i ngacmimeve seksuale<br>• Moduli 10. Programi i iniciativës së të rinjve- Y Rinia<br>• Moduli 11. Parandalimi i martesave të hershme<br>• Moduli 12. Parandalimi i punës së fëmijëve<br>Kjo pako u promovua dhe u përkthye edhe në gjuhët tjera. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Tutje janë realizuar aktivitete në parandalim të dhunës:<br>- Plasimi i videos promovuese për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në shkolla<br>- 2 misione televizive<br>- Ligjërata në shkolla nga stafi i Fakultetit të Edukimit dhe i Katedrës së Psikologjisë<br>- Aktivitete me Këshillin e nxënësve<br>- Seancë diskutimi me koordinatorë të cilësisë në komunat: Ferizaj, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë.<br><br>U mbështeten komunat për funkionimin e ekipeve shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes. Kemi mbajtuar sesione mbështetëse për ekipet e shkollave fillore dhe të mesme të ulta si dhe sesione mbështetëse për ekipet e shkollave të mesme të larta, në bashkëveprim me ECMI dhe UNICEF. Sesionet janë mbajtuar në 20 komuna (Kamenicë, Gjilan, Podujevë, Ferizaj, Shtime, Suharekë, Pejë, Gjakovë, Lipjan, Dragash, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Prizren, Obiliq, Vushtrri, Skënderaj, Viti, Drenas dhe Deçan). Gjithashtu janë përkrahur komunat në hartimin e planeve të tyre të veprimit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes, të cilat presim të shënojnë rezultate të ndjeshme.<br><br>U hartua e lansua **"Politika për mbrojtjen e fëmijës"** si dhe u përkthye në gjuhët tjera: serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe anglisht.<br>Dokumenti i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijës përmban zotimin dhe përkushtimin e institucionit për mbrojtjen e fëmijës sipas Konventës për të drejtat e Fëmijës, Kushtetutës e Republikës së Kosoves dhe legjislacionit për mbrojtjen e fëmijës në fuqi;<br><br>- U realizua Konferenca e Forumit nacional për shkolla miqësore ku MASHTI promovoi të gjitha dokumentet e zhvilluara në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës (Politika e mbrojtjes së fëmijës, Pakoja e 12 moduleve tematike, Doracaku për parandalim të trafikimit, Informatori për konventën e Stambollit; Ligji për mbrojtjen e fëmijës në version miqësor)<br>Ishim pjesë e takimeve në komuna në kuadër të fushatës nacionale për promovimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;<br>- u realizua seanca me përfaqësues të komuniteteve për parandalimin e martesave të hershme, me ç`rast u promovua pakoja e moduleve tematike dhe moduli për parandalimine martesave të hershme.<br>Komuna e Prishtinës- Me asamblen e fëmijëve të cilët janë zëri i fëmijëve të të gjitha shkollave të kryeqytetit kemi aktivitete të ndryshme sa i përket parandalimit të diskriminimit dhe 2 aktivitete ku me marrëveshje bashkëpunim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | me OJQ-të janë mbajte fushata e tilla në të gjitha shkollat e kryeqytetit.<br>Komuna e Malishevës- ka organizuar Ligjerate në SHFMU “Imer Krasniqi” në bashkëpunim me nxënesit Tema: bullizmi në shkolla Ligjerate ne dy SHFMU të drejtat e femijeve 1.me nxenes 2.me Mesimdhenes Është realizuar Kthimi i katër nxënësve në shkolle nga komuniteti RAE<br>Në Komunën e Kamenicës janë realizuar aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit). NJKDNJ ka organizuar javën kundër brakisjes së shkollimit, ku Koordinatorja e NJKDNJ-së ka përgatitë dhe shpërndar broshura me informacione tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme e në veçanti tek nxënësit duke bashkëbiseduar me ta. |
| II.2.7 | Parandalimi i diskriminimit mbi bazat e përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi përmes monitorimit të procesit gjatë shpalljes së konkurseve për pozita të lira qoftë në sektorin publik apo privat | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | MPBAP Ministrit( Zyrat e burimeve njerëzore, Zyrtarët për mbrojtjen nga Diskriminimi) Komunat (Zyrat e burimeve njerëzore, Zyrtarët për mbrojtjen nga Diskriminimi) Institucioni i Avokatit të Popullit ABGJ ZKM/ | Konkurset për pozita të lira qoftë në sektorin publik apo privat pa elemente diskriminues e dhe përjashtuese;<br><br>Numri i konkurseve të monitoruara; | Institucionet në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes janë duke ofruar mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpresin aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.<br><br>Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.<br><br>MPB gjatë vitit 2023 ka shpallur konkurse publike dhe janë monitoruar procedurat e konkurseve:<br><br>Në konkurset publike të shpallura nga MPB inkurajohen për aplikim komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë, citoj tekstin: ‘’të gjitha komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura”.<br>Çdo konkurs për pozita të ndryshme hartohen dhe publikohen në dy gjuhë zyrtare siç është paraparë në në Ligjin Nr. 02/l-37 për përdorimin e gjuhëve.Komisionet e vlerësimit krijohen duke respektuar barazin gjinore dhe etnike.<br>ME, gjate vitit 2023 ka pasur gjashtë (6) procedura të rekrutimit të realizuara përmes Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.<br>Dy (2) procedura për Lëvizje Brenda Kategorisë (LBK) kanë përfunduar me sukses dhe dy (2) procedura për Lëvizje Brenda Kategorisë (LBK) kanë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ZQM<br>OJQ-të | Numri i politikave të miratuara në sektorin publik dhe privat për të parandaluar diskriminimin, sidomos diskriminimin në punësim dhe ngacmimin seksual; | dështuar. Ndërsa dy (2) procedura për Ngritje në Detyrë (ND) kanë përfunduar me sukses. Çdo procedur e rekrutimit ka qene e hapur dhe transparente dhe e publikuar përmes Sistemit Informativ, nuk ka pas asnjë diskriminim apo shkelje të procesit.<br><br>Qeveria ka aprovuar Politkën kundër ngacmimit seksual në organet e adminstrateës publike, gjithashtu është hartuar Udhëzuesi (manuali) për zbatimin e e saj, gjithashtu janë organizuar trajnime dhe punëtori për promovimin e e Politikes kundër ngacmimit seksual me zyrtarët në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes, Policin e Kosovës. |
| II.2.8 | Hulumtime mbi përceptimin e qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës ose në tregun e punës në Kosovë | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/<br>ZQM<br>ABGJ<br>Ministrit<br>Komunat<br>OSBE<br>ZBEK<br>UNDP | Hulumtimi pasqyron parametrat aktual të vetëdijes ,përjetimeve dhe njohurive të qytetarëve mbi diskriminimin si dhe legjislacion që e rregullon fushën e mbrojtjes nga | Hulumtimi , paraqet rezultatet e studimit të kryer për vlerësimin e përceptimeve të qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës në Republikën e Kosovës.<br>Ai synon të paraqesë një masë të nivelit aktual të diskriminimit në Kosovë, me fokus në diskriminimin në vendin e punës ndaj grupeve më të margjinalizuara dhe të rrezikuara, përfshirë, por jo vetëm, gratë, minoritetet, të rinjtë dhe personat LGBTI.<br>Ky publikim është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | diskriminimi. | |
| II.2.9 | Hulumtime mbi përceptimin e shërbyesve civilë lidhur me diskriminimin në vendin e punës ose në tregun e punës në Kosovë | 2021 | Financimi i donatorëve | ZKM/ ZQM ABGJ Ministrit Komunat OJQ-të OSBE ZBEK UNDP | Hulumtimi pasqyron parametrat aktual të vetëdijes, përjetimeve dhe njohurive të nëpunësve civil mbi diskriminimin, mekanizmat referues si dhe legjislacion që e rregullon fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. | Vlerësimi i perceptimeve lidhur me diskriminimin në vendin e punës është diçka aktuale në të gjitha vendet, përfshirë vendet e zhvilluara me korniza gjithëpërfshirëse ligjore dhe mekanizma të zbatimit, monitorimit dhe raportimit. Kjo mundëson ndërmarrjen e masave adekuate parandaluese të cilat, nga ana e tyre përmirësojnë cilësinë dhe produktivitetin në punë, duke ndikuar kështu pozitivisht në kapacitetet e një ekonomie për të siguruar rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.<br>Ky raport paraqet rezultatet e studimit të kryer për vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve lidhur me diskriminimin në vendin e punës në Republikën e Kosovës. Ai synon të paraqesë një masë të nivelit aktual të diskriminimit në Kosovë, me fokus në diskriminimin në vendin e punës ndaj grupeve më të margjinalizuara dhe të rrezikuara, përfshirë, por jo vetëm, gratë, minoritetet, të rinjtë dhe personat LGBTI. |
| II.2.10 | Marrja e masave afirmative për përmirësimin e situatës së komuniteteve të margjinalizuara duke përfshi (grat nga zonat e thella rurale, fëmit ,personat me aftësi të kufizuara, | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Ministrit Komunat ZKM/ZQM ABGJ Agjenisonet e Panvarura OSBE | Numri i masave afirmative të propozuara dhe të zbatuara | Me Vendimin e Kryeministrit nr. 6/81 të datës 01.06.2022 është themelua Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<br>Duhet theksuar se themelimi i Ekipit **është masë e përkohshme afirmative** për inkurajimin dhe avancimin si dhe për arritjen e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç është përcaktuar në Kushtetutë. në ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës<br><br>**Me qëllim te rritjes së gëzimit të të drejtave pronësore të grave** - ABGJ i ka propozuar Qeverise vazhdimin e masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshorteve pa pagesë . Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 01/ |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | komunitetet, të zhvendosurit etj. | | | | Kategoria e grupeve dhe numri i përfituesve si rezultat i zbatimit të masave afirmative | 2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve, i aprovuar në mbledhjen e Qeverisë, më datë 12.04.2023, me vendimin nr. 07/138 .<br><br>Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për periudhën tetë (8) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi."<br>Për derisa në vitin 2016 kemi pasur vetëm 105 qifte që e kanë regjistruar pronën e përbashkët në tërë Kosovën, në 2022 janë 4 mijë 375 qifte që e kanë bërë këtë". Kjo masë afirmative ka ndihmuar në rritjen e qasjes së grave në pronë dhe për herë të parë kemi rritur normën e pronësisë nga gratë në nivel vendi në përqindje prej 19.22"<br><br>ABGJ ka iniciuar hartimin e një mase afirmative për ngritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në administratën publike, ABGJ e ka shtyrë këtë aktivitet për vitin 2024 në mënyrë që masa afirmative të mbështetet në kornizë ligjore të përfunduar. Po ashtu, ABGJ ka mbështetur formimin e shoqatës së grave në pozita vendimmarrëse në administratë publike me qëllim të inkurajimit mbështetjes, dhe promovimit të vendimmarrjes së grave si masë inkurajuese për gratë në shërbimin civil që të aplikojnë në pozita vendimmarrëse.<br><br>**MASHTI, sipas thirrjes publike të vitit 2023 për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore për mbështetjen e nxënësve rom, ashkalinj dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, janë, ka mbështetur me 200.000 Euro këto 7 OJQ:**<br><br>**1. Caritas Kosova,**<br>**2. Romani Iniciativa Hak,**<br>**3. The Ideas Partnership,**<br>**4. Betharny Christian Servise BCS,**<br>**5. Terre Des Hommes,**<br>**6. Nevo Koncepti, dhe**<br>**7.VORAE**<br><br>- U bë përkrahja e OJQ-ve që merren me promovimin e nxënësve me IQ të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti. Shuma totale e mbështetjes 170 mijë euro. Përfituan 7 organizata të shoqërisë civile. |

- Janë dhënë edhe bursat për nxënësit e shkollave të mesme të larta për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian:
MAShTI ka planifikuar 500 bursa për vitin shkollor 2023/24 gjithsej 150.000 euro ndërsa kanë përfituar 467 nxënës sespe nuk ka pasur më shumë aplikime.

Pagesa e bursave për vit mësimor bëhet në vlerë prej 300 EUR për nxënës, për periudhën Shtator 2023 – Qershor 2024.

| **Përfituesit e bursës 2023/2024:** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| **Rom** | **Ashkali** | **Egjiptian** | | | |
| | | | | | |
| **F** | **M** | **F** | **M** | **F** | **M** |
| **46** | **31** | **99** | **103** | **99** | **89** |
| **Gjithsej: 467** | | | | | |

**Mbështetje financiare për studentët**

- 1882 studente vajza/gra të regjistruara për herë të parë në programet e studimit STEM dhe studente të cilat kanë përfunduar vitin e parë dhe të dytë të studimeve kanë përfituar nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës 1.882.000 euro.
- 1647 studentë të nivelit bachelor dhe master me notë mesatare 9 kanë përfituar nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës 1.647.000 euro.
- 28 studentë me aftësi të kufizuara, kanë përfituar nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës 28.000 euro.

55 studentë të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptianë përfitues të bursave për vitin akademik 2023/2024 kanë përfituar nga 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës 55.000 euro.
(MAShTI ka planifikuar 100 bursa për studentet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ndërsa ka pasur pak aplikime).

- 70 bursa në drejtimet deficitare dhe drejtimet teknike në vlerë 500 euro për një vit shkollor (30 për nxënëse/vajza të drejtimeve teknike kurse 40 nxënës/ djem në drejtime deficitare). Shuma totale e pagesës 35.000 euro.
- 13 përfitues të bursave të nivelit master në top 150 universitetet më të mira në botë sipas listës Shanghai 2023. Përfituan nga 7 mijë euro. Shuma totale e pagesës 91.000 euro.
- 43 studentë të cilët ndjekin studimet e doktoratës në 500 universitetet më të mira në botë sipas listës “Shanghai” të vitit 2023 përfituan nga 8,500

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | euro. Shuma totale e pagesës 365.500 euro.<br>- 467 nxënës të shkollave të mesme të larta nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përfituan bursë në shumë 300 euro. Shuma totale e pagesës 140.100 euro.<br>- 89 nxënës të Gjimnazit të specializuar matematikor në Prishtinë, për vitin shkollor 2023/24, kanë përfituar bursë në shumë 1 mijë euro. Shuma totale e pagesës 89.000 euro.<br>- Programi Fulbright<br>- Këtë vit kemi 7 përfitues nga Kosova të bursave Fulbright për vitin 2023.<br>- Investimi i qeverisë për programin Fulbright (600 mijë euro në vit) e rendit Kosovën në vendin numër një në botë për shumën e bashkëfinancimit të programit Fulbright për kokë banori.<br>- Tani kemi mbi 40 qytetarë në baza vjetore që janë pjesë e shkëmbimeve akademike nga Kosova në SHBA dhe anasjelltas.<br><br>Është aprovuar nga Qeveria me propozim të MSh UA /QRK) Nr. 11/2022 për Caktimin e Listës, Llojeve dhe Pajisjeve Ndihmëse që Ofrohen Falas për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik që Sherbejnë për Lëvizje, Parandalim dhe Asistim i cili do filloj zbatimin gjatë vitit 2024. Ku eshte themelur Komisioni dhe shume shpejte do filloj punën per zbatim.<br><br>**Komuna e Prishtinës**- Ndanë subvencione grave që mirën me bujqësi, subvencionohen OJQ që mirën me personat me aftësi të kufizuar dhe pjestarëve të komuntiteteve Rom, Ahkali dhe Egjiptian ju ndahen pako ushqimore, materjale për ngrohje etj. Numri i personave ndryshon varsishte nga kërkesat.<br>Komuna e Vushtrrise- ka organizuar nje ser aktivitetesh (trajnimesh) kryesishte për gratë e fshatrave rurale, gjithashtu në vazhdimësi subvencionon transportin e veqante për femijet me aftësi te kufizuara, subvencionon OJQ-të që meren me këto qështje, gjithashtu ka financuar 50% të pagsës për të rinjët që kanë përfunduar kurse.<br>**Komuna e Malishevës** -në ndërtesën e banimit social është zgjidhur qështja e banimit për shume gra kryefamiljare (viktima të dhunës në familje, familje që kanë anëtare me aftësi të kufizuar dhe raste sociale).Po ashtu me banim për kohe të caktuar kemi një rast (dhune në familje).<br>Në marrjen e masave afirmative për përmirësimin e situtatës së komuniteteve të margjinalizuara, gratë në zonat rurale, fëmijët, personat me aftësi të kufizuar dhe komunitetet tjera.<br>Drejtoritë e caktuara siç janë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, inkurajon gratë në startape me 10 pikë si dhe Drejtoria e DKA-së për nxënësit e kominteteve |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Romë, Ashkalinj, Egjiptian. Të gjithë nxënësit e këtyre komuniteteve i ndahen bursa.Pastaj Drejtoria e Bujqësisë për vitin që lam pas i ka përkrahur fermerët dhe fermeret me mjete të bujqësisë si në vijim; Përkrahja me Motokultivator 16 femra, Përkrahja me Fidane – Mjedrra 13 femra, Përkrahje me Motokultivator 12 femra, Përkrahje me Fidane – Fafarona 10 femra, Përkrahje me Serra 33 femra, Përkrahje me Mëshqerra 51 femra etj, ndërsa DSHMS-ja në thirrjen publike i mbështet Shoqatën e Handikos me 15,000 Euro, si dhe OJQ-të që kanë programe me nevoja të veçanta nga 2,000 Euro.<br>**Komuna e Kamenicës** -shënon "Ditën Ndërkombëtare për Mundësi të Barabarta Profesionale për Personat me Aftësi të Kufizuar". Shënimi i kësaj dite ka për qëllim që PAK, qofshin studentë apo punë-kërkues, të kenë mundësinë që për disa ditë të punojnë në një profesion, i cili u përshtatet interesave të tyre për zhvillimin e karrierës. Për shënimin e kësaj dite, u mundësua punësimi i shtatë personave me aftësi të kufizuar. |
| II.2.11 | Të sigurohet dëmshpërblim adekuat dhe kompensim të viktimave të diskriminimit në proporcion me dëmin e shkaktuar material dhe jo material | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK | Numri i viktimave të diskriminimit të kompensuar për dëmin e përjetuar material dhe jo material<br><br>Numri i vendimeve të shqiptuara nga gjykatat | Përdoruesi i karrocës F.K, ka paditur Komunën e Prishtinës për mungesën e infrastrukturës së nevojshme për përdoruesit e karrocës. Pas shqyrtimit të rastit, Me vendim, Gjykata themelore e obligon Komunën e Prishtinës që të kompensojë dëmin e shkaktuar jomaterial në vlerë prej 5,500 euro.<br>"Detyrohet e paditura – Komuna e Prishtinës, që paditësit – F.K, për shkak të diskriminimit nga mosveprimi, mungesa e ofrimit të kushteve fizike në hapësirat publike dhe qasjes në objektet publike për personat me aftësi të kufizuara, t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar jomaterial në emër të cenimit të dinjitetit në shumë prej 5,500 euro" – thuhet në vendimin e Gjykatës së Prishtinës.<br>( për aq sa kemi informacione nuk ka pas ndonjë kompenzim tjetër ), ndërsa sa i përket viktimave të krimit ,shuma totale e taksës për kompenzimin e viktimave të krimit në vitin 2023 ka qenë **228,978.00€** |
| II.2.12 | Zhvillimi i kurrikulës trajnuese për mos diskriminimin e cila doli si rezultat i vlerësimit të nevojave trajnuese për | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës, Bugjeti i Akademisë së Drejtësisë | **Akademia e Drejtësisë**<br>KGJK<br>KPK<br>OSBE<br>ZBEK<br>USAID | Do të realizohen së paku 15 trajnime dhe nga këto trajnime së paku 150 gjyqtarë dhe 105 | Akademia e Drejtësisë çdo vit bënë vlerësimin e nevojave trajnuese dhe harton kurrikulën trajnuese përshtatshmërisht me nevojat trajnuese.<br><br>Në vitin 2023 është realizuar 1 trajnim për Aspektin material dhe procedural të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij.<br>Këtë trajnim e vijuan 12 (4 nga Gjykata e Apelit dhe 8 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës)<br>Gjatë muajit gusht 2023 , Organizata "CEL" ka mbajtur trajnimin njëditor me zyrtarë policorë dhe prokurorë të Republikës së Kosovës, i cili u fokusua në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | gjyqtarë, prokurorë si dhe zyrtarë tjerë që merren me të drejtat e njeriut. Kjo kurrikulë do të zbatohet për tre vitet në vijim 2021-2023 | | | | prokurorë të trajnuar me mundësi përfshirje edhe të zyrtareve që merren me të drejtat e njeriut dhe zyrtarëve për barazi gjnore.<br><br>Numri i zyrtarve të cilët janë trajnuar | krimet e gjuhës së urrejtjes dhe përndjekjen penale të tyre, konsiderimin e hershëm dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes, diskriminimit dhe paragjykimeve karshi personave LGBTIQ+.<br><br>Gjithashtu nga Organizata "CEL" Është mbajtur trajnimi njëditor me gjyqtarë të Republikës së Kosovës, i cili u fokusua në gjuhën dhe krimet e urrejtjes dhe përndjekjen penale të tyre, konsiderimin e hershëm dhe parandalimin e gjuhës dhe krimeve të urrejtjes, diskriminimit dhe paragjykimeve karshi personave LGBTIQ+.Përgjatë trajnimit u diskutuan edhe konceptet kryesore që u përkasin komuniteteve LGBTIQ+, kështu duke plotësuar bazën për ndjekje më teknike të gjuhës dhe krimeve të urrejtjes, si dhe si duhet trajtuar viktimat e krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+ dhe çfarë aftësi kryesore janë të nevojshme për të mbledhur prova të motivit të paragjykimit dhe elementet kryesore që diferencojnë krimet e urrejtjes nga krimet e zakonshme. |
| II.2.13 | Hetimi i rasteve të mundshme të sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), me prioritet | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK<br>AD<br>Policia e Kosovës | Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, të dhunës familjare dhe krimit të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit , si dhe rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), janë hetuar dhe shqyrtuar me urgjencë | Në Kosovë gjatë vitit 2023 janë regjistruar 72 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, një pjesë e tyre natyrisht online, por të formave të ndryshme kundër gazetarëve. Gati gjysma e tyre kanë ndodhur në veriun e Kosovës në një periudhë vetëm pesë javore, prej fundit të majit deri në fund të qershorit 2023. Sulmet ndaj gazetarëve në Kosovë përgjatë vitit 2023 janë dënuar në shkallë të gjerë nga përfaqësuesit e institucioneve e partive politike në Kosovë, asociacioneve, dhe shoqatave vendëse e ndërkombëtare të gazetarëve.<br>Gjithsesi ka pasë një reagim të shpejt nga organet e drejtësia ne rastin e sulmit ndaj gazetarit V.S , gjykata tashmë ka dhënë një verdikt gjykues të shkallës së parë kundër tre personave. Sulmi ndaj tij ka qenë kundër lirisë së shprehjes.<br>Sa i përket Lirisë së shtypit Kosova vlerëset se ka shënuar përparim duke u radhitur në vendin e 56-të, një rritje prej 5 vendesh në krahasim me raportin e kaluar ku radhitej në vendin e 61-të.<br>Gjate vitit 2023 janë raportuar rastet si ne vijim:<br>Janë ngrit 15 aktakuza për krime lufte<br>1108 raste (lëndë) të dhunës në familje,1037 raste prej tyre janë zgjidhë dhe vendos nga gjykatat.<br><br>**Gjate vitit 2023, p**ërderisa po flitej dhe diskutohej Projekt Kodi Civil në seancën plenare te Kuvendit të Kosovës , përgjatë kohës sa po mbahej seanca, si dhe ditë e javë pas dështimit të kalimit të tij, rrjetet sociale e mediat nxorën |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Numri i vendimeve të shqiptuara nga gjykatat | në pah gjuhën skajshmërisht urrejtëse e dhunënxitëse ndaj personave të komunitetit LGBTQI+.<br><br>Kjo gjuhë urrejtëse hasej nëpër komente në rrjete sociale, biseda e shprehje rasti mes njerëzish, e edhe tituj e tekste të mediave.Rastet që cenojnë të drejtat e personave të komunitetit (LGBTI), janë hetuar dhe shqyrtuar me urgjencë.<br><br>Aktgjykimi i dhënë nga Gjykata Themelore në Prishtinë kundër individit të akuzuar në vitin 2023, paraqet një moment të rëndësishëm në përgjigjen ligjore të Kosovës ndaj terrorizmit dhe krimeve të urrejtjes që synojnë komuniteteve LGBTI+. Gjykata e shpalli fajtor B.V. për planifikim dhe përgatitje të sulmeve terroriste kundër pjesëtarëve të komuniteteve LGBTI+ në Kosovë, Trajtimi efikas i kësaj çështjeje nga gjykata është i për t'u lëvduar. Vendimi i gjykatës për ta dënuar B.V. dhe dënimin e tij me tre vjet e gjashtë muaj burgim, nënvizon seriozitetin me të cilin sistemi juridik i Kosovës i trajton aktet e terrorizmit dhe kërcënimet ndaj sigurisë publike dhe ndaj komuniteteve të cenueshme<br><br>Policia e Kosovës në vitin 2021 ka hartuar Udhëzuesin "Trajtimi i krimeve të urrejtjes.<br>Po ashtu Policia e Kosovës ka në përdorim që disa vite<br>**PSO Trajtimi policor me rastet e Anetareve të komunitetit LGBT**<br>**Ndërsa në vitin 2022,** është hartuar PSO parandalimi dhe Trajtimi e dhunës në familje. |
| II.2.14 | Të bëhet mbledhja, analizimi dhe raportimi lidhur me rastet e lidhura me diskriminimin, duke përfshirë rastet e diskriminimit me **bazë gjinore dhe ato të ngacmimit seksual,** në | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës | KGJK<br>KPK<br>ZKM/ZQM<br>ABGJ | Mirëmbajtja dhe raportimi i të dhënave statistikore të kategorizuara sipas gjinisë, lidhur me rastet, procedurat dhe vendimet në rastet e diskriminimit dhe ngacmimit (seksual) | <u>KGJK/Gjykatat nuk gjenerojnë statistika lidhur me lëndët duke ju referuar kategorive të caktuara të personsve por vetem në bazë të neneve përkatëse që parashihen me Kodin Penal të Kosovës, ashtu që sa i përket rasteve lidhur me Dhunën në Familje, për vitin 2021 kanë qenë 206 lëndë të zgjidhura të kesaj natyre në nivel të 7 Gjykatave të Rregullta të Republikës së Kosovës.</u><br>*Ashtu siç e kemi cekur edhe në rastet e kaluara, KGJK, përkatësisht sistemi përkatës elektronik në gjykata, nuk gjeneron statistika mbi këtë bazë, por duhet të ceket neni përkatës nga Kodi Penal, si dhe eventualisht periudha kohore e cila është objekt interesimi, pastaj sistemi gjeneron të dhënat adekuate*<br>Gjatë vitit 2023 janë denoncuar 33 lëndë për ngacmim seksual, prej tyre janë zgjidhë 25 lëndë, sa i përket dhunës në familje kemi pas 1108 raste, prej tyre janë zgjidhë 1037 raste (lëndë). |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | harmoni me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ato të Ligjit për Barazinë Gjinore. | | | | | |
| II.2.15 | Të evidentohen rastet e ankesave të ushtruara në sektorin publik dhe privat mbi bazat e diskriminimit të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | IAP Ministrit Komunat Inspektorati i Punës | Numri i ankesave të paraqitura për diskriminim ,si dhe numri i rasteve te iniciuara ex-officio për diskriminim në sektorin publik dhe privat | Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka vazhduar të pranoj ankesa me pretendim për diskriminim. Bazat e diskriminimit të pretenduara nga ankesat e pranuara kanë të bëjë me etninë, gjininë, moshën, aftësinë e kufizuar, mendimet politike, gjuhën, gjendja shëndetësore, diskriminim në vendin e punës, ushtrimi i profesionit si dhe baza tjera. Gjithashtu, janë hapur edhe raste sipas detyrës zyrtare.<br>Gjatë vitit raportues janë mbyllur 130 raste lidhur me ankesat me vendim për refuzim mbi ndonjërën nga bazat e përcaktuara me nenin 22 të Ligjit për Avokatin e Popullit.<br>Pas hetimeve ex-officio, janë publikuar 6 raporte me rekomandime me konstatime për diskriminim.<br>Sipas informacioneve të Inspektoratit të Punës, numri i ankesave për shkak diskriminimit është 2 –gra lehona dhe numri i rasteve të inicuara ex officio është 3 raste të gjetura me rastin e inspektimeve të inspektorëve në subjektet punuese (Inspektorati i punës). |
| II.2.16 | Të vendosen rregullat dhe proceduart për ndryshimin e gjinisë/seksit (shënjuesit të gjinisë) në dokumentet zyrtare | 2022/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MPBAP Agjensioni për Regjistrim Civil ZKM/ZQM ABGJ ZBEK KE | Jane hartuar udhëzimet, qartësuar rregullat dhe procedurat për ndryshimin e gjinisë/seksit (shënjuesit të gjinisë) në dokumentet zyrtare | Projektligji për Gjendjen Civile është miratuar në Mbledhjen e 174-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 02/174, të dates 22.11.2023, përmes të cilit janë shpjeguar procedurat e ndërrimit të gjinise/seksit. |

| II.3 | Objektivi specifik: Krijimi dhe fuqizimi i sistemit të trajnimit për standardet e të drejtave të njeriut; | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | **Progresi në zbatim** |
| II.3.1 | Përditësimi i programit të trajnimit për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve | 2021 | Buxheti i Kosovës Donatorët | IKAP<br>ZKM /ZQM<br>ABGJ<br>Zyra për çështje të komuniteteve<br>Zyra e Komisionerit për Gjuhët<br>AD<br>OSBE | Programit i trajnimit për standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve i institucionalizuar<br><br>Programi trajnues i Akademisë së Drejtësisë | Është bërë përditësimi i programit të trajnimit për “Të drejtat e njeriut” dhe për “Të drejtat e komuniteteve”.Trajnimet realizohen konform temave të përcaktuara në kuadër të Programit të trajnimit.<br>Në fund të vitit 2022 IKAP ka azhurnuar Progarmin e trajnimit për nëpunesit civil dhe në këtë Program ka rifreskuar trajnimet.<br>“Të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Sistemi Evropian i mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut” dhe “Të drejtat e komuniteteve në Kosovë”.<br>Me datë 03.04.2024 në Institutin e Kosovës për Administrate Publike është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me; ZQM/ZKM; Fondacioni Terre des Hommes Lausanne në Kosovë.<br>Memorandumi i bashkëpunimit është bërë më qëllim të rritjes dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërmjet Palëve për ngritjen e kapaciteteve të Zyrtarëve Publik në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, migracionit dhe anti-trafikimit si dhe drejtësisë për të mitur. Përmes këtij memorandumi palët kanë shprehur vullnetin e tyre për themelimin e marrëdhënieve bashkëpunuese për realizimin e programit trajnues për çështjet si: mbrojtja nga diskriminimi, antigjipsizmi, fëmijët në konflikt më ligjin, puna e ndaluar e fëmijëve, mbrojtja dhe trajtimi i fëmijëve viktimë e abuzimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe migrimit të pasigurt të fëmijëve.<br>Si obligime për zhvillim të aktiviteteve nga të tre palët në marrëveshja ndër të tjera do jenë organizimi i trajnimeve për zyrtarët publikë në sferat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe në çështjet kundër diskriminimit. Në këtë memorandum që përfshinë tema të agjendës qeveritare Terre des Hommes do mbështesë IKAP dhe ZQM të realizojnë programet e tyre duke përfshirë zyrtarë publik të nivelit qendror dhe atij lokal.<br>Zyra e Komisionerit për Gjuhët, në bashkëpunim me IOM-in, ka bërë përgatitjet për ofrimin e kursit për mësimin e gjuhës serbe për zyrtarët qeveritarë të cilët janë të interesuar (interesimi fillimisht ka ardhur nga zyrtarët e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit). Janë lajmëruar 32 zyrtarë civilë, të interesuar të vijojnë kursin e gjuhës serbe), i cili ka filluar me 9 janar 2023.<br>Faza e dytë e Projektit “Avancimi i të drejtave gjuhësore” ka filluar së zbatuari në muajin tetor 2023 dhe do të zgjasë 8 (tetë) muaj - deri në muajin maj 2024. Deri më tani janë mbajtur 2 takime dhe janë paraparë takime të tjera, vizitë studimore, trajnime dhe monitorim me zyrtarët komunalë në të gjitha komunat e Kosovës. Ky projekt do të zbatohet përmes ZKGJ-së, me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe IOM. Projekti financohet nga UNMIK-u; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.3.2 | Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civil mbi referimin interpretimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe legjislacionit për të drejtat e njeriut dhe komuniteteve në punën e tyre të përditshme | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | IKAP ZKM /ZQM ABGJ OSBE KE Këshilli i Evropës | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i nëpunësve civil të cilët kanë marre pjese në trajnime , i ndare në baza gjinore; | Gjatë vitit 2023 IKAP ka organizuar kurset e trajnimit “Të drejtat e komuniteteve në Kosovë” si dhe “Të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Sistemi evropian i mbrojtjes së drejtave të njeriut”.<br>Për këto aktivitete u organuizuan 8 ditë trajnim dhe u trajnun 43 pjesëmarrës.<br>ABGJ ka mbajtur 4 punëtori ne nivelin lokal për Mekanizmat koordinues kundër dhunës ne familje, ku janë prezantuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, përgjegjësite e nivelit lokal konform Konventës së Stambollit dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Punëtoria është mbajtur në këto Komuna: Fushë Kosovë, Deçan, Vushtrri, Lipjan dhe kanë marrë pjesë 72 persona, nga këta janë 46 gra dhe 26 burra. Vlera totale e buxhetit është; 1,326.00 Euro.<br>**MAPL** në pajtim me objektivat e strategjisë për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht forcimit të kapaciteteve institucionale të komunave, ka ndërmarrë veprime për zbatimin e aktiviteteve të parapara në këtë fushë. Në këtë drejtim, janë organizuar takime me IKAP dhe donatorë për të koordinuar aktivitetet rreth organizimit të trajnimeve për komuna komform planit të trajnimeve dhe për të ofruar përkrahje në realizimin e planit të trajnimeve për vitin 2023.<br><br>Në bashkëpunim me MMPHI dhe JICA është realizuar punëtoria në fushën: "Ngritje e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë. Faza II’’, Pilot projekte e dobishme per komunat për të vazhduar tutje me marrjen e përvojave nga Projecti i JICA. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin zyrtarët komunal të këtyre fushave, duke u njoftuar me procedurat e raportimit, kriteret, metodat e dokumentimit te cilësisë, afatet dhe dokumentet udhëzuese për menaxhimin e mbeturinave.<br>Ndërsa në periudhën prill – qershore janë mbajtur trajnimet në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, bazuar në planin e trajnimeve, në bashkëpunim INDEP-GIZ- IKAP-in dhe Departamentin për Zhvillim të Qëndrueshëm Komunal. Trajnimi ka qenë një ditor me temën “Strategjia për zhvillim ekonomik lokal.<br>Nga fusha e komunikimit me publikun ne bashkëpunim me OSBE-ne është realizuar trajnimi me temën “Rritja e komunikimit me media dhe marrëdhëniet me publikun dhe menaxhimin e mediave sociale” Nga këto takime përfitues drejtpërdrejt kane qene zyrtarët komunalë për informim dhe marrëdhënie me publikun, në përmirësimin e komunikimit të tyre me publikun dhe mediat dhe në promovimin e punës së komunave.<br><br>Ndërsa në bashkëpunim me projektin DEMOS, ne kuader të ngritjes së kapaciteteve të zyrtareve komunal ështe realizuar trajnimi me temën: Funksionimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Ky trajnim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | është organizuar për të gjitha komunat dhe për të gjithë zyrtarët të cilët janë përdorues të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Trajnimi ka zgjate 5 dite radhazi ka pas për qëllim përgatitjen e zyrtarëve komunal per ngritjen e kapaciteteve për përdorimin e SMPK- së.<br>MAPL në bashkëpunim dhe koordinim me ZQM/ZKM si dhe me mbështetjen financiare nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), ka organizuar trajnime me anëtarët e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës të cilat i kanë themeluar EDF-të, sipas Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e ekipit për të drejtat e fëmijës.<br>**MAPL në bashkëpunim me ZQM/ZKM** dhe me mbështetje të OSBE-së dhe IKAP-in, ka realizuar trajnimin me zyrtaret komunal ‘’Konsultimi publik në komuna dhe procesi i Publikimet në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovë.<br><br>Divizioni për avancim të kapaciteteve dhe reformave komunale në bashkëpunim me OSBE, Asociacionin e komunave te Kosovës (AKK) si dhe (IKAP) ka orgnizuar trajnimin tre ditor në fushën e Menaxhimit të Pronës Komunale.Gjate tri ditëve janë trajtuar sfidat e zbatimit të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Përfitues të kësaj punëtorie kanë qenë zyrtarët ligjor të komunave, si dhe zyrtarët të cilët janë kompetentë për fushën e menaxhimit të pronës komunale.<br>**Gjithësejt janë trajnuar 380 zyrtarë komunal**. |
| II.3.3 | Trajnimi i inspektorëve të punës për ngacmimi seksual, përkufizimin e tij ligjor si dhe mënyrën e referimit të rasteve. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | Inspektorati i Punës<br>MFPT<br>ABGJ<br>ZKM<br>/ZQM | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i inspektorëve të punës të cilët kanë marre pjese në trajnime; | Trajnimi i inspektorëve të punës për ngacmimi seksual, përkufizimin e tij ligjor si dhe mënyrën e referimit të rasteve.<br>Numri i trajnimeve të mbajtura -1 trajnim<br>Numri i inspektorëve të punës të cilët kanë marre pjese në trajnime është 26<br>Numri i inspektorëve të punës të cilët kanë marr pjesë në Trajnime –mbi 20<br>IKAP ka organizuar trajnime;<br>‘Puna e denjë, siguria dhe shëndeti në punë: Hyrje në perspektivën gjinore’<br>Ky trajnim është mbështetur nga UN-Women dhe është organizuar në kuadër të projektit “Komponenta gjinore në promovimin e punës së denjë përmes menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë”, i cili është implementuar nën menaxhimin e ILO dhe financuar nga Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë.<br>Në këtë aktivitet u trajnuan 24 pjesemarrës në 4 ditë trajnim.<br>**6 femra dhe 18 meshkuj.** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| II.3.4 | Raportimi lidhur me numrin e trajnimeve të realizuara për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht me theks të veçantë për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNj) | 2021-2023 | Buxheti i Akademisë së Drejtësisë | Akademia e Drejtësisë<br><br>KGJK<br>KPK | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë marre pjese në trajnime | Gjatë vivit 2023 janæ realizuar 5 trajnime për të drejtat e njeriut përkatësisht sipas standardeve të KEDNJ-së.<br>Këto trajnime i kanë vijuar 81 gjyqtarë dhe 6 prokurorë. |
| II.3.5 | Zhvillimi i programe përkatëse për gjyqtarë, prokurorëve, zyrtarëve të policisë dhe avokatëve ,mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me fokus në ; **lirinë e shprehjes ,gjuhën e urrejtjes , lirinë e medias dhe për sinjazimin e gazetarve** në përputhje me | 2021/2022 | E Buxhetuar Donatoret | Akademia e Drejtësisë<br>Akademia e Kosovës për Siguri Publike<br>KGJK<br>KPK<br>OAK<br>Këshilli i Evropës<br>Policia e Kosovës<br>OSBE<br>ZKM/ ZQM | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i zyrtarëve të cilët kanë marre pjesë në trajnime<br><br>gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e policisë dhe avokatët ,kanë njohuri të nevojshme mbi standardet ndërkombëta | Gjate vitit 2023 nga Policia e Kosovës janë mbajtur 39 trajnime të kësaj natyre. Nga këto trajnime janë trajnuar 230 Zyrtar Policor.<br>**Akademia e Drejtësisë**<br>Është realizuar 1 trajnim për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve. Përfitues të këtij trajnimi ishin 12 Bashkëpunëtorët profesional, prej tyre 9 nga gjykatat dhe 3 nga prokuroritë nga regjionet e ndryshme.<br>**Akademia e Kosovës për Sigri Publike (AKSP)**<br>Në, Temat gjuha e urrejtjes, barazia gjinore dhe të drejtat e njeriut janë trajtuar në:<br>- Trajnimin Profesional Zyrtar Policor /PK, moduli I dhe II gjenerata 57 dhe 58 Gjithsej- 850 kadetë të trajnuar.<br>Trajtimi i temës së të drejtave të njeriut, krimet e urrejtjes janë trajtuar në:<br>- Trajnimin Themelor të Hetimit të Krimit (3 trajnime)<br>Gjithsej - 78 vijues të trajnuar<br>Temat që ndërlidhet me të drejtat e njeriut trajtohet në:<br>- Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues-SHKK (moduli 5)<br>Gjithsej - 92 kadetë janë trajnuar<br>- Totali i trajnimeve: 7<br>Vijues të trajnuar: 1020 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | standardet e Këshillit të Evropës, me një fokus të veçantë në gjyqësorin. | | | | re për të drejtat e njeriut me fokus në lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjazimin e gazetarve në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës | |
| II.3.6 | Trajnimi i zyrtarëve policorë lidhur me përkufizimin e dhunës në baza gjinore dhe ngacmimit seksual sipas ligjeve të Kosovës, atë se çfarë përfshihet në të, si dhe lidhur me mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve kur këto raportohen në polici, konform Kodit Penal të Kosovës | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) Policia e Kosovës ZKM/ ZQM ABGJ | Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i zyrtarëve policor të cilët kanë marre pjesë në trajnime<br><br>Përditësimi i kurseve të trajnimit konform ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë | Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)<br><br>Temat ngacmimet seksuale janë trajtuar në:<br>- Trajnimin Themelor të Hetimit të Krimit (Vepra kundër dhunës seksuale)<br>- Trajnimin e Avancuar të Hetimit të krimit (Hetimi i krimit seksual)<br>Totali i trajnimeve:4<br>Vijues të trajnuar: 109<br><br>**ABGJ** ka realizuar 6 trajnime dy ditore për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në familje dhe dhuna ndaj Grave 2022-2026, ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde te Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.<br><br>Gjatë muajve janar- dhjetor 2023 janë certifikuar 119 polic, prej tyre 85 burra dhe 34 gra në këto Komuna: Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Vlera totale e këtyre trajnimeve është 6,853.60 Euro.<br>Numri i trajnimeve të mbajtura gjatë vitit 2023 eshte 82. Numri i zyrtareve policor të trajnuar për vitin 2023 është 922. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | gjinore dhe ngacmimin seksual, me përqendrim në viktimën. | |
| II.3.7 | Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe organizimi i trajnimeve për prokurorët dhe gjyqtarët lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacionin, mbajtjen financiare të bashkëshortit-es ,krimet në bazë gjinore, veçanërisht, dhunën në familje, dhunën seksuale, ngacmimin seksual, veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal; | 2021/2022 | Buxheti Donatorët | Akademia e Drejtësisë ZKM/ ZQM ABGJ KGJK KPK | Moduli i trajnimit i përditësuar konform ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal lidhur me dhunën në bazë gjinore dhe ngacmimin seksual.<br><br>Numri i trajnimeve të mbajtura<br><br>Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë marrë pjesë në trajnime | Për vitin 2023 të gjitha modulet kanë qenë përshtatshmërisht me risitë ligjore. Në periudhën raportuese është realizuar një trajnim me temë: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje. Këtë trajnim e kanë vijuar 36 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 4 nga Gjykata e Apelit dhe 31 gjyqtarë tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet<br><br>6 trajnime me temë: Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve. Këto trajnime kanë qenë regjionale dhe kanë vijuar 7 prokurorë, 1 gjyqtarë, 11 avokatë, 26 nga QPS, 35 zyrtarë policor si dhe 9 mbrojtës të viktimave; 1 trajnim për Kompensimi i viktimave të krimit-ndryshimet e ligjit. Këtë trajnim e kanë vijuar 8 gjyqtarë, 3 prokuror, 3 mbrojtës të viktimave si dhe 12 bashkëpunëtorë profesioanl dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **III.** | **Objektivi strategjik: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;** | | | | | |
| **III.1** | **Objektivi specifik: Harmonizimi i kornizës ligjore me Konventën Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| III.1.1 | Themelimi dhe Funksionalizimi i plotë i fondit për sigurime shëndetësore dhe qasja në kujdesin shëndetësor | 2023 | Buxheti i Kosovës | **MSH**<br>MFPT<br>Departamenti i Thesarit<br>Banka Qendrore e Kosovës | Janë siguruar burimeve të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financiare për sektorin shëndetësor, përmes ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore të arritshme dhe të përballueshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. | Fondi është themeluar me Statutin e Fondit të miraturar në vitin 2016. Funksionalizimi i plotë i Fondit pason pas Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces. |
| III.1.2 | Nisja e mbledhjes së premiumeve, si dhe rimbursimi i barnave jashtëspitalore si shërbim i parë i fondit për sigurime shëndetësore | 2022 | Buxheti i Kosovës | MSH<br>MFPT<br>Departamenti i Thesarit<br>Banka Qendrore e Kosovës | Është funksionalizu procesi i mbledhjes së premiumeve dhe dhe rimbursimi i barnave jashtëspitalore si shërbim i parë i fondit | Aktivitetet e parapara në Plan fillojnë së zbatuari pas përfundimit të Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mbledhja e premiumeve të sigurimeve shëndetësore nga qytetarët, mbulimi i kostos së premiumeve për kategoritë sociale nga buxheti i Kosovës. | | | | për sigurime shëndetësore | |
| III.1.3 | Organizimi i fushatave për informim publik dhe projekteve tjera të promovimit dhe edukimit shëndetësor me qëllim të rritjes së shkallës së vetëdijes publike dhe pajtueshmërisë me standardet shëndetësore; | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | MSH | Numri i fushatave të mbajtura dhe aktiviteteve promovuese të realizuara | IKSHPK ka organizuar 8 (tetë) fushata për shënimin e Ditëve botërore të shëndetit: Tuberkulozit, Shëndetit, Duhanit, Substancave narkotike, Zemrës, Hipertensionit, Diabetit dhe HIV/AIDS.<br>Janë organizuar 694 aktivitete të edukimit shëndetësor në komunitet, përfshirë ligjeratat për sëmundjet kronike jongjitese, vaksinimin, dukurite negative, faktorët e rrezikut dhe stili i shëndetshëm i jetës, aktiviteti fizik dhe ushqimi i shëndetshëm, shendeti dhe sporti, parandalimi i aksidenteve në komunikacion, duke perfshire edhe komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe personat me aftesi të kufizuara<br>52 trajnime në komunitet<br>- përpilimi i materialeve edukativo-shëndetësore<br>- shqyrtimi dhe aprovimi i materialeve edukative –shëndetësore (fletushka, broshura, videospote)<br>- Rreth 50.000 fletëpalosje dhe broshura të shpërndara<br>- Rreth 5.000 materiale tjera të shpërndara, perfshire roll up banner, fanella, varëse të celësave, fjongo, shalla |
| III.1.4 | Rishikimi dhe plotësim-ndryshimi i kornizës ligjore për Skemën e Ndihmës Sociale | 2020/2021 | Donatorët Buxheti është i paraparë në kuadër të | Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare | Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale i harmonizuar dhe aprovuar | Gajtë vitit 2021 , është themeluar grupi Punues për hartimin e Projekt Ligjit të Skemës se Ndihmës Sociale,pocesi lidhur me pergatijen e këtij projekt ligji është planifikuar në kuadër të ratifikimit të Marrveshjes me B.Boterore për Projektin e Reformes së Skemës së Ndihmës Sociale.<br>Gjatë vitit 2022 është punuar në përgatitjen e Projekligjit për Skemën e Ndihmë Sociale, i cili projekligj është planifikuar të finalizohet dhe aprovohet gjatë vitit 2023. Finalizimi i këtij projeklgji ndërlidhet edhe me fillimin e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Strategjisë Sektoriale e MPMS (2018-2022) | (DPSF)<br><br>Departamenti Ligjor i MFPT,<br><br>ZKM, Komunat | | zbatimit të Projektit të Reformës së Skemës së Ndihmave Sociale, i planifikuar të financohet nga Banka Botërore, i cili projekt ende nuk ka filluar të zbatohet, si rezultat i mos ratifikimit të Marrëveshjes Financiare, e cila deri me tani është proceduar dy(2) herë në Kuvendin e Kosovës.<br>Grupi Punues ka finalizuar Draft-Projekligin e SNS-së, në Gusht/2023 dhe e ka proceduar tek menaxhmenti i Ministrisë për shqyrtim, para se të procedohej për konsultime paraprake dhe publike. Pas ndryshimeve në Planin Legjislativ të vitit 2023 dhe planifikimeve të MFPT që fillimisht të kemi zbatimin e Pilotimit të Skemës së Asistencës Sociale, ky projektligj është planifikuar për aprovim në pjesën e dytë të vitit 2024 |
| III.1.5 | Ministria e Financave ,Punës dhe Transfereve në bashkëpunim me institucionet komeptent dhe Organizatat e Shoqërisë Civile ta harmonizojnë Ligjin e Punës me Direktivat e BE-së | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MFPT | Ligji i punës është harmonizuar me Direktivat e BE-së dhe është aprovuar | Nuk janë ndërrmarë veprime në këtë drejtim. |
| III.1.6 | Të ofrohet përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar | 2021/2022 | Buxhet i Kosovës | MFPT Qendrat për Aftësim Profesional (QAP-të) Qendrat për aftësimin, riaftësimin dhe punësim në Kosovë (QRPK) | Numri i personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë përfituar nga zbatimi i këtij ligji<br><br>Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të | Me vendimin nr. 202 të datës 24.02.2023 të nxjerr nga z.v.Drejtoresha e Përgjithëshme e APRK-së është themeluar Grupi Punues për të analizuar barrierat në legjislacion dhe në politikat e kualifikimeve dhe të aftësimit profesional të personave me aftësi të Kufizuar. Anëtarë të Grupit Punues kanë qenë përfaqësuesë nga APRK-QAP, AKK, Save the Children dhe Forumi Kosovarë i Aftësisë së Kufizuar, ku është hartuar në bashkëpunim me konsulenten Raporti përfundimtar me të gjeturat nga analiza e barrierave në legjislacion dhe në politikat e kualifikimeve dhe të Aftësimit Profesional të personave me aftësi të kufizuara për qasje në tregun e punës, ky Raport pritet të miratohet ditëve në vijm dhe pas miratimit të propozohet për ndryshim dhe plotësim të legjislacionit në fuqi.<br>Me marrëveshje mirëkuptimi me Save the Children`, është arritur të sigurohen kushtet për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në aftësim profesional të organizuar nga QAP në kuadër të APRK. Në kualifikime qe organizohen nga |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor. | QAP, ne 2023 janë perfshire në trajnime 60 persona.<br>Numri i personave me aftësi te Kufizuar të punësuar gjatë vitit 2021 është gjithsejtë 20 persona, nga ata 13 meshkuj dhe 7 femra.<br><br>Numri i personave me aftësi të kufizuar të punësuar gjatë viti 2022 është gjithsejtë 10 persona me aftësi te kufizuar, 7 femra dhe 3 meshkuj.<br><br>Ndërsa në kuadër të masës 1.6, në fazën e parë kanë qene të përfshirë 233 kandidatë (për një periudhë 6, respektivisht 3 mujore) kurse në fazën e dytë gjithsej 161 kandidatë (për një periudhë 6 mujore subvencionim nga Qeveria) që janë punësuar në kuadër të bizneseve/entiteteve. |
| III.1.7 | *Konfrom Ligjit nr. 04/l – 092 për personat e verbër ,të gjithë personat e verbët të lirohen nga nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, duke përfshi edhe tatimin në pronë.* | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | Komunat MFPT Departmenti i Tatimit në Pronë (DPT) ZKM/ZQM | Numri i përfituesve (versonave të verbër ), të cilët/at janë liruar nga pagesa e tatimit në pronë | Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2023 janë parashtruar gjithsejtë 24 ankesa ndaj vendimeve të komunave për lirim nga tatimi në pronë për shkak të statusit të përfituesit për persona të verbër, nga të cilat 20 ankesa janë aprovuar për t'u liruar nga tatimi në pronë dhe 4 ankesa janë refuzuar për shkak se tatimpaguesi/ankuesi nuk i përkiste kategorisë së personave të verbër.<br>Vlen të theksohet se në vazhdimësi komunat kanë aprovuar ankesat e personave të verbër për lirim nga tatimi në pronë në përputhje me opinionin ligjor të lëshuar nga DTP për komunat, përveç komunave të Gjakovës dhe Prizrenit nga të cilat i kemi pranuar 24 ankesat e tatimpaguesve.<br>**DTP ju ka përcjellur njoftim komunave që të fillojnë zbatimin e lirimit nga ngarkesa e tatimit në pronë për personat e verbër, ku ka filluar edhe të zbatohet nga komunat, mirëpo sa i përket numrit të personave secila komune e ka evidencën e vet varësisht nga rastet individuale që janë lajmëruar nepër komuna.**<br>**Në komunën e** F.Kosoves janë të liruar nga tatimi në pronë 3 persona të verbër .<br>Komuna e Malishevës ka liruar nga pagesa e tatimit në pronë personat e verbër<br>Komuna e Vushtrrise i ka liruar dy persona të verbër, në bazë të kërkesës dhe legjislacionit në fuqi<br>Në Komunën e Kamenicës të gjithë personat e verbër lirohen nga nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, duke përfshi edhe tatimin në pronë, dmth që Ligji nr. 04/l – 092 për personat e verbër zbatohet. |
| III.1.8 | Hartimi i Ligjit Gjithëpërfshirës | 2020/2021 | Buxheti i Kosovës | MFPT Departamenti i | Ligji Gjithëpërfshirës për | Ligji Gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara ende është në proces të hartimit.Pritet të procedohet për matim në everi gjatë vitit 2024 |

<table>
<tr><td></td><td>për personat me aftësi të kufizuara</td><td></td><td></td><td>Pensionev e</td><td>personat me aftësi të kufizuara i aprovuar</td><td></td></tr>
<tr><td>III.1. 9</td><td>Raportimi mbi mbështetjen me grante për OJQ-të e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare</td><td>2021-2023</td><td>Buxheti i paraparë në kuadër të buxhetit të MPMS</td><td>MFPT</td><td>Numri i organizatave të licencuara të cilat kanë marrë subvencione, për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare</td><td>Si pjesë e zbatimit të programeve të mbështetjes së sektorit joqeveritar të licencuara në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2021, 2022 ,2023 të dhënat janë si në vijim:
<table>
<tr><td>MFPT</td><td>2021</td><td>900.000.00 euro</td></tr>
<tr><td>MFPT</td><td>2022</td><td>1,000.000.00 euro</td></tr>
<tr><td>MD</td><td>2023</td><td>1.500.000.00 euro</td></tr>
</table>
<table>
<tr><td>2021</td><td>39 OJQ</td><td>përfituese</td></tr>
<tr><td>2022</td><td>44 OJQ</td><td>përfituese</td></tr>
<tr><td>2023</td><td>45 OJQ</td><td>përfituese</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>III.1. 10</td><td>Të krijohet granti specifik për shërbime sociale dhe familjare</td><td>2021-2022</td><td>Buxheti i Kosovës<br><br>Sa i përket buxhetit për grand specifik, ende nuk ka kaluar ligji, komunat janë duke funksion uar nga grandi i përgjiths hëm.</td><td>Qeveria e Kosovës MFPT Asociacio ni i Komunave të Kosovës (AKK)</td><td>Granti specifik për shërbime sociale dhe familjare i përcaktuar dhe funksionalizu ar</td><td>Ligji për Financat e Pushtetit Lokal në fuqi, rregullon transferet në komuna nëpërmjet tre granteve kryesore ,por ky Ligj nuk e ka te rregulluar Grantin specifik per sherbime sociale. Projekt-ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal ku është paraparë krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale akoma nuk ka është miratuar. Ky Projektligj e rregullon krijimin e Grantit Specifik për Shërbime Sociale me qëllim të sigurimit të financimit të qëndrueshëm dhe të drejtë të shërbimeve sociale në Kosovë.<br><br>Mungesa e Grantit specifik për QPS-në po vështirëson ende kryerjen e punëve dhe planifikimin për shërbimet që janë imanente për shkak të mungesës së mjeteve financiare por ofrohen shërbimet më të limituara por megjithatë konform përgjegjësisë ligjore po arrihen që të realizohen sikur: Financimi i strehimorëve për strehim të viktimave të dhunës në familje, Përkrahja financiare e viktimave të dhunës dhe fëmijëve me përkrahje të limituar edhe te disa programeve të tjera sociale etj.</td></tr>
<tr><td>III.1. 11</td><td>Organizimi i fushatave për informim publik dhe projekteve</td><td>Në vazhdi mësi</td><td>Buxheti i Kosovës Donatorë t</td><td>MFPT Departame nti për politika sociale</td><td>Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuese</td><td>Departamenti i shërbimeve sociale në MD<br><br>Gjate vitit 2023 jane organizuar tre fushata në nivel Nacional:<br>Muaji kunder trafikimit me qenie njerzore,<br>16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj Gruas</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | tjera promovuese me qëllim të informimit të qytetarëve se ku mund të marrin shërbime dhe çfarë lloj shërbime sociale dhe familjare ofrohen | | | dhe familjare | të realizuara<br><br>Niveli i gjithëpërfshirjes së fushatave dhe aktiviteteve promovuese, me fokus në zonat rurale dhe grupet e margjinalizuara; | Fushata nje vjeçare me moton "HAPE DERËN, ÇELE ZEMRËN! – BËHU FAMILJE STREHUESE", fushate në kuadër të mbrojtjes së fëmijeve implementuar nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtesise dhe OJQ Partnere.<br><br>Në vazhdimësi, bëhet ,Informimi i komuniteteve përmes bisedave, takimeve komunitare , fletushkave, udhëzuesve mbi të drejtat themelore ne fushën e mirëqenies sociale.<br>Informimi publik - shpallje publike në web faqen e MD-së, për OjQ- përfituese dhe llojet e programeve në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare ofrohen nga OJQ-të<br>Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2023 ka hapur Thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve efiçiente për ngrohje; Pajisjeve shtëpiake efiçinete, Pompë termike, Kondicioner, Klimë efiçiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efiçiencë të lartë), Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket); Stufa individuale me biomasë si dhe për mbështetjen e ndërmarjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në pajisje efiçiente për ngrohje.<br>Thirrjen për subvencionim me Pompë termike, Kondicioner, klimë efiçiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efiçiencë të lartë), Ministria e Ekonomisë ka ofruar masa lehtësuese për disa kategori të cilat kanë nevojë për përkrahje dhe mbështetje, pra për prindërit vetëushqyes gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive, për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) është subvencionuar gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive. Kurse për Stufa individuale me biomasë, për prindërit vetëushqyes janë subvencionuar nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive, për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) janë subvencionuar nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive.<br>Thirrja publike për subvencionimin e Ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në pajisje efiçiente për ngrohje, shqyrtimi i aplikuseve është duke vazhduar edhe gjate këtij viti, ku deri me tani kanë përfituar 20 aplikues në kategorinë e klimave, ku nga këta 20 përfitues, 3 prej tyre janë femra, të cilat gëzojnë të drejtën e përfitimit në përqindje, 5%. Pra për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave nga pesëdhjetë e një për qind (51%) e tutje, vlera e subvencionimit është njëzet e pesë për qind (25%).<br>Përfitues total të gjitha masave gjithsejtë është 11454 aplikues, ku prej tyre 2510 apo 22% janë femra dhe 8944 apo 78%meshkuj.<br><br>Komuna e Podujeves ka realizuar në vazhdimësi gjatë kësaj periudhe shtatë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | fushata vetdijësuese nëpër lokalitete të ndryshme të Komunës ku tri fushata i'u kanë kushtuar zonave rurale më të thella me një pjesëmarrje solide edhe nga ana gjinore si edhe pjesëmarrja e të rinjëve ku është sqaruar ana ligjore se qka parashihet nga Ligji për Familjen dhe Ligji për Shërbimet Sociale dhe në cilat kategori i përfshin dhe të tjerë, edhe për kategoritë të tjera për grupet e margjinalizuara komunitetet dhe OJQ – Handikos. |
| **III.2** | **Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve dhe vetëdijes shoqërore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| III.2.1 | Qeveria e Kosovës të inicoj formimin e një trupe ndër-institucionale që do ti koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e "Agjendës së Gjelbër" | 2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MMPHI Ministrit ZPS (Zyra për Planifikim Strategjik) Komunat ZKM/ZQM BE KE | Me vendim të Qeverisë është themeluar trupa ndërinstitucionale që do ti koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e "Agjendës së Gjelbër"<br><br>Trupa ndërinstitucionale ka hartuar Planin Kombëtar për zbatimin e "Agjendës së Gjelbër" | Kjo trupe ndër-institucionale është formuar dhe funksionon në kuadër të projektit EU4Green dhe udhëhiqet nga Zyra e Kryesministit. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor reflekton Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe bazohet në pesë shtylla kryesore: dekarbonizimi, ndotja, biodiversiteti, ekonomia qarkulluese (qarkore) dhe sistemet e qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit.<br>"EU4Green krijon një shtysë të rëndësishme për ta bërë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor të pranishme dhe efektive. Agjenda e Gjelbër do të mbështesë njëkohësisht si objektivin drejt një tranzicioni të qëndrueshëm dhe të drejtë të kontinentit, ashtu edhe procesin e anëtarësimit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor në BE," . |
| III.2.2 | Projekte vetëdijësuese dhe | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorë | MMPHI MAPL MBPZHR/ | Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësi | Lidhur me këtë masë ka pas aktivitete dhe takime të ndryshme të organizuara nga niveli qendror dhe lokal i qeverisjes.Në pamundësi me i prezantu të gjitha ,në vijim i kemi prezantuar vetëm disa prej tyre ,kërkojmë mirëkuptim prej |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | fushata avokimi për të rinjtë lidhur me mbrojtjen e mjedisit (mbrojtjen e florës dhe faunës ) | | t | Agjencion i i Pylltarisë MASHTI MKRS Komunat | mit të të rinjve për çështjet mjedisore përmes aktiviteteve të angazhimit qytetar.<br><br>Numri i projekteve dhe fushatave avokuese të organizuara me të rinjtë dhe për të rinjtë | institucioneve nga niveli lokal i qeverisjes.<br><br>Në kuadër të aktivitetete të MMPHI gjate vitit 2023 jane mbajtur dhjetëra aktivitete vetëdijesuese dhe fushata avokimi për të rinjtë lidhur me mbrojtjen e mjedisit ne kuadër të shënimit te ngjarjeve mjedisore në kuadër të kalendarit mjedisor për vitin 2023.<br>MMPHI në bashkëorganizim me MASHTI, Fondacionin për të drejtat e kafshëve, OJQ ERA, kanë shënuar “Ditën Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve”<br>MASHTI u ka sugjeruar shkollave/ komunave që të realizojnë aktivitete ndërgjegjësuese për planetin në përgjithësi, tema këto që janë pjesë e kurrikulave dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. Shkollat kanë realizuar aktivite cilësore dhe të llojlloshme. Janë shënuar edhe datat mjedisore në bashkëpunim me MMPHI, ku edhe MASHTI merr pjesë. Bëhet fjalë për Ditën e ujit, Ditën e Tokës, Ditën e Mjedisit, Biodiversitetit, etj.<br>Komuna e Prishtinës -Asamblea e fëmijëve të kryeqytetet ka mbajt fushatë ne ditën e tokës dhe në kohen e festave të fund vitit kemi bere dekore me materjale të Riperdorshme për ti vetëdijesuar të rinjët tanë për mbrojtjen e mjedisit.<br>Komuna e Kamenices- Këshilli i Veprimit Rinor Lokal ka organizuar aktivitete me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për çështjet mjedisore.DKA,përkatësisht shkollat në vazhdimësi organizojnë fushata vetdijësuese lidhur me mbrojtjen e mjedisit qoftë përmes mësimdhënësve të edukatës qytetare, psikologëve dhe pedagogëve në shkolla.<br>Komuna e Podujeves- Projekte vetdijësuese dhe fushata avokimit për të rinjë dhe mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e florës dhe faunës i kushtohet në koordinim të ngushtë me DKA dhe OJQ-të që realizojnë projekte të kësaj natyre në komunë, duke pasur parasysh mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit si dhe zhvillimit të kulturës të të rinjëve për një ambient sa më të mirë dhe mbrojtjes së ujërave si dhe mbrojtjes së faunës në Komunën tonë që padyshim është shumë e rëndësishme edhe si komponent për zhvillimin e turizmit malor.<br>Kom e .F.Kosovës Është mbajtur aktivitet pastrimi në kuadër të ditës së tokës 22 Prilli dhe ditës boterore të mjedisit me 5 Qershor në ambientet e shkollave fillore ne qytetin e Fushë Kosovës.<br>Komuna e Rahoveit- Eshte mbajtur aktivitet pastrimi për nder të ditës se tokës 22 Prilli dhe ditës botëroret të mjedisit me 5 Qershor në ambientet e shkollave fillore ne qytetin e Rahovecit. Në vazhdimësi i kushtohet vëmdenje ndërgjegjësimit të qytetarve ndaj ndotjes se ajrit, ruajtjes së ekologjisë, gjelbrimit dhe largimit të depunive ilegale. Fushata të tilla mbahen të shpeshta me nxënesit e shkollave fillore dhe të mesme, në media lokale, dhe aksione të ndryshme të pastrimit me të rinjet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Komuna e Malishevës -Ne bashkepunim me Health of Nature in Kosova kanë realizuar aktivitete të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit, vlenë të permendet kuizi ekologjik me nxënës ku edhe janë ndarë mirënjohje për vendet e para.<br>Komuna e Istogut -në kuadër të vetëdijësimit dhe ndërgjegjësimit qytetar të të rinjtë ne si DKA konsiderojmë se arsimimi nëpër shkollat tona jep një kontribut të madh përmes organizimit të punës me grupet e EKOLOGËVE në nivel shkollash si dhe pjesëmarrja e nxënësve në aksionet,si: ta Pastrojmë Kosovën. Sa i takon numrit të projekteve të cilat koontribuojnë në këtë fushë theksojmë se DKA-ja në Istog ka arritur Memorandume bashkëpinimi me OJQ-TOKA, projekt 3 vjeçar që trajton tema për ruajtjen Mjedisore<br>. |
| III.2. 3 | Organizimi i fushatave për informim publik dhe projektet e tjera të promovimit dhe edukimit të popullatës për mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorë t | MMPHI MBPZHR Komunat Ministrit OJQ-të Komisioni Evropian | Numri i fushatave dhe aktiviteteve promovuse të realizuara sa i përket sigurimit të një ambienti të shëndetshëm dhe të sigurtë për qytetarët | Në kuadër të aktivitetete të MMPHI gjatë vitit 2023 janë mbajtur dhjetëra aktivitete vetëdijesuese dhe fushata avokimi për të rinjtë lidhur me mbrojtjen e mjedisit në kuadër të shënimit të ngjarjeve mjedisore në kuadër të kalendarit mjedisor për vitin 2023.<br>Fushata për vetëdijesim për cilësin e ajrit dhe mbrojtjen e natyrës janë mbajtur edhe në kuadër të projektit të bashkëpunimit në mes të AMMK dhe Agjencise se Mjedisit të Suedis.<br>MBPZHR ka zhvilluar aktivitete ne ndërgjegjësimin e publikut bazuar në dokumentin- Strategjia e Komunikimit dhe Informimit për Pylltarine 2021 - 2025:<br>- Dita Ndërkombëtare e Pyjeve 21 Mars manifestim publik në Blinajë-përfitues dy shkolla të Lipjanit<br>- Tryezë e rrumbullakët me OJQ-ve me temën Menaxhimi i Qendryeshem i Pyjeve fushatë ndërgjegjësuese<br>- Trajnim për raportim mediatik për Pylltarine, pjesëmarrës 10-15 gazetar si pjesë e ngritjes së kapaciteteve për të raportuar për pylltarinë.<br>- Fushata ‘Duaj dhe Ruaj Pyjet’<br>- MBPZHR me sukses ka integuar me ndihmën e FAOS prespektiven gjinore.<br>Fushata senzibilizuese për ndalimin e punëve të rënda në pylltari në 6 regjionet e Kososvës,<br>Promivimi i Ligjit Nr.08/L-137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.09/03 Prill 2023), dhe Ligjit Nr.08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.08/29 Mars 2023)<br>-<br>MBPZHR është mbështetur nga FAO në prespektiven gjinore dhe ka zhvilluar aktivitete ne vetedisimin e qytetareve ne brojten e natyrës dhe ambientit ne toka pyore. MBPZH ka hartuar dhe ka miratuar Udheuesin per Keshilltar Komunal |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | per Bujqesi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Me qellim te zbatimit te Ligjit per Mbrotjen e Femijes Nr.06/L-084 si dhe parandalimit te punëve te rrezikshme ne bujqësi dhe pylltari.<br>Komuna e Prishtinës, me grat e kryeqytetit ka mbajtë trajnim në lidhje me kursimin e energjisë elektrike dhe hudhjes së mbeturinave |
| III.2.4 | Të përmirësohet dhe përditësohet në vazhdimësi sistemi i informimit të publikut, i cili njëherësh do të ishte masë parandaluese e ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin dhe jetën e njeriut. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës | MMPHI Agjencion i për mbrojtjen e Mjedisit Policia e Kosovës | Sistemi i informimit për qeshjet e mjedisit funksional ,transparent dhe informon me kohe qytetarët lidhur me çështjet mjedisore | MMPH-Në kuadër të procesit të ngritjes së Sistemit Informativ Mjedisor, është zhvilluar portali për Cilësinë e ajrit (Air Quality Kosova https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/about-air-quality-portal/). Po ashtu është zhvilluar edhe Sistemi Informativ për Raportim për Mbeturina, dhe është në proces të funksionalizimiti regjistri për Kemikate dhe mbeturina të rrezikshme. Për nevoja të informimit të publikut po ashtu është në dispozicion edhe ueb faqja e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (www.ammk-rks.net ) dhe ueb faqja e Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (https://ihmk-rks.net/). Në të dy këto ueb faqe ofrohen informata për gjendjen e mjedisit dhe në mënyrë specifike për gjendjen e ajrit, ujerave, tokës, mbeturinave dhe biodivesitetit.<br><br>Është mirëmbajtur dhe përmirësuar portali për cilësin e ajrit (https://airqualitykosova.rks-gov.net/?lang=sq) si dhe janë publikuar të dhëna dhe informata në ueb faqen e AMMK (ammk-rks.net) dhe të IHMK (ihmk-rks.net)<br>Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Preventiv në vazhdimësi angazhohet në informimin e komunitetit lidhur me rëndësin e një mjedisi të sigurt dhe mbrojtjen e ambientit dhe evitimin e rreziqeve nga hapësirat publike duke bashkëpunuar me mekanizmat relevant. |
| III.2.5 | Të fuqizohen kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatësve dhe Policisë së Kosovës me trajnime lidhur me trajtimin e lëndëve që dalin | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Akademia e Drejtësisë Akademia për Siguri Publike Këshilli Prokurorial i | Numri i trajnimeve të realizuara dhe numri i zyrtarëve të trajnuar nga gjygjesori, prokuroria dhe policia | Numri i trajnimeve te mbajtura nga Policia e Kosoves gjate vitit 2023 është 8.<br>Numri i zyrtareve të trajnuar për vitin 2023 është 35.<br>Ndërsa gjate vitit 2023 ne Policine e Kosoves janë raportuar 909 Raste nga kapitulli XXVIII: VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË, dhe 249 Raste nga kapitulli XXVII: VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE,;<br>Temat ku përfshihen cenime dhe vepra nga kapitulli XXVIII i Kodit Penal janë të trajtuara në:<br>-Trajnimi Profesional Zyrtar Policor (moduli 4) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | nga kapitulli XXVIII i Kodit Penal | | | Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës Policia e Kosovës | lidhur me veprat penale që i dedikohen mjedisit | Gjithsej - 433 kadetë janë trajnuar.<br>-Trajnimi i Avancuar i Hetimit te Krimit (masat e veçanta hetimore)<br>Gjithsej - 31 vijues<br>Totali i Trajnimeve: 2<br>Vijues të trajnuar 464 |
| III.2.6 | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ta vendosin bazën e të dhënave lidhur me trajtimin e lëndëve kundër mjedisit. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës | Baza e të dhënave lidhur me trajtimin e lëndëve kundër mjedisit e funksionalizuar | Nuk janë ofruar informacione lidhur me kete aktivitet. |
| III.2.7 | Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me ministrinë, Komunat duhet të hartojnë planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MMPHI** MBPZHR/ Komunat MAPL | Numri i Komunave të cilat kanë hartuar dhe aprovuar planin për mbrojtje të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës. | Komunat mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, deri më tani **27 komuna** kanë hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave komunale ndërsa **11 komuna** (Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Graçanicë, Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Partesh, Zveçan, Klinë) ende nuk kanë hartuar këtë plan. Komunat në vazhdimësi hasin sfida për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale për **shkaqe të fondeve të pamjaftueshme**, mosvetëdijesimit të qytetarëve, mungeses së pagesave nga ana e qytetarëve, numrit të vogël të inspektimeve, mungeses së ndërmarrjeve, stafit jo adekuat për laminë përkatëse, mungeses së pajisjeve të mjaftueshme teknike për kompaninë që menaxhon me mbeturinat etj |
| III.2.8 | Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me ministrin, Komunat duhet të hartojnë Programet lokale | 2021-2023 | Buxheti I Kosovës Donatorët | MMPHI Komunat MAPL | Numri i Komunave të cilat kanë hartuar dhe aprovuar programet dhe masat | Sipas informacioneve të siguruara nga MAPL , Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave, ku vetëm 3 prej tyre kanë hartuar këtë plan.<br>**Komuna e Istogut**- ka të aprovuar PZHK (2019-2027) dhe HZK 2024-2032, ku me këto dy plane hapësinore përcaktohen zonat e ndërtimit në lokacionet e caktuara, varësisht nga kapaciteti i pranueshëm i ndotjes së mjedisit dhe qëllimeve të ndërtimit brenda vendeve të caktuara në kuadër të këtyre |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda komunave në harmoni me Strategjinë kosovare të mbrojtjës së ajrit nga ndotja. | | | | për parandalimin apo uljen e nivelit të ndotjes së ajrit<br><br>Numri i aktiviteteve për zbatimin e programeve per parandalimin dhe uljen e nivelit të ndotjes së ajrit | lokacioneve.<br>Në zonat e mbrojtura lejohet kryerja e aktiviteteve në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e veçanta, në përputhje me natyrën e ngarkesës së mjedisit. Komuna ka planin e veprimit lokal në mjedis ose programe mjedisore për mbrojtjen e mjedisit,<br>**Komuna e Vushtrrisë** - ka të hartuar planin për mbrojtje të mjedisit.<br>**Komuna e Podujevës-** Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifik Hapsinor ka aprovuar planin Harta Zonale në të cilën është bazë e zhvillimit të përgjithshëm në përputhje me Strategjinë e Mbrojtjes së Ujërave, Mbrojtjes së Ambientit dhe Mjedisit.<br>Tri komuna kanë hartuar dhe miratuar PLVCA;Obilqi ,Fushë Kosava ,Rahoveci<br>Është duke u zbvilluar projekti "Zhvillimi i kapaciteteve për kontrollin e ndotjes se ajrit" i financuar nga JICA, ku përfshihen 6 aktivitete të vazhdueshme<br>**Fushë Kosova**, ka miratuar Plani Lokal për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja për vitet 2023-2027,në përputhje me Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj .<br>**Komuna e Istogut** -Po ashtu në kuader të Planit Lokal të Veprimit për cilësi të ajrit mbetet të thëksohet edhe aktiviteti me një pilot projekt të financuar JICA Japonezë të projektit ECO-DRR kemi mbjellë 250 fidanë të llojit Bli , Pishë e Zezë dhe Bredh i Bardhë që kanë një ndikim për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë e ekosistemit.<br>Është miratuar Plani Lokal për Mbrojetjen e ajrit nga ndotja për Komunën e Rahovecit 2024-2029. |
| III.2.8.1 | Institucionet kompetente konform legjislacionit në fuqi t`i ndërrmarin veprimet e nevojshme për sigurimin e sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe mbrojtjen e | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë se Kosovës (AUVK) Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të | Numri i kontrolleve dhe masave parandaluese me qëllim të parandalimit të cenimit të shëndetit publik dhe konsumatorëve nga ushqimet (produktet | Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitrit 2023 për mbrojtjen e shëndetit publik ka realizuar:<br>81.476 kontrolle zyrtare të operatorëve të bizneseve që merren me ushqim si gjatë importit ashtu edhe ato vendore.<br>Këto kontrolle janë realizuar nga inspektorët veterinarë, fitosanitarë dhe sanitarë, sipas fushave relevante të inspektimit dhe natyrës së produkteve.<br>Nga këto kontrolle janë testuar 3.592 mostra të analizuara në laboratore brenda dhe jashtë vendit!<br>Produktet të cilat ishin jo conform rregullave shëndetsore janë asgjësuar si vijon:<br>374,770 kg produkte të mishit;<br>74,522 kg produkte të qumështit;4.842 kg mjaltë;125 kg peshk; 155,491 kg produkte fitosanitare; 950,565 kg produkte të përziera sanitare; |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shëndetit publik dhe Konsumatorit | | | Kosovës (IKSHP) MBPZHR MSH Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë Departamenti për mbrojtjen e Konsumatorit Policia e Kosovës | vendore), dhe ato të importuara<br><br>Numri i masave të shqiptuara ndaj atyre që e cenojnë sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe Konsumatorit | Nga sëmundjet ngjitëse të kafshëve janë asgjësuar 345 krerë gjedhe;29 krerë dhenë dhe dhi;1082 derra dhe 171 koshere bletësh.<br>48 ngarkesave iu është rrefuzuar importi në Republikën e Kosovës |
| III.2. 8.2 | Të bëhen hulumtime të vazhdueshme mbi ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë në burra dhe gra. | 2021/2022 | Buxheti Kosovës Donatorët | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) | Analiza Gjinore e perpiluar mbi ndikimin e faktoreve mjedisore në burra dhe gra;<br><br>Janë ndërrmarë hulumtimet dhe janë propozuar masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme të faktorve të mjedisit në | Departamenti i Ekologjisë Humane në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK),në vazhdimësi kryen detyrat si në vijim: monitorimi, vlerësimi, parandalimi dhe korrigjimi i faktorëve të mjedisit me efekte të dëmshme në shëndet dhe mbështetja e aktiviteteve që përmirësojnë cilësinë e mjedisit që drejtperdrejt ndikojnë në kualitetin e shëndetit. Këto realizohen nëpërmjet: Monitorimit, hulumtimit dhe vlerësimit të sigurisë së ushqimit në shkallë vendi. • Monitorimit, hulumtimit dhe vlerësimit të sigurisë së ujit të pijshëm, ujit për rekreacion, dhe situatës së furnizimit me ujë për pije në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. • Monitorimit të statusit nutritiv të popullatës, sidomos të grup moshave vulnerabile të popullatës (fëmijët, gratë shtatzëna dhe të moshuarit). • Monitorimit, hulumtimit dhe vlerësimit të kualitetit të ajrit dhe ndikimit të tij në shëndet;<br>I mbështetur nga Zyra e OBSH -së UNDP, IKSHPK gjatë vitit 2022-2023, ka bërë hulutimin mbi “Vlerësimin e cilësisë së ajrit të brendshëm në amvisërit e Kosovës”, studim ky i kryer në 2000 amvisëri të Republikës së Kosovës, mbi mënyrën e ngrohjes dhe gatimit. Poashtu në 25 amvisëritë e intervistuara më herët kemi bërë matjet për formaldehide, benzen, dhe $NO_2$ brenda dhe jashtë shëpive, ndërsa matjet per CO, CO2, T dhe lagështi relative janë analizuar në 25 amvisëri<br>Dokumentijn mund ta shkarkoni në;<br>linkun: https://niph-rks.org/ |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | shëndetin e popullsisë | |
| III.2. 8.3 | Përcaktimi i kushteve mikroklimatike në ambientet shkollore | 2020 | Donatorët OBSH | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Publike të Kosovës (IKSHP) MASHTI | Për here të pare në Kosovë do të zhvillohet metodologjia e punës në mjediset shkollore dhe do të analizohen parametrat kimik me ndikim në shendetin e fëmijeve në Institucionet Publike | I mbështetur nga Zyra e OBSH-së UNDP, IKSHPK gjatë vitit 2021 ka bërë hulumtim mbi kushtet mikroklimatike në shkolla dhe ujin, higjienën dhe sanitacionin në 10 shkolla të Komunës së Prishtinës, Fushë Kosoves dhe Obiliqit.<br>Parametrat qe janë testuar në 3 klasë te secilës shkollë dhe në oborrin e shkollës kanë qenë: formaldehidet, benzeni. NO2, CO, CO2, T dhe Lagështia relative.<br>Jane marrë nga një mostër e ujit për pije në secilën shkollë dhe janë plotësuar 10 pyetësor me administratorët e shkollës, 900 pyetësor me nxënës dhe 30 inspektime në lokacionet e shkollave si dhe inspektimi I te gjitha nyjeve sanitare në shkolla.<br>Raportin e keni te publikuar ne webfaqen e IKSHPK dhe e gjeni ne linkun: https://niph-rks.org/ |
| III.2. 8.4 | Menaxhimi i informatave mbi kualitetin e ajrit, ndryshimet e sjelljes dhe shërbimet e komunikimit | 2021-2022 | Donatorët Millenium Challenge Corporati-on dhe Millenium Foundation Kosovo | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Publike të Kosovës (IKSHP) | Zhvillimi i këshillave shendetesore si pasojë e mjedisit të ndotur, të dizajnoj kampanjën, trajnime, punëtori për Qeverine, Institucionet, shoqërinë civile, OJQ, gazetarët. Asistencë IKSHPK-se, mbi | I mbështetur nga MCC, MSH/IKSHPK gjatë viteve 2021-2022, ka qenë pjesë e projektit : “Supply of project management, air quality information management, behavior change and communication services”, ku në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara mbi aerondotjen dhe ndikimin ne shëndetin e popullatës, kanë qenë edhe aktivitete te shumta ndër to:<br>-KËSHILLAT SHËNDETËSORE PËR MESAZHET E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM GJATË NDOTJES SË AJRIT, (Qeverinë, profesionistët shëndetësor, gratë shtatëzëna, fëmijët dhe të sëmurët kronik),<br>Realizimi i studimit dhe Vlerësimi i Ndikimit në Shëndet në Kosovë”,<br>-Lansimi i Kampanjës së parë të Kualitetit të ajrit në Kosovë<br>- Promovimin e mjeteve dhe materialeve që kemi zhvilluar në projektin e Cilësisë së Ajrit mbi ndryshimet e sjelljes,(broshura, poster dhe Fact sheets për grupet vulnerabile)<br>Fushatë vetdijësuese mbi rëndësin e aerondotjes e zhvilluar në 7-t Komuna të Republikës së Kosovë**s,**<br>Krijimi i webfaqes në IKSHPK mbi informatat dhe aktivitetet lidhur me aerondotjen<br>Vlerësimi i ndikimit te aerondotjes në shëndet. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | informimin e publikut, grumbullimin dhe interpretimin e informatave ekologjike dhe shëndetësore për grupet vulnerabile te popullatës. Analiza statistikore e të dhënave të morbiditetit dhe mortalitetit që vijnë si pasojë e aerondotjes. | Linku ajri.niph-rks.org |
| III.2.9 | *Sigurimi i kontrollit të vazhdueshëm të kualitetit të ujit për pije, duke përfshirë zonat e mbrojtura ujore sanitare* | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP)/ Qendra e ujit | Numri i kontrolleve të realizuara si dhe rekomandimeve të ardresuara dhe të zbatuara nga institucionet | Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP)/, në vazhdimësi zhvillon hulumtime dhe analiza për cilësinë e ujit të pijshëm dhe ofron udhëzime për menaxhimin e sigurisë së ujit.<br>Ky proces kompleks është jetik për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve, dhe përfshin përgjegjësi të ndryshme nga prodhuesit e ujit deri te organet monitoruese. Sigurimi i ujit të pijshëm është një synim kryesor për të garantuar shëndetin dhe kualitetin e jetës së qytetarëve<br>IKSHPK bënë monitorimin e rregullt të cilësisë së ujit për pije në shkallë Kosove. Për periudhën kohore 2021-2023 gjithsej janë marrë për analiza laboratorike (R1, R2, R3, sipas UA 10/2021), 29508 mostra të ujit për pije. Prej tyre 1544 mostra të ujit apo 5.2% kanë rezultuar jashtë standardit për ujin për pije.<br>(shih raportin vjetor të Departamentitë Ekologjisë humane 2021,2022,2023.<br>Çdo herë kur ka mospërputhshmëri të rezultateve laboratorike me standard jepen rekomandime conform rezultatit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **III.3** | **Objektivi specifik: Garantimi i të drejtave të punëtorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare;** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| III.3.1 | Të rritet numri i inspektimeve dhe inspektorëve, për monitorim rigoroz të zbatimit të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Mbrojtjen dhe Sigurinë në Punë apo për plotësim-ndryshim të ligjeve të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë në punë. | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës | **MFPT Inspektorati i Punës** Këshilli Nacional për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë | Numri i inspektorëve shtesë të angazhuar në kuadër të Inspektoratit të Punës si dhe,<br><br>Numri i inspektimeve dhe gjobave të shqiptuara<br><br>I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. | Numri i inspektorëve të angazhuar në kuadër të Inspektoratit të Punës është për dy ma pak nga 39 sa ishin tani janë 37 (viti 2022). i inspektorëve të angazhar nëkuadër të Inspektoratit të Punës është 37 burra e 7 gra)<br>Numri i inspektimeve dhe gjobave të shqiptuara 281 në tërsi (viti 2022). Nuk kemi të dhëna të ndara për lëmi, sektor, apo për shkelje të veçanta të dispozitave të caktuara shqiptimin e masës së gjobës.<br>Numri i inspektimevetë realizuara është 6316, numri gjobave të shqiptuara 359 në tërsi. Nuk kemi të dhëna të ndara për lëmi, sektor, apo për shkelje të veçanta të dispozitave të<br>Numri i inspektorëve shtesë të angazhuar në kuadër të Inspektoratit të Punës është 34; sipas gjinisë 13 femra dhe 21 meshkuj dhe tani numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës 59 inspektor 41 meshkuj dhe 18 femra (viti 2023)<br>Numri i inspektimeve është 7253 dhe numri i gjobave të shqiptuara është 927.<br>Nr. i aksidenteve të regjistruara është 330 aksidente në të cilin janë aksidentuar 338 persona. Për secilin nga këto raste Inspektorati ka kry inspektim në vendin e ngjarjes. |

<table>
<tr><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td>III.3.<br>2</td><td>Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në Inspektoratin e punës</td><td>Në vazhdi mësi</td><td>Buxheti i Kosovës</td><td>MFPT Inspektorati i Punës</td><td>Rritja e numrit të inspektimeve në sektorët me rrezikshmëri të lartë</td><td>Prioritet iu është dhënë inspektimit të subjekteve në sektorin e ndërtimtarisë, subjekteve në sektorin e prodhimit si dhe subjekteve në sektorin e organizatave shërbyese si sektor të cilët kryejnë punë në kushte ma të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendet e tyre të punës.<br>7253 inspektime janë relizuar për vitin 2023.</td></tr>
<tr><td>III.3.<br>3</td><td>Monitorimi i zbatimit rigoroz të Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë</td><td>Në vazhdi mësi</td><td>Buxheti i Kosovës</td><td>MFPT Inspektorati i Punës Inspektorati Shëndetësor – Ministria e Shëndetësisë</td><td>Raportet mbi monitorimin e zbatimit rigoroz të Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë</td><td>Konform kapaciteteve mbikëqyrëse lidhur me monitorimin e Ligjit të Punës dhe ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë , sipas planifikimit janë kryer 3022 inspektime (informacion i ofruar nga Inspektorati i Punës)<br><br>Numri i inspektimeve të realizuara sipas planifikimit është 3323 inspektime për vitin 2022. Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës dhe Ligjit të sigurisë dhe shëndetit në punë Inspektorati i Punës ka realizuar gjithsejtë 7253 inspektime për vitin 2023.</td></tr>
<tr><td>III.3.<br>4</td><td>Forcimi i kapaciteteve të inspektoratit të punës për adresimin e punësimit joformal</td><td>2021-2022</td><td>Nuk ka kosto shtesë<br><br>Buxheti i përfshirë në Planin eVeprimit të Strategjisë Sektoriale të MPMS-së 2018-2020</td><td>MFPT/ Inspektorati i Punës IKAP, ASK</td><td>Programi i trajnimit i zbatuar dhe numri i inspektorëve të trajnuar</td><td><table><tr><td>Ditë</td><td>Pjesemarres</td><td>Certifikuar per pjesemarrje</td></tr><tr><td>10</td><td>56</td><td>56</td></tr></table><br>Inspektorët e punës janë trajnuar nga siguria dhe shendeti në punë (3 trajnime) dhe 1 trajnim sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit kundër diskriminimit.<br>Në trajnime kanë marr pjesë 59 inspektor.<br>Në inspektime janë përfshi gjithsejtë 45353 punëtor, 28091 meshkuj dhe 16508 femra si dhe punëtor të huaj 51 meshkuj dhe 703 femra.<br>Në punë jo formale pra pa kontrata pune kanë qenë 1762 punëtor meshkuj dhe 967 punëtor femra.</td></tr>
<tr><td>III.3.<br>5</td><td>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të</td><td>2021/2022</td><td>Buxheti i Kosovës</td><td>MFPT Këshilli Nacional për</td><td>Krijimi i bazës ligjore do të mundësonte</td><td>Nuk janë ofruar informacione</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | krijojnë bazën Ligjore për sigurimin e të punësuarve nga aksidentet (fatkeqësitë) në punë dhe sëmundjet profesionale. | | | Sigurinë dhe Shëndetin në Punë | krijimin e një fondi të përbashkët të punëdhënësve dhe punëmarrësve i cili do t'iu siguronte punëtorëve të Kosovës dhe familjeve një trajtim me dinjitet në rast fatkeqësie në punë | |
| **III.4** | **Objektivi specifik: Zhvillimi i programeve për rehabilitim dhe trajtimin e varësisë nga alkooli dhe droga;** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| III.4 .1 | Zhvillimi i programeve për rehabilitim dhe trajtimin e popullatave kyçe vartës nga alkooli dhe droga; | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | **MSH** Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) Departamenti për shëndetsinë në burgje Fondit Global në Kosovë | Programet për rehabilitim dhe trajtimin e popullatave kyqe vartës nga alkooli dhe droga të hartuara Bartës i veprimit është MSH, kurse IKSHPK është pjesëmarrës në grupet punuese per hartimin e dokumenteve | Ministria e Shëndetsisë ka organizuar Ligjërata në shkolla në kuadër të Programit -Pakos bazike me temë "Duhani, akooli dhe drogat".<br>Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë e re kundër drogës për vitin 2024-2028. Disa nga objektivat e strategjisë janë:<br><br>Ndërprerja e kanaleve të distribuimit të drogës në masa të vogla dhe mesme.<br>Zvogëlimi i kërkesës për drogë.<br>Parandalimi i përdorimit të drogës.<br>Sigurimi i qasjes dhe forcimi i shërbimeve të trajtimit, kujdesit dhe rehabilitimit të përdoruesve të drogës.<br>Risocializimi dhe ri-integrimit në shoqëri i përdoruesve të drogës.<br>Kufizimi i përdorimit të drogës në burgje dhe adresimi i nevojave shëndetësore dhe shoqërore të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas lirimit.<br>Ky dokument është një hap i rëndësishëm drejt luftimit të përdorimit të drogave dhe ndërpërmjet tij, Kosova synon të ndikojë në parandalimin dhe trajtimin e këtij sfide sociale. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | strategjike dhe programeve duke ofruar ekspertizën profesionale dhe shkencore | |
| III.4. 2 | Të ndërtohet Qendra rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike | 2022-2023 | Buxheti Donatorët | MSH Klinika Psikiatrike –QKUK | Ndërtimi i Qendrës rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike<br><br>Numri i personave të cilët kanë përfituar dhe marrë shërbime nga Qendra rehabilituese | Gjatë vitit 2023, janë shtuar hapsirat në repartin e sëmundjeve të varësisë në kuadër të Klinikës së Psikiatrisë, me çrast është dyfishuar numri i shtretërve. Është bërë riorganizimi i shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese bazuar në nevojat aktuale dhe të së ardhmes. |
| III.4. 3 | Zhvillimi i programeve për parandalimin dhe eliminimin e stigmës dhe paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it; | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorët | **MSH** Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) Fondi Global për Grupin e Avokimit të Programit HIV dhe TBC në | Programet për parandalimin dhe eliminimin e stigmës dhe paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it të hartuara dhe zbatuara | Në kuadër të programeve për parandalimin dhe eliminimin e stigmës , paragjykimeve dhe trajtimin e personave me HIV-it,IKSHPK gjatë vitit 2023 ka mbajtë ligjerata në shkolla të mesme me temë HIV/AIDS, parandalimi dhe eliminimi i stigmës dhe paragjykimeve ndaj personave të prekur me HIV/AIDS, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kosovë – PAG | | |
| III.4. 4 | Ngritja e kapaciteteve profesionale (për promovim dhe edukim shëndetësor, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues si dhe nevojat specifike shëndetësore të grave dhe burrave). | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorë t | **MSH** Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP Shoqëria Civile Mediat | Numri i fushatave ,aktiviteteve të organizuara lidhur me Informimin, edukimin dhe këshillimin mbi shëndetin seksual dhe riprodhues | IKSHPK –Janë mbajte 15-të trajnime periodike rreth Shëndetit seksual dhe riprodhues, me mësimdhënsit dhe nxënsit e shkollave të mesme, në bashkëpunim me MASHTI, UNFPA dhe KOPF |
| III.4. 5 | Të bëhet Vlerësimi periodik i nivelit të mundshëm të stigmës dhe diskriminimit dhe i kualitetit të shërbimeve të ofruara ndaj popullatave kyçe të rrezikuar nga HIV dhe PJHIV. | Në vazhdi mësi | Buxheti Donatorë t | **MSH** Organizata Botrore e Shëndetsis ë (OBSH) OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovim in e të drejtave të personave të prekur me HIV | Raportet dhe vlerësimet periodike te realizuara. Personat e rrezikuar nga HIV dhe PJHIV, trajtohen në mënyrë humane dhe marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore etj | Nuk janë ofruar informacione |
| III.4. | Të ofrohet trajtim human | Në vazhdi | Buxheti Donatorë | MSH Organizata | Numri i personave të | Përgjate gjithë vitit 2023 janë ofruar trajnime në komunitet për edukim shëndetsor lidhur me parandalimin e infektimit me TB si dhe mundësite e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | dhe shërbime të nevojshme shëndetsore për personat e prekur nga Tuberkulozi (TBC) | mësi | t | Botrore e Shëndetsisë (OBSH) OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të prekur me TBC | prekur nga Tuberkulozi (TBC) të trajtuar në mënyrë humane dhe marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore etj... | diagnostikimit dhe trajtimit për pacientet me TB. Këto trajnime janë mbajte për të gjitha komunitetet por specifikisht për ata Roma , Ashkali dhe Egjiptas.<br>Po ashtu jane shperndare fletepalosje me njohuri për semundjen e Tuberkulozit në komunitet.<br>"Gjatë vitit 2023 sa i përket rasteve të mjekuara nga tuberkulozi në klinikën e Pulmologjis janë mjekuar diku 203 raste, nga ato kanë qenë 111 meshkuj, 92 femra. Kurse, sa i përket rasteve në nivel vendi, janë diku rreth 550 raste. Vlerësohet se diku 600 apo më pak se 600 raste për vitin 2023, çka do të thotë se në krahasim me vitin 2022 vërehet një tendencë e lehtë e rënies së rasteve të reja me tuberkulozë. |
| III.4.7 | Ministria e Arsimit të iniciojë fushata vetëdijësuese në shkolla lidhur me pasojat nga përdorimi i substancave narkotike me qëllim parandalimin; | Në vazhdimësi | Buxheti Donatorët | MASHTI MSH MKRS OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave përdorues të substancave narkotike | Numri i aktiviteteve të realizuara për vetëdijesimin e të rinjve lidhur me pasojat që sjell përdorimi i substancave narkotike | Temat për dukurite negative janë pjesë e planprogramit mësimor në të gjitha klasët që nga niveli fillor deri te ai i mesëmi lartë dhe mësohen të fusha edukatës fizike, sportet dhe shëndeti.<br><br>MASHTI në vazhdimësi ka mbajtur aktivitete ndërgjegjësuese në kontekst të vetëdijësimit dhe parandalimit të dukurive abuzimit me substanca narkotike si dhe pasojave nga përdorimi i tyre negative te gjeneratat e reja.<br><br>Sa i përket specifikisht parandalimit të narkotikëve, Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, gjatë vitit 2022 në bashkëpunim më të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë ka mbajtur 107-të ligjerata për parandalimin dhe pasojat nga substancat narkotike, duke përfshirë shkolla të ndryshme në nivel vendi.<br>Poashtu është mbajtur kampi treditor në Prevallë me të rinjë pjesëmarrës nga qytetet: Prishtinë, Mitrovicë dhe Prizren, ku është diskutuar për pasojat nga përdorimi i substancave narkotike.<br><br>Githashu komunat në bashkëpunim me DKA-të dhe Policinë e Kosovës gjatë gjithë vitit organizojnë fushata sensibizijuese dhe ligjërata nëpër shkolla sa i përket parandalimit të dukurive negative, abuzimit me substanca narkotike si dhe pasojave nga përdorimi i tyre.. |
| III.4.8 | Ministria e Drejtësisë të përkujdeset që të varurit nga narkotikët të cilët | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | MD Shërbimi Korrektues i Kosovës | Personat e varur nga narkotikët kanë marrë tretmanin e | Shërbimi i kujdesit shëndetësor në burgjet e Republikës së Kosovës organizohet dhe funksionon si pjesë integrale e sistemit shëndetësor të vendit. Shërbimi shëndetësor që funksionon në burgje të cilat janë nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të specifikave organizohet dhe mbikëqyret nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DSHB) në Ministrinë e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | janë në vuajtje të dënimit nëpër qendra korrektuese (burgje) të marrin tretmanin e duhur për varësinë e tyre. | | | Shërbimi Sprovues i Kosovës<br>OJQ “Labyrinth” | duhur<br><br>Numri i personave të cilët kanë marrë shërbime<br><br>Të paktën 30 persona të varur nga narkotikët kanë marrë shërbimet dhe tretmanin e duhur | Shëndetësisë.<br><br>Në procesin e pranimit të të burgosurve, nga 4,848 të pranuar, gjatë vizitë së parë mjekësore,janë identifikuar:<br> **3,360** duhanpirës janë pranuar në burgje në këtë periudhë (69.31%);<br> **289** përdorues të alkoolit (5.96%);<br> **795 përdorues të drogave (16.40%);**<br> **127** raste me diabet (2.62%);<br> **342** raste me hipertension (7.05%);<br>Në të gjitha Njësitë shëndetësore të burgjeve ka trajtim të personave dhe program të mirëmbajtjes me terapi me metadon.<br>Gjatë vitit 2023 ka vazhduar trajtimi me terapi zëvendësuese me Metadon për të burgosurit.<br>Lidhur me mënyrën e menaxhimit të programit të metadonit ekzistojnë Praktikat Standarde të Veprimit lidhur me këtë të cilat janë në funksion dhe janë të publikuara në faqen zyrtare të MSh-së te Departamentit shëndetësor i Burgjeve.<br>Gjatë vitit 2023 kemi pasur gjithsejtë **408 persona në program**, ndërsa pozita të reja gjatë vitit 2023 kemi pasur në total 97 pozita për trajtim dhe janë shpenzuar 92,559.50ml Metadon. Në fund të vitit në program me terapi mbajtëse me Metadon, janë 162 persona. |
| **IV.** | **Objektivi strategjik: Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë;** | | | | | |
| **IV.1** | **Objektivi specifik:Rritja e efikasitetit të trajtimit të lëndëve nga gjykatat dhe prokurorit**<br>**Progresi në zbatim** | | | | | |
| IV.1.1 | Reduktimi dhe zgjidhja e lëndëve të vjetra, përmes përfshirjes së profesioneve të lira ligjore, ku përfshihen ndërmjetësuesit, noterët e përmbaruesit | 2021-2023 | Buxheti Donatorët | Ministria e Drejtësisë, Departamenti për profesione të lira<br>KGJK<br>KPK<br>USAID<br>UNDP | Përfshirja e profesioneve të lira ligjore në zgjidhjen e këtyre lëndëve në mënyrë që ky numër i madh i lendeve të vjetra të zgjidhet sa më parë. | Reduktimi dhe zgjedhja e lëndëve të vjetra, përmes përfshirjes së profesioneve të lira ligjore, ku përfshihen ndërmjetësimi, noterët e përmbaruesit privat.<br><br>Numri aktual është gjithsejtë 50 (pesëdhjetë e pesë) Noterë;<br>• Në vitin 2023 gjithsejtë janë përpiluar/hartuar 644,866 vërtetime/akte, prej tyre 484,039 vërtetime noteriale si dhe 160,827 akte noteriale, këto të dhëna janë sipas raportit vjetor për vitin 2023 të Odes së Noterëve .<br><br>Përmbarues Privat, numri aktual është gjithsejtë 42 (tridhjetë e nëntë);<br>Në vitin 2023 sips raporteve të Përmbaruesve Privat gjithësjtë janë si në vijim:<br>- Numri i lëndëve të pranuara është 26,090 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | privat | | | | | - Numri i lëndëve të zgjidhura është 7,482<br><br>Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vazhdimësi ka promovuar përdorimin e Ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore. Informacione më të zgjeruara ofrohen në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2023.pdf |
| IV.1.2 | Ndërmarrja e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor ,me të cilin do të përcaktoheshin mjetet juridike për rastet që kane te bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut | 2022 | Buxheti Donatorët | MD | Janë përcaktuar mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjygjësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut ,me qëllim të parandalimit të shkeljes apo në formë të kompenzimit | MD është duke e finalizuar draftin e Koncept dokumentit për realizimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtën e palëve në gjykim brenda kohës së arsyeshme, janë mbajtur dy punëtori me përkrahjen e Programit për Drejtësi - EUKOJUST janë angazhuar dy ekspert vendor, posa të finalizohet drafti do të shpërndahet për konsultime paraprake, MD është duke punuar qe brenda këtij viti të procedohet në Qeveri për shqyrtim dhe miratim.<br>Më 29.6.2023 është miratuar Koncept Dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme. |
| IV.1.3 | Të zvogëlohet numri i parashkrimit të lëndeve të qytetarëve në gjykata dhe prokurori | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KPK | Eshtë zvogëluar numri i parashkrimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori | KGJK në vazhdimësi ka ndërmarr veprime për zvogëlimin e lëndëve, duke shtuar numrin e gjyqtarëve të ri duke bërë rekrutimin e 49 gjyqtarëve dhe shtimin e stafit mbështetëses, po ashtu KGJK-ja ka miratuar Planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025 efikasiteti dhe prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor, ku do tu jepet dhe po i ipet prioritet lëndëve që janë afër parashkrimit.<br>Informacione më të zgjeruara ofrohen në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2023.pdf |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.1.4 | Këshillat, duhet të hetojnë në thellësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve për çdo rast, pa asnjë përjashtim dhe të inicojnë procedura përkatëse ndaj përgjegjësve që kanë lejuar parashkrimin e lëndëve gjyqësore | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KPK | Numri i hetimeve të ndërmarra dhe masave të iniciuara dhe të shqiptuara lidhur me rastet e parashkrimit të lëndëve në gjykata dhe prokurori | KGJK në vazhdimësi i shqyrton kërkesat për inicimin e procedurave disiplinore që vijnë nga Autoritetet Kompetente konform Ligjit Nr. 06/L-057 për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. “Sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji 06/L-057) dhe Rregullores për Procedurën Disiplinore (05/2019) palët në një lëndë gjyqësore kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë ndaj gjyqtarit ose prokurorit.<br>KGJK themeloi Komitetin Këshillëdhënës për Etikën Gjyqësore dhe miratoi një rregullore për procedurat disiplinore kundër anëtarëve të KGJK-së. Të dy Këshillat vazhdojnë të zhvillojnë procedura disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve.<br>Informacione më të zgjeruara ofrohen në **https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/?r=M&tabId=1&cYear=2023** |
| IV.1.5 | Të sigurohet qasje në drejtësi për qytetarët që nuk kane mjete të mjaftueshme financiare, veçanërisht për viktimat e dhunës në baza gjinore, dhunës seksuale, komuniteteve jo-shumicë dhe personat e zhvendosur | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihme Juridike falas si dhe OJQ-të e specializuara (CLARD) etj. | Numri i qytetarëve të cilët kanë përfituar shërbime falas për qasje në drejtësi, i ndarë sipas etnisë dhe gjinisë së përfituesve; | Me ndryshimet ligjore që janë bërë gjatë vitit 2022 është bërë lehtësimi i qasjes në drejtësi për disa kategori të qytetarëve, kjo me Ligjin Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas, ku janë përcaktuar kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike falas ku pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik (pra, pa i shikuar fare kriteret) ndihma juridike falas i ofrohet:<br>1.1. personave të dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999;<br>1.2. viktimave të dhunës në familje;<br>1.3. viktimave dëshmitare të dhunës, të cilët janë në varësinë e viktimave të dhunës ne familje;<br>1.4. viktimave të dhunës në baza gjinore;<br>1.5. viktimave të cilitdo lloj të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual;<br>1.6. viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;<br>1.7. viktimave të mitur;<br>1.8. fëmijëve qe jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;<br>1.9. fëmijëve nën kujdestari që kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;<br>1.10. personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent sipas ligjit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi;<br>1.11. Gazetarëve, gazetarëve të pavarur, fotoreporterëve, kameramanëve dhe redaktorëve që punojnë në/për media të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe/ose në media anëtare në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).<br>Ofrimi i Shërbimeve Juridike Falas: Në ANJF gjatë vitit 2023 është ofruar ndihma juridike falas për të gjithë personat që kanë plotësuar kriteret e parapara me Ligjin 04/L-17 për Ndihmë Juridike Falas dhe Ligjin 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik.<br>Në vitin 2023 ndihma juridike falas u është ofruar 6081 qytetarëve, 2890 femrave dhe 3191 meshkujve. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 5214 shqiptar, 175 serb, 73 boshnjak, 54 turk, 213 ashkali, 156 egjiptian, 137 rom, 54 goran dhe 5 tjerë.<br>Krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 32.19 %, ndërsa krahasuar me vitin 2022 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 3.75 %.<br>ANJF e ka të hartuar një strategji të komunikimit objektiv, qëllimi i së cilës është fokusimi në forcimin e nevojës për informim për të përmirësuar njohuritë ligjore dhe fuqizimin e qytetarëve, veçanërisht individëve ose grupeve në pozitë të pafavorshme, duke ofruar informacione ligjore që drejtojnë në ndërmarrjen e veprimeve përdorimin e platformave ekzistuese të informacionit dhe aktivizimin e një rrjeti të shoqërisë civile, organizatave në nivel lokal dhe të rinjve për të përçuar informacion.<br>ANJF e ka zbatuar Udhëzuesin për Procesimin e Rasteve për Ndihmë Juridike Falas i cili është hartuar me përkrahjen e USAID vite më parë, ku u jepet përparësi rasteve të viktimave të dhunës dhe grupeve të margjinalizuara. Poashtu ka edhe Manualin e Praktikuesve të Ndihmës Juridike në Kosovë – Çështjet civile, familjare dhe pasurore juridike si dhe Manualin e Praktikuesve të Ndihmës Juridike në Kosovë – Çështjet administrative i cili është hartuar gjatë vitit 2023.<br>Agjencia ka bashkëpunuar me Zyrat për Mbrojtjen e Viktimave, Policinë e Kosovës, Strehimoret, Qendrat për Punë Sociale etj. nëpërmjet të cilave viktimat mund të njoftohen me mundësinë për të përfituar ndihmë juridike falas. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Agjencia ka nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për themelimin e Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje në këto komuna:<br>· Shtërpcë<br>· Ranillug<br>· Novobërdë<br>· Klinë<br>· Pejë<br>· Deçan<br>· Istog<br>Me qëllim të bashkëpunimit Zyrat rajonale dhe zyrat mobile për ndihmë juridike falas përditësojnë listën e ofruesve të shërbimeve juridike, organizatave të interesit publik (p.sh. grupet e komuniteteve, grupet e përkrahjes si viktimave, shërbimet e këshillimit, grupeve të avokimit etj.) dhe ofruesve të shërbimeve sociale (p.sh. përkrahja e viktimave, shërbimet e këshillimit, strehimoret, etj.) në rajonin e tyre, duke mbajtur takime me këto grupe për të përcaktuar interesimin e tyre për komunikim të rregullt me Agjencinë. |
| IV.1.6 | Të sigurohet financim i qëndueshëm dhe prania e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (Agjencia) në të gjitha komunat, përmes rritjes së numrit të zyrtarëve për ndihmë juridike në zyrat e saj rajonale; | 2021/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihme Juridike falas si dhe OJQ-të e specializuara (CLARD) etj. | Është rrit numri i zyrtarëve për ndihmë juridike në zyrat rajonale të Agjencisë | ANJF-është ballafaquar me sfida të konsiderueshme për arritjen e objektivave si pasojë e mungesës së buxhetit për shtrirjen e Ndihmës Juridike në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 22, të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ku parashihet themelimi i Zyrave Rajonale dhe Zyrave Mobile për Ndihmë Juridike Falas për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar qasje efikase në sistemin e drejtësisë të përfitojnë shërbime të ofrimit të Ndihmës Juridike Falas.<br>Aktualisht, Ndihma Juridike Falas ofrohet nëpërmjet 7 (shtatë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të cilat funksionojnë në: ZRNJF Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përmes 14 (katërmbëdhjetë) zyrave mobile të cilat funksionojnë në komunat në vijim: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skënderaj dhe Kamenicë.<br>Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor, kemi dorëzuar projekt-propozime te donatorët dhe kemi arritur që ndihma juridike falas të ofrohet edhe përmes 6 (gjashtë) zyrave mobile të përkrahura financiarisht nga GIZ-i deri me 30 Qershor 2023, të cilat kanë funksionuar në komunat: Podujevë, Klinë, Lipjan, Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, duke mundësuar punësimin e 4 (katër) zyrtarëve të cilët kanë ofruar ndihmën juridike falas. Po ashtu Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka edhe Klinikën Mobile Lëvizëse, e cila funksionon për realizimin e fushatave senzibilizuese dhe informuese të qytetarëve.<br><br>Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna ka hasur përkrahje nga Ministria e Drejtësisë. Me qarkoren e fundit buxhetore të vitit 2024 janë siguruar 4 (katër) pozita zyrtar ligjor për zyrat mobile të përkrahura nga GIZ, e po ashtu është lejuar edhe 1 (një) pozitë zyrtar ligjor për hapjen e zyrës mobile edhe në një Komunë tjetër. |
| IV.1.7 | Të sigurohet një numër më i madh i përfaqësimeve në gjykata, përmes financimit të qëndrueshëm. | 2021/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për Ndihmë Juridike falas si dhe OJQ-të e specializuara (CLARD) etj. | Është rritë numri i përfaqësimit të palëve në gjykata | Në periudhën raportuese për vitin 2023 janë angazhuar 584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër) avokatë, prej tyre në procedurë civile 539 (pesëqind e tridhjetë e nëntë), në procedurë administrative 14 (katërmbëdhjetë) dhe në procedurë penale 31 (tridhjetë e një). Krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të angazhimit të avokatëve për 4.84 %.<br>Nga viti në vit, numri i përfaqësimit në gjykata është duke u ngritur në vazhdimësi. |
| IV.1.8 | Të sigurohen lehtësira për qasjen në sistemin e drejtësise për azilkërkuesit, refugjatët, personat pa shtetësi, duke ju | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | KGJK KPK | Numri i shërbimeve të përkthimit të ofruara<br><br>Numri i personave të cilët kanë përfituar shërbime të | KGJK-ja ka krijuar lehtësirat për përdorimin e Gjuhëve, ka bërë licesimin e përkthyeseve dhe intepretëve gjyqësor, procesi i cili ka qenë i mbikëqyrur edhe nga partnerët ndërkombëtar. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | siguruar përkthim adekuat institucional në gjuhët zyrtare dhe gjuhën të cilën e kuptojnë. | | | | përkthimit në gjuhën e tyre | |
| **IV.2** | **Objektivi specifik: Funksionimi i Sistemit të ndërmjetësimit;** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| IV.2.1 | Organizimi i kampanjave vetëdijesuese për të informuar qytetaret për mundësinë e shfrytëzimit të ndërmjetësimit, si dhe promovimin e procesit të ndërmjetësimit | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MD** KGJK Këshilli Prokurorial i Kosovës, | Aktivitetet promovuese të realizuara lidhur me ndërgjegjësimin e publikut për ndërmjetësimin dhe qendrat e ndërmjetësimit; | KGJK-ja në bashkëpunim me USAID është duke e bërë promovimin e Ndërmjetësimit përmes mjeteve të informimit, rrjeteve sociale dhe broshurave. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nën mbështetjen e Programit të USAID-it Drejtësia Komerciale, ka hartuar Protokollin për Referimin e lëndëve të përshtatshme civile në procedurën e Ndërmjetësimit.<br><br>Ky Protokoll ka për qëllim të udhëzojë dhe lehtësojë punën e gjyqtarëve dhe stafit, gjatë procesit të identifikimit dhe referimit të rasteve të cilat janë të përshtatshme të dërgohen në procedurë të ndërmjetësimit. Gjithashtu egziston Procedurat e ndërmjetësimit, do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në ngritjen e efikasitetit, përmirësimin e performancës dhe të imazhit të sistemit gjyqësor, rritjen e besueshmërisë së publikut si dhe ofrimin e zgjidhjeve alternative më të lehta, më të shpejta për qytetarët, duke përmirësuar dukshëm sistemin gjyqësor të Kosovës në në tersi. |
| IV.2.2 | Të promovohet dhe ofrohet ndërmjetësimi si mjet i **zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve** për të gjitha kategoritë e rrezikuara komfor legjislacionit në fuqi, si dhe të sigurohet kompensim dhe financim adekuat | 2021-2023 | Buxheti i Kosovś Donatorët | MD KGJK Këshilli Prokurorial i Kosovës, | Është siguruar buxhet i nevojshëm për funksionimin e shërbimit te ndërmjetësimit<br><br>Numri i përfituesve nga ndërmjetësimi si mjet i zgjidhjeve | MD dhe MASHTI hartuan Udhëzuesin për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve, i cili synon të parandalojë përfshirjen e fëmijëve në vepra penale, duke mos lejuar dhunë e konflikte, dhe duke përmirësuar marrëdhëniet shoqërore brenda shkollës.<br>Edhe pse ndërmjetësimi ka filluar të aplikohet relativisht vonë, statistikat tregojnë se ka ngritje graduale të rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit. Deri më tani janë referuar rreth 11,530 (nuk përfshinë vitin 2016, në tre regjione) raste në procedurë të ndërmjetësimit, dhe kanë rezultuar me arritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes rreth 9,320 raste. Ajo që mund të vërehet nga këto statistika janë rezultatet e marrëveshjes me zgjidhje të suksesshme. Arsye më shumë për të zgjidhur ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.<br>Gjatë vitit 2021 janë miratuar dy Udhëzime Administrative për ndërmjetësimin,<br>- Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 05/2021 për përcaktimin e procedurës së ndërmjetësimit të vetinicimit të rasteve dhe rasteve të referuara nga organi administrativ, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për këtë shërbim | | | | alternative të mosmarrëveshjeve | - Udhëzim Administrativ MD-Nr. 4/2021 Për tarifën e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.<br>Statistikat e rasteve në procedurën e ndërmjetësimit për vitin 2021 të referuara nga gjykatat dhe prokuroritë themelore.<br><br>Rastet e referuara nga gjykatat;<br>Rastet penale kane qene gjithësej 2232 raste, prej tyre të zgjedhura 1830, të pa zgjidhura 383 në procedur19.<br>Rastet civile, kane qene gjithse 887raste, prej tyre të zgjedhura kane qene 642, të pa zgjedhura 222, ne procedur 23.<br><br>Totali i 3119.<br><br>Rastet e referuara nga prokurorit ne vitin 2021 kane qene 2315, prejt tyre janë zgjedhur 1765 raste, te pa zgjedhura 308 raste dhe në pune 240 raste.<br>Zyra e ndërmjetësimit gjatë vitit 2023, ka pasur në punë gjithsej 864 lëndë gjyqësore, prej të cilave 287 lëndë në lëmin penale dhe 577 lëndë në lëmin civile dhe në total janë përfunduar me marrëveshje për ndërmjetësim 397. |
| IV.2.3 | Aty ku është e përshtatshme, mekanizmat e zgjidhjeve informale të mosmarrëveshjeve në rastet e fëmijëve shkelës të ligjit duhet të përdoren, duke përfshirë këtu *zbatimin e masave të ndërmjetësimit* | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Prokurori i shtetit për të mitur Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës MD ANJF OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | Drejtësia restauruese, një qasje alternative në zgjidhjen e pasojave që vijnë nga kryerja e një vepre penale është promovuar | Me datë 14.1.2023 është miratuar Udhëzimi Administartiv (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale.<br><br>Ky Udhëzim ka paraparë Ndërmjtësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve me qëllim të dhënies së mundësisë së kthimit të raporteve normale në mes të bashkëmoshatarëve dhe rehabilitimit të fëmijës dhe re-integrimit të tij në shoqëri. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *dhe praktikës restauruese[4] për të miturit në konflikt me ligjin* | | | | | |
| **IV.3** | **Objektivi specifik: Përmirësimi i zbatimit të drejtës për ndihmë juridike falas;** | | | | | **Progresi në zbatim** |
| IV.3. 1 | Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ushtrimin e së drejtës për ndihmë juridike falas, në mënyrë që të sigurohet qasje efikase në drejtësi për qytetarët që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencia për ndihmë juridike falas (ANJF) Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit | Është rritur vetëdijesimi i qytetarëve lidhur me realizimin e të drejtës në ndihme juridike falas përmes formave dhe aktiviteteve të ndryshme të promovimit | Me qëllim të informimit dhe vetëdijësimit ANJF organizon dhe bëhet pjesë e këtyre fushatave të ndërgjegjësimit:<br>- Java e Ndihmës Juridike Falas me moton "Mbroj të drejtën tënde", janë mbajtur konferenca, takime informuese me akter të ndryshëm komunal, është bërë informimi i qytetarëve përmes shpërndarjes së 5000 broshurave në 4 gjuhë shqip, serbisht, anglisht dhe turqisht si dhe në alfabetin BRAIL, 80 posterëve, 3 spoteve televizive, publikimeve në web faqe dhe rrjete sociale, 5 paraqitjeve në media, ligjeratave në institucione dhe me grupe të interest publik; me kominitetet jo shumicë.<br>Me përkrahjen e donatorit USAID Projekti JAK dhe donatorin GIZ kemi punuar në përgatitjen broshurave, postereve që u shtypen me rastin e Javës së Ndihmës Juridike Falas. Këtë vit kemi përgatitur edhe fletushka të veçanta lidhur me Ndihmën juridike falas për personat e riatdhesuar në Kosovë.<br>- ANJF i është bashkangjitur si çdo vit tjetër edhe këtë vit kampanjës botërore "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore" duke qenë pjesë e dhjetra aktiviteteve të cilat u realizuan nga Ministria e Drejtësisë. Gjatë kësaj kampanje u shpërndanë afro 500 broshura.<br><br>Me qëllim të arritjes së informacionit tek komunitetet jo shumicë gjatë vitit 2023 janë mbajtur:<br>•6 Sesione informative ligjore me komunitetin Rom për Qasjen në Drejtësi së bashku me Eukojust në rajone të ndryshme të Kosovës.<br>•1 Sesion informativ ligjor me komunitetet jo shumicë në rajonin e Pejes nga |

[4] Drejtësia restauruese është një qasje ndaj krimit, e cila njeh pasojat e krimit mbi viktimën, komunitetin në të cilin është kryer krimi dhe shkelësin.Fokusi i saj parësor është të riparojë dëmin e shkaktuar nga shkelja, të zhdëmtojë komunitetin dhe viktimën, si dhe t'i ofrojë kundërvajtësit mundësinë për të dhënë kontributin e tij/saj pozitiv për komunitetin

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ANJF, si dhe shumë takime e tryeza tjera. |
| IV.3. 2 | Të rritet në mënyrë substanciale buxheti për programin e ndihmës juridike falas. | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Qeveria e Kosovës MFPT ANJF | Është siguruar buxhet i nevojshme për ofrim cilësor të ndihmës juridike falas | ANJF është ballafaquar me sfida të konsiderueshme për arritjen e objektivave si pasojë e mungesës së buxhetit për shtrirjen e Ndihmës Juridike në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 22, të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, ku parashihet themelimi i Zyrave Rajonale dhe Zyrave Mobile për Ndihmë Juridike Falas për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar qasje efikase në sistemin e drejtësisë të përfitojnë shërbime të ofrimit të Ndihmës Juridike Falas.<br>Aktualisht, Ndihma Juridike Falas ofrohet nëpërmjet 7 (shtatë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të cilat funksionojnë në: ZRNJF Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përmes 14 (katërmbëdhjetë) zyrave mobile të cilat funksionojnë në komunat në vijim:Fushë Kosovë, Drenas,Deçan, Istog, Suharekë, Dragash,Mitrovicë Veriore,Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok,Malishevë,Graçanicë,Skënderaj dhe Kamenicë.<br>Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.<br><br>Me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor, kemi dorëzuar projekt-propozime te donatorët dhe kemi arritur që ndihma juridike falas të ofrohet edhe përmes 6 (gjashtë) zyrave mobile të përkrahura financiarisht nga GIZ-i deri me 30 Qershor 2023, të cilat kanë funksionuar në komunat: Podujevë, Klinë, Lipjan, Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, duke mundësuar punësimin e 4 (katër) zyrtarëve të cilët kanë ofruar ndihmën juridike falas. Po ashtu ANJF ka edhe Klinikën Mobile Lëvizëse, e cila funksionon për realizimin e fushatave senzibilizuese dhe informuese të qytetarëve.<br>ANJF nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë nenin 22 të Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ku për të arritur mbulueshmëri të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, parashihet hapja e Zyrave Mobile në të gjitha komunat e Kosovës.<br><br>Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna ka hasur përkrahje nga Ministria e Drejtësisë. Me qarkoren e fundit buxhetore të vitit 2024 janë siguruar 4 (katër) pozita zyrtar ligjor për zyrat mobile të përkrahura nga GIZ, e po ashtu është lejuar edhe 1 (një) pozitë zyrtar ligjor për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | hapjen e zyrës mobile edhe në një Komunë tjetër.<br><br>Po ashtu edhe buxheti i ANJF-së në kategorinë mallra dhe shërbime është rritur për **40,000,00 € për vitin 2024.** |
| IV.3.3 | Të rritet bashkëpunimi ndërmjet Agjensionit për Ndihme Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat ofrojnë Ndihme Juridike falas | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas Zyrat rajonale për ndihmë juridike falas OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | Marrëveshjet e mirëkuptimi të arritura ndërmjet Agjensionit për Ndihme Juridike falas dhe Organizatave Joqeveritare të cilat ofrojnë Ndihme Juridike falas | Në Qershor të vitit 2023 është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Rregullorja MD - NR. 05/2023, për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të që hynë në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Andaj bazuar në rregullore janë përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme; është hapur thirrja publike për OJQ-të për aplikim për hyrje në partneritet, është formuar Komisioni për vlerësimin e kritereve dhe nga velrësimet e Komisonit, gjashtë OJQ kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në rregullore. Andaj tani jemi në fazën e lidhjes së Marrëveshjeve të Partneritetit me OJQ-të. |
| IV.3.4 | OJQ-të ofrojnë shërbime juridike të autorizuara në bazë të kritereve të përcaktuara nga Këshilli, me propozim të Drejtorit të Agjencisë për Ndihmë Juridike falas | 2021-2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas OJQ-të që ofrojnë ndihme juridike falas | Kriteret janë të përcaktuara dhe shërbimet ofrohen komfor kritereve | Në Qershor të vitit 2023 është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Rregullorja MD - NR. 05/2023, për përcaktimin e kritereve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të që hynë në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Andaj bazuar në rregullore janë përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme; është hapur thirrja publike për OJQ-të për aplikim për hyrje në partneritet, është formuar Komisioni për vlerësimin e kritereve dhe nga velrësimet e Komisonit, gjashtë OJQ kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në rregullore. Andaj tani jemi në fazën e lidhjes së Marrëveshjeve të Partneritetit me OJQ-të. |
| **IV.4** | **Objektivi specifik: Lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit, në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje;**<br>**Progresi në zbatim** | | | | | |
| IV.4. | Të raportohet mbi financimin e | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | **MD** Komisioni | Është zbatuar Ligji Nr. | Në periudhën Janar-Dhetor 2023, nga programi për kompenzim kanë përfituar 129 (njëqind e njëzet e nëntë) viktima. Shuma totale e taksës për kompenzimin |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | qëndrueshëm për programin e kompensimit të viktimave të krimit, të paraparë në Ligji Nr. 05/L -036 për kompensimin e viktimave të krimit; | | Donatorët | për kompensimin e viktimës së krimit KPK KGJK Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave Zyrat për ndihmë juridike falas OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima. | 05/L -036 për kompensimin e viktimave të krimit, si dhe është bërë kompensimi i viktimave komfor dëmit të shkaktuar<br><br>Numri i viktimave të cilët/at kanë përfituar kompensim konform Ligjit Nr. 05/L -036 për kompensimin e viktimave të krimit | e viktimave të krimit në vitin 2023 ka qenë **228,978.00€**<br><br>Gajtë vitit 2023, gjithësej 129 (njëqind e njëzet e nëntë) viktima kanë përfituar kompenzim |
| IV.4.2 | Zbutja e pengesave për mbrojtjen e viktimave të krimit, konform detyrimeve ligjore të institucioneve përkatëse | 2021/2022 | Buxheti i Kosovës Donatorët | **MD** Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit KPK KGJK Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave | Është amandamentuar dhe aprovuar Ligji për Kompenzimin e Viktimave të krimit<br><br>Instucionet kompetente që vijnë në kontakt me | Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ka hyrë ne fuqi me 17.11.2022 në të cilin janë përfshirë dhe adresuar një mori ndryshimesh si:<br>1. Zgjatja e afatit për aplikim nga 6 muaj sa ka qenë në ligjin e vjetër, në 3 vjet pas pranimit të aktgjykimit të formës së prerë.<br>2. Është krijuar mundësia e qasjes së menjëhershme në kompensim të viktimave të dhunës në familje, viktimave fëmijë, viktimave te trafikimit etj.<br>3. Janë ndryshuar mënyrat dhe lartësia e kompensimit sidomos veprat penale të dhunës në familje, viktimave fëmijë etj.<br>4. Është rritur buxheti në fondin e kompensimit nga 78.000 euro sa ka qenë në vitet paraprake, në vitin 2023 ka qene 148.000 mijë euro e për vitin vitin 2024 kemi planifikuar buxhet në vlerë 200.000 euro si rezultat i shtimit të kërkesave e vlerës së kompensimit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zyrat për ndihmë juridike falas Institucionet shëndetësore dhe të kujdesit shoqëror Policia OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktima. | viktimën i informojnë me kohë viktimat lidhur me të drejtën e kompenzimit në përputhje me detyrimet ligjore | 5. Janë thjeshtësuar formularët për aplikim si dhe mënyrat e aplikimit. Parashtruesit e kërkesave mund ti dërgojnë kërkesat për kompensim në emailin e komisionit, në mënyrë fizike, apo edhe me postë.<br>Po ashtu janë hartuar aktet nënligjore,, rregullorja për mënyrat e kompensimit si dhe përmbajtjen e regjistrave të cilat kanë hyrë në fuqi.<br>Në çdo rast kur viktimat apo parashtruesit e kërkesave aplikojnë për kompensim, janë stafi i divizionit që ju ndihmon dhe informon për procedurën e aplikimit si dhe informon viktimat në çdo fazë.<br>Rrjeti i institucioneve që ofrojn shërbime për viktimat e krimit informojn viktimat në të drejtën e tyre në kompensim.<br>**Policia e Kosoves** në të gjitha rastet kur bjen në kontakt me viktimat i informon lidhur me të drejtat e tyre të cilat burojnë nga legjislacioni në fuqi. Gjate vitit 2023 PK ka lansuar edhe fletusheken NDAL DHUNËN NË FAMILJE ku në brendi të kësaj fletushke janë të listuara edhe të drejtat e viktimave të dhunës në familje. |
| IV.4.3 | Të sigurohet mbështetje në realizimin e të drejtës për kompensim për fëmijët, gratë dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. | Në vazhdi mësi | Buxheti i Kosovës Mjetet nga Programi për kompensimin e viktimave te krimit që kap buxhet në shumën prej afër 100.000 euro, që ekziston si linjë e rregullt buxhetor | MD MFPT MPBAL | Numri i përgjithshëm i parashtruesve të kërkesave; numri i parashtruesve të kërkesave që u është mohuar kompensimi; numrin i parashtruesve të kërkesave që u është dhënë kompensimi; shumën e kompensimit, të dhënë | **Në vitin 2023 janë pranuar 129 kërksea për kompenzim.**<br>- **24 kërkesa janë refuzuar**<br>- **98 janë aprovuar**<br>- **7 në punë.**<br>**Vlera totale e kompenzimit 221.249.53 euro**<br>Dhunë në familje 39 raste<br>Dhunim 11 raste<br>Keqpërdorim seksual i fëmijëve 8 raste<br>Ngacmim seksual 9 raste<br>Krime Lufte 12 raste<br>Trafikim me qenje njerëzore 3 raste<br>Vrasje 13 raste<br>Vrasje në tentative 9 raste<br>Lëndim i rënd trupor 13 raste<br>Lëndim i let trupor 10 raste<br>Grabitje 1 rast dhe<br>Mospërfillje e gjykatës 1 rast |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | e | | parashtruesve të kërkesave, | |
| IV.4.4 | Me qëllim të informimit të opinionit publik, të organizohen dhe mbahen aktiviete promovuese për promovimin e Programit për kompensimin e viktimave të krimit[5] | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës Donatorët | MD Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit | Është promovuar e drejta për kompenzimin e viktimave të krimit, përmes kampanjave vetdijësuese, debateve apo formave tjera të promovimit. | Divizioni për mbështetjen e viktimave të krimit së bashku me partnerët e vet, ka mbajtur trajnime me Gjyqtarë, Prokurorë, Mbrojtës të Viktimave, Punëtor Social, Policia e Kosovës, Njësi e Trafikimit me Qenie Njerëzore, OJQ të ndryshme të cilët janë informuar për të drejtën e viktimave në kompensim.<br><br>Është realizuar fushatë informuese për të drejtat e viktimave në kompensim përmes panove apo posterave informuese, fletëpalosjeve, broshurave të cilat janë vendosur dhe shpërndarë ne institucionet relevante dhe OJQ-të e ndryshme.<br><br>**Janë përditësuar informacionet në linkun e web faqes së MD-së. Linku -https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,103** |
| IV.4.5 | Vlerësimi i respektimit të të drejtave të njeriut në proceset gjyqësore penale në Kosovë | Në vazhdimësi | Buxheti i Kosovës | KGJK KGJK QKRMT | Respektimi i të drejtave të burgosurve konform standardeve të përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut | Gjykatat bëjnë trajtimin e të gjitha palëve dhe pjesëmarrëseve në procedura penale duke i respektuar parimet e parapara në Kushtetutë, Konvetat Ndërkombëtare dhe legjislacionin penal. |

[5] Ligji i Kosovës 05 / L-036 për kompensimin e viktimave të krimit rregullon të drejtën për kompensim për viktimat e krimeve të dhunshme si dhe të varurit e tyre. Ligji u miratua në 2015 duke renditur krimet e dhunshme që kompensohen nga fondi i kompensimit të viktimave.Krimet që duhet të kompensohen përfshijnë: trafikimin e qenieve njerëzore, përdhunimin, abuzimin seksual të fëmijëve, vrasjen,dhe krimet e dhunës në familje siç përcaktohen në ligjin për mbrojtjen nga familja Dhuna.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.4.6 | Të sigurohet dhe ofrohet qasje në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës | Në vazhdimësi | Buxheti Donatorët | Komisioni qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës së fundit në Kosovë Prokurorit Gjykatat | Numri i kallëzimeve penale dhe aktakuzave të ngritura për dhunën seksuale gjatë luftës | Nga të dhënat e siguruara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) , rezulton se numri i rasteve në procedim për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, është si në vijim:<br>**50 –viktima të dhunës seksuale**<br>48 raste për gjininë femërore)<br>( 2 raset për gjininë mashkullore**)**. |
| **IV.5** | **Objektivi specifik: Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve**<br>**Progresi në zbatim** | | | | | |
| IV.5.1 | Regjistrimi i pronës së përbashkët në emrin e të dy bashkëshortëve | 2021-2023 | Nuk ka kosto shtesë | **Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)** Komunat ABGJ | Prona e përbashkët e regjistruar në emrin e të dy | Masa afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë. ABGJ propozoi për miratim Qeverisë vazhdimin e masës afirmative "Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë." UA është vazhduar edhe për një vit prill 2023-prill 2024.<br>Nga kjo masë afirmative për periudhën janar- dhjetor 2023 janë regjistruar (pesëmijë e pesëdhjet) 5050 prona në emër të dy bashkëshorteve. |
| IV.5.2 | Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë | 2021-2023 | Buxheti Financimi i Donatorëve | **MD, ABGJ,** Komunat MPL | Fushatat dhe aktivitete promovuese të realizuara | ABGJ me synim të senizibilizimit për të drejtat pronësore të grave dhe përfitimet përmes aplikimit të masës afirmative ka realizuar një videospot televiziv për Udhëzimin Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve-pa pagesë. Vlera totale është 1450.00 euro:<br>https://www.youtube.com/watch?v=NYuCL7TtB1Y<br>Komuna e Istogut SDNJK (Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komuniteteve) në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi me përkrahjen e OSBE-së në muajin Maj 2023, organizoi dhe mbajti dy takime më qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Në këto takime u shpërndanë fletushka me të dhëna për të drejtën në |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | trashëgimi dhe pronë.<br>**Komuna e Rahovecit** -ka organizuar fushatë vetëdijesuese për të drejten në trashëgimi, janë shpërnda fletushka me qëllim të promovimit të Udhëzimt Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Gjithashtu është vendosur Njoftimi në A3 para Drejtorisë së Kadastres dhe Gjeodezis.<br>Kemi organizuar fushatë vetëdijesuese për të drejten në trashëgimi, kemi shpërnda ROLL UP me qëllim të promovimit të Udhëzimt Administrativ për regjistrimin e pronës në emer të dy bashkëshortëve.<br>Spoti promovues emituar dy muaj me radhe ne TV lokale-TV Malisheva për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshorteve |
| IV.5. 3 | Të realizohen të drejtat pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve përmes Zbatim të vendimeve të plotfuqishmetë vendosura nga AKKVP-së (apo organi pasues) | 2021-2023 | Buxheti Financim i i Donatorëve | Sekretaria Ekzekutive e AKKVP-së Policia e Kosovës | Kthimi i të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve, si rezultat i zbatimit të vendimeve të AKKVP-ja<br><br>Numri i vendimeve të plotëfuqishme të zbatuara | Numri i vendimeve të plotëfuqishme të zbatuara është 324. |
| IV.5. 4 | AKKVP-ja duhet të zbatoj urdhrat për dëbim sipas kompetencave ekzekutive të AKKVP-së, si dhe duhet të lehtësojë bartjen dhe largimin eventual të uzurpuesve | 2021-2023 | Nuk ka kosto shtesë | AKKVP-së Policia e Kosoves | Numri i urdhërave të zbatura për dëbim, qoftë të pronave të uzurpuara apo ato të cilat janë ri uzurpuar<br><br>*Dëbimi i uzurpuesve të paligjshëm nga pronat* | Numri i urdhrave për dëbim të zbatuara në periudhën raportuese është 5. Ne pritje janë 65 urdhra për dëbim ku 90 % e këtyre pronave janë në veri të vendit. Policia e Kosovës ka asistuar Agjencinë e Pronave në 51 raste. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *përkatëse sipas kompetencave e ekzekutive të Agjencisë* | |
| IV.5.5 | Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për çështjet e pronës duhet të respektohen plotësisht dhe të zbatohen me shpejtësi | 2022-2023 | Buxheti i Kosovës | Sekretaria Ekzekutive e AKKVP-së | Numri i vendimeve të zbatuara lidhur me të drejtat pronësore | Vendime të zbatuara të Gjykates Kushtetuese për periudhën 2022-2023 nuk ka. Në proces të zbatimit jane tri vendime të cilat per tu zbatuar është kërkuar nga ana e paraqitësve të kërkesës që të bejne ndarjen fizike pasi që zbatimi është i pa mundur pa ndarjen fizike.<br>Arsye tjeter e mos zbatimit të dy vendimeve tjera janë edhe ndërtimi I strukturave jo legale, Agjencia bazuar në kornizën ligjore në fuqi u ka afruar paleve ndërmjetesim dhe deri me tani ky mjet nuk është pranuar por Agjencia mbetet e përkushtuar që të aplikoje kete mjet nëse palët pajtohen me vone.<br>Dy vendime ende të pa zbatuara për shkak të mosdorzimit te dokumentave te kerkuara nga Agjencia (parashtrusi I kerkeses ka vdeke dhe trashigimtaret duhet të kene vendimin e trashegimise- në prone ka struktur të paligjshme). |
| IV.5.6 | Të zbatohen në tërësi dispozitat nga Ligji Nr. 02/L-37 "për përdorimin e gjuhëve" për të siguruar se pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë mund t'i qasen informatave dhe mund të marrin pjesë në të gjitha procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore. | 2021-2023 | Buxheti i Kosovës | (AKKVP) Gjykatat Prokurorit Zyra për Qështje të komuniteteve Zyra e Komisionerit për Gjuhët | Pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë mund t'i qasen informatave dhe mund të marrin pjesë në të gjitha procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore komfor dispozitave të përcaktuara me Ligji Nr. 02/L-37 "për përdorimin e gjuhëve | Të gjithë pjesëmarrësit në procedurat gjyqësore, para prokurorive, Policisë apo Shërbimit Korrektues të Kosovës, kanë të drejtë të përdorin gjuhët e tyre amtare. Përkthimin e siguron falas gjykata, përkatësisht organet e lartcekura. Nuk është raportuar ndonjë akesë lidhur me realizimin e kësaj të drejte në procedurat në të cilat preken të drejtat e tyre pronësore.<br>Agjencioni për krahasim dhe Verifikim të Pronës në plotni e zbaton Ligjin. Nr.02/L-37 dhe dokumentacioni lëshohet në të tri gjuhet zyrtare në Kosove.<br>Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ-ja), nuk ka marrë ndonjë ankesë nga qytaterët për këtë çështje. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| IV.5.7 | Konform Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme 01/2008 ,Qeveria të themelon Komisionin Qendror për Ankesa | 2021 | Buxheti i Kosovës | MKK<br>ZKM<br>MFPT<br>MMPHI<br>UNHCR | Qeveria ka marrë vendim për themelimin e Komisionit Qendror për Ankesa | Eshtë zbatuar.<br>Komisoni është themeluar me Vendimit të QRK Nr.13/116 datë 28.12.2022. |
| IV.5.8 | ZKKK përgatit plan veprimet përkatëse në pajtueshmëri me prioritetet komunale, për t‟i<br><br>Komunës në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit dhe të ri-integrimit në bazë të Rregullores për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim harton Planin e Veprimit Komunal për Kthim | 2021/2023 | Buxheti i Kosovës Donatorët | MKK<br>Komunat<br>ZKKK (Zyrat Komunale për Këthim dhe Komunitete)<br>MAPL<br>UNHCR | Numri i planeve të zhvilluara dhe aprovuara<br><br>Kategoria dhe numri i personave të cilët kanë përfituar | Komuna e Kamenices ka përgatitë dhe aprovuar Planin komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Kamenicës 2023 – 2025<br>Komuna e Podujevës ka përgaditë dhe përfunduar Planin komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025.<br>Komuna e Prishtines ka hartuar Planin për riintegrim e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, Plani për avansim e të drejtave të komuniteteve, Plani lokal i veprimit për kthim<br>Kthim nuk ka pasur nga viti 2021 e kthyer 1 familje, riintegrim 10 familje qe ju paguhet banimi, dhe shërbimet tjera dhe përfitimet ne plani e biznesit , aftësim profesional, etj.<br>ZKKK ka të miratuar 2 plane të veprimit që kanë për synim integrimin e qëndrushëm të personave të riatdhesuar dhe personave të kthyer (2023-2025)<br>Në komunën e Malishevës është hartuar Plani i veprimit nga zyra për komunitete për personat e kthyer dhe riintegruar<br>Poashtu është renovuar edhe QAK (qendra për angazhimin e komuniteteve e cila shërben për personat e riintegruar) për aktivitete e njoftime të ndryshme.<br>Po në përputhje me Rregulloren për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme 01/2018 Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, zyrtari i ZKKK-së përgatit plane dhe ndermerr veprime përkatëse në pajtueshmëri me prioritetet komunale për t‟I ndihmuar komunës në përmbushjen e obligimeve të veta. |